

Aliqi ZHONGA

Dhurata MULGECI

Mirela CELAMI

GJUHA SHQIPE 7

Udhëzues për mësuesin



IRISOFT EDUCATION

Miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit

Botues: Irisoft EDUCATION
Esmeralda TASHO

Konsulent shkencor: Dr. Elida QENAMI

Redaktore letrare: Ortensa MARINI

Arti grafik: Zamir BRAHIMAJ

© IRISOFT EDUCATION 2016

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Riprodhimi i librit, qoftë edhe në formë të pjesshme është i ndaluar.

Botim i vitit 2016

Shtypur në shtypshkronjën: CLASSICPRINT

ISBN 978-9928-4362-5-2

Shtëpia botuese: IRISOFT EDUCATION

Adresa: Rruga "Him Kolli; V. 23/1

Tel: 00355 2242 107;

Mob: 069 40 970 40

e-mail:info@irisoft.al

www.irisoft.edu.al



Përmbajtja e lëndës

Plani sintetik	5
Plani analitik i detajuar	6
Plani i tremujorit të parë (shtator-dhjetor).....	6
Plani i tremujorit të dytë (janar-mars)	15
Plani i tremujorit të tretë (prill-qershor)	23
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç	29
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës.....	31
Metoda të mësimdhënies në klasë, të klasifikuara sipas veprimtarive të të nxënit.....	33
Planifikimi ditor (ditari)	35
Teste.....	326

Plani sintetik

35 javë mësimore x 5 orë/javë = 175 orë

Kompetencat/klasat	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare		Të shkruarit për qëllime letrare dhe funksionale	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Totali
Klasa e shtatë	10 orë	10 orë	49 orë tekste letrare	21 orë tekste joletrare	25 orë	60 orë	175 orë

Plani analitik i detajuar

Plani i tremujorit të parë (shtator-dhjetor)

Nr.	Kompetenca për fushë	Tema mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia	Vlerësim	Burimi
1	Të folurit	Bisedojmë rreth pushimeve	Më pëlqejnë pushimet	Pema e mendimit, Bisedë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Album me fotografi nga pushimet verore
2	Të dëgjuarit	Rrëfime personale	Rrëfime personale	Parashikim me terma paraprakë, Bisedë e drejtuar, Punë e pavarur	Imagjinatë e drejtuar, Parashikim me terma paraprakë,	Vlerësim i vazhduar
3	Të lexuarit-tekst joletrar	Teksti letrar dhe joletrar	Punë me fisha	Stuhi mendimi, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti “Gjuha shqipe 7”, fisha me tekste të ndryshme
4	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Grupet e zanoreve dhe diftongjet në gjuhën shqipe (Fonetikë)	Punë me fisha	Rrjeti i diskutimit, Ditari dypjesësh, Praktikë e drejtuar	Vlerësim i vazhduar	Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe
5	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Theksi i fjalës dhe fjalisë (Fonetikë)	Punë me fisha	Praktikë e drejtuar, Punë në dyshe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe
6	Të lexuarit-tekst joletrar	Enciklopedia	Prezantim i dy enciklopedive: elektronike dhe të shkruara	Diskutim, Lexim i drejtuar	Vlerësim i vazhduar	Lloje të ndryshme enciklopedish

7	Të lexuarit- tekst joletrar	Enciklopedia	Prezantimi i enciklopevide elektronike dhe të shkruara nga nxënësit	Diskutim, Lexim i drejtuar	Vlerësim i vazhduar	Lloje të ndryshme enciklopedish
8	Të lexuarit – tekst letrar	Fabula	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
9	Të lexuarit – tekst letrar	Fabula	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Libra me fabula
10	Të dëgjuarit	Të dëgjojmë fabula	Fabula të autorëve shqiptarë e të huaj	Dëgjim me vëmendje, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
11	Të lexuarit – tekst letrar	“Lahutari” B. Dedja	Punë individuale, Punë me fisha	Ruaje fjalën e fundit për mua, Diskutim, Pema e mendimit, Punë në çift	Vlerësim i vazhduar	Teksti “Gjuha shqipe 7”, skeda, tabela, shkumësa me ngjyra
12	Të shkruarit	Të shkruajmë një përrallë	Punë e pavarur	Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
13	Të lexuarit – tekst letrar	“Prometeu” Eskili – përshtatje	Punë individuale, Punë me grupe.	Minikonkurs, Lexim në heshtje, Punë e drejtuar	Vlerësim i vazhduar	Teksti “Gjuha shqipe 7”, fletore, CD, videoprojektor
14	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Klasat e fjalëve	Punë me grupe fjalësh që ndryshojnë ose jo	Harta e koncepteve, Punë e pavarur, Punë në	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

				grupe, Diskutim		
15	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
16	Të lexuarit – tekst letrar	“Besa e Kostandinit” M. Kuteli	Punë me tekstin	Lexim dhe pyetje, Harta e tregimit, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti “Gjuha Shqipe 7” tabela, shkumësa me ngjyra, lapsa
17	Të lexuarit – tekst letrar	“Besa e Kostandinit” M. Kuteli	Punë me tekstin	Lexim dhe pyetje, Harta e tregimit, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti “Gjuha Shqipe 7” tabela, shkumësa me ngjyra, lapsa
18	Të dëgjuarit	Dëgjimi i përrallës	Punë me tekstin	Dëgjim me vëmendje, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
19	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Emri dhe karakteristikat e tij	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
20	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Trajta dhe lakimi i emrave	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
21	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime përmbledhëse	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
22	Të lexuarit	“Gjeniu i vogël”		Bisedë, Lexim i drejtuar,	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

		S. Cvajg		Punë e pavarur, Diskutim		
23	Të lexuarit	“Gjeniu i vogël” S. Cvajg		Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
24	Të lexuarit- tekst joletrar	Eseja	Punë me tekstin	Diagrami i Venit, Tabela, VLD (veprimtari e leximit të drejtuar)	Vlerësim i vazhduar	Teksti “Gjuha shqipe 7”, fletore, materiale nga interneti
25	Të lexuarit- tekst joletrar	Eseja (Ca këshilla mbi artin e të shkruarit)	Punë me tekstin	Diagrami i Venit, Tabela, VLD (veprimtari e leximit të drejtuar)	Vlerësim i vazhduar	Teksti “Gjuha shqipe 7”, fletore, materiale nga interneti
26	Të shkruarit	Të shkruajmë ese	Të krijojmë	Diagrami i Venit, Tabela, VLD (veprimtari e leximit të drejtuar)	Vlerësim i vazhduar	Fletë formati
27	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Mbiemri	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
28	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Shkallët e mbiemrit	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
29	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime për mbiemrin	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
30	Të lexuarit- tekst joletrar	Letra formale	Modeli i një letre	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

				drejtuar, Diskutim		
31	Të shkruarit	Shkruajmë një letër formale	Letrat	Punë e pavarur		Teksti mësimor
32	Të dëgjuarit	Letërsi gojore "Athinaja"		Diskutim, Mbajtje shënimesh		
33	Të shkruarit	Rishikimi i punës me shkrim (eseja)	Lexojmë punën më të mirë	Praktikë e drejtuar, Praktikë e pavarur, Diskutim		Fletoret e punës me shkrim
34	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Përemri dhe llojet e tij	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
35	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
36	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
37	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Folja në mënyrën kushtore	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
38	Të lexuarit – tekst letrar	"Gjaku i arbërit" F. Kraja	Punë me tekstin	Bisedë, Lexim në role, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
39	Të lexuarit- tekst letrar	"Gjaku i arbërit" F. Kraja	Lojë në role	Lojë në role, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

40	Të shkruarit	Kthejmë në prozë një tekst dramatik	Punë e pavarur	Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
41	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Mënyra habitore	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
42	Të lexuarit	Bisedë letrare (1)	Më pëlqen të lexoj	Bisedë, Prezantim, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Libër artistik
43	Të folurit	Bisedë letrare	Më pëlqen të lexoj	Bisedë, Prezantim, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Libër artistik
44	Të dëgjuarit	A jam një dëgjues i mirë?	Punë me tekstin	Diskutim, Dëgjim me vëmendje	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
45	Të shkruarit	Rishikimi i punës me shkrim	Punët më të mira	Praktikë e drejtuar, Praktikë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Puna me shkrim
46	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Mënyra dëshirore dhe urdhërore	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
47	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime për mënyrat e foljeve	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
48	Të lexuarit – tekst letrar	“Ishuj në qiell” A. Klark	Punë me tekstin	Bisedë, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
49	Të lexuarit – tekst letrar	“Ishuj në qiell” A. Klark	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

				drejtuar, Diskutim		
50	Të shkruajmë	Shkruajmë një tregim fantastiko-shkencor	Punë e pavarur	Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	Fletoret e punës me shkrim
51	Të lexuarit – tekst letrar	“Çapkën i madh ky Tom Sojeri” M. Tuein	Punë me tekstin	Bisedë, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
52	Të lexuarit – tekst letrar	“Çapkën i madh ky Tom Sojeri” M. Tuein	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
53	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Format e pashtjelluara të foljes	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
54	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime për format e pashtjelluara	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
55	Të shkruarit	Rishikimi i punës me shkrim		Punë e pavarur		
56	Të lexuarit – tekst joletrar	Teksti udhëzues	Teksti, receta, manuale etj.	Dëgjim me vëmendje, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Libra gatimesh, manuale përdorimesh
57	Të shkruarit	Shkruajmë udhëzime	Shkruajmë një tekst udhëzues	Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	Fletoret e punës me shkrim
58	Të folurit	Rëndësia e lojërave	Më pëlqen të luaj	Bisedë, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
59	Të lexuarit – tekst letrar	“Xhevahiri i fjalës” Zh. Jorganxhi	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

				drejtuar, Diskutim		
60	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Lidhëzat	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
61	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Lidhëzat	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
62	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Diktim	Shkruan duke dëgjuar leximin e tekstit nga mësuesi/ja	Punë e pavarur	Vlerësim përmbledhës	Teksti mësimor
63	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Pasthirrmat, llojet e tyre	Punë me fisha	Bisedë, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
64	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Pjesëzat	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
65	Të lexuarit – tekst letrar	“Vrarja e ndërgjegjes” A. Nesin		Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
66	Të lexuarit – tekst letrar	“Vrarja e ndërgjegjes” A. Nesin	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
67	Të folurit	Të respektojmë njëritjetrin në shkollë dhe jashtë saj	Diskutojmë për ndryshimet e marrëdhënieve mësues -	Bisedë, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

			nxënës			
68	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Përsëritje të njohurive	Diskutim, Punë e pavarur, Punë e drejtuar	Diskutim, Punë e pavarur, Punë e drejtuar	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
69	Të shkruajmë	Test për tremujorin e parë		Punë e pavarur	Vlerësim përmblendhës	Test për tremujorin e parë
70	Të shkruajmë	Shkruajmë me imagjinatë: Shkolla ime	Imagjinata ime	Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

Plani i tremujorit të dytë (janar-mars)

Nr.	Kompetenca për fushë	Tema mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia	Vlerësim	Burimi
71	Të lexuarit – tekst joletrar	Autobiografia Anton Pashku	Punë me tekstin	Diskutim për njohuritë paraprake, Bisedë	Vlerësim i vazhduar	Tekste autobiografike
72	Të lexuarit – tekst joletrar	Autobiografia A. Pashku	Lexojmë e diskutojmë tekste autobiografike	Diskutim për njohuritë paraprake, Bisedë	Vlerësim i vazhduar	Interneti, libra autobiografik
73	Të shkruarit	Shkruajmë autobiografinë	Shkruajmë autobiografinë tonë	Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	Të shkruarit
74	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Drejtshkrim: Përdorimi i pikës, presjes, pikëçuditjes	Tekste të shkurtra	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Tekste të ndryshme
75	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Përdorimi i shumëpikëshit dhe përdorimi i apostrofit te trajtat e shkurtra të bashkuara	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
76	Të lexuarit – tekst letrar	“Çajld Haroldi” Bajroni	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	

77	Të lexuarit – tekst letrar	“Çajld Haroldi” Bajroni	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
78	Të lexuarit – tekst joletrar	Biografia Xh. Bajron	Punë me tekstin	Bisedë, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
79	Të lexuarit – tekst joletrar	Biografia	Punë me tekstin	Bisedë, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
80	Të shkruarit	Shkruajmë biografi		Punë e pavarur		
81	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Drejtshkrimi i zanores ë në trup të fjalës	Teksti i shkurtër	Punë me fisha, Tabela e koncepteve, Praktikë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
82	Të lexuarit – tekst letrar	“Karnalet e Korçës” S. Çomora	Përvojat e fëmijëve në teatër	Parashikim me terma paraprakë, Praktikë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, CD
83	Të lexuarit – tekst letrar	“Karnalet e Korçës” S. Çomora	Punë me tekstin	Bisedë, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
84	Të folurit	Festa e Karnavaleve	Prezantimi punës të secilit grup	Bisedë, Punë në grupe, Turi i galerisë, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Interneti, enciklopedi
85	Të lexuarit – tekst joletrar	Intervistë me Lorik Canën	Intervista	Stuhi mendimesh, Lexim i drejtuar, Shkëmbim idesh e përvojash, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Media
86	Të shkruarit	Shkruaj një intervistë	Punë e pavarur	Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

87	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupe zanoresh dhe diftongje - ie dhe - je	Punë me fisha	Punë me fisha, Punë dyshe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
88	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Drejtshkrimi i emrave që kanë dy trajta shumësi sipas kuptimit të ndryshëm të tyre	Punë me fisha	Bisedë, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Libra të ndryshëm
89	Të lexuarit	Bisedë letrare 2	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Libra të ndryshëm artistik
90	Të folurit	Bisedë letrare	Punë me tekstin	Bisedë, Lexime të punës së nxënësve, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Libra të ndryshëm artistik
91	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Drejtshkrimi i fjalëve të prejardhura me prapashtesat –si, -ri, -ar, -tar, -tor, -shëm	Klasifikimi i prapashtesave	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
92	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Drejtshkrimi i fjalëve të përbëra kur fjala e dytë fillon me zanore	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë me fisha, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
93	Të lexuarit- tekst joletrar	Artikuj gazetash	Punë me tekste të ndryshme nga	Bisedë, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Gazetat

			mediat			
94	Të lexuarit- tekst joletrar	Artikuj revistash	Revista të ndryshme	Lexim zinxhir, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Revistat
95		Diktim				
96	Të dëgjojmë	Dëgjojmë emisione informative	Më pëlqejnë emisionet	Stuhi mendimesh, Punë e drejtuar, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Televizionet
97	Të lexuarit- tekst letrar	“Plaku dhe deti” E. Heminguej	Punë me tekstin	Lexim në heshtje, Karrigia e nxehtë	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
98	Të lexuarit- tekst letrar	“Plaku dhe deti” E. Heminguej	Punë me tekstin	Bisedë, Ditari dypjesësh, Lojë në role	Vlerësim i vazhduar	Vepra “Plaku dhe deti” E. Heminguej
99	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Kryefjala	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Tekste të ndryshme
100	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime	Ushtrime	Punë me fisha, Punë në dyshe, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
101	Të shkruarit	Rishikimi i punës me shkrim	Qortim	Bisedë, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Fletoret e punës me shkrim
102	Të lexuarit- tekst joletrar	Rregullorja	Di të respektoj rregulloren	Bisedë, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, Rregullore të ndryshme në institucione, materiale interneti,

						CD
103	Të shkruarit	Shkruajmë rregullore	Di të respektoj rregulloren	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, Rregullore të ndryshme në institucione, materiale interneti, CD
104	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Kallëzuesi i thjeshtë foljor	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Tekste të ndryshme
105	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Kallëzuesi emëror	Teksti	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
106	<i>Të lexuarit: tekst letrar</i>	“Hymni i flamurit” F.Noli	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor,CD
107	<i>Të lexuarit: tekst letrar</i>	“Hymni i flamurit” F.Noli	Diskutojmë rreth figurës së Nolit	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, interneti, vepra të Nolit
108	Të folurit	Krenar që jam shqiptar	Prezantimi punës së secilit grup	Bisedë, Punë në grupe ,Turi i galerisë, Diskutim.	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, interneti
109	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Kallëzuesi i përbërë foljor	Ushtrime	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

110	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime për kallëzuesin	Ushtrime	Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim.	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
111	Të dëgjuarit	Deklarata e Pavarësisë së Kosovës	Punë me tekstin	Diskutim, Punë individuale, Turi galerisë, Diagrami i Venit	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, deklaratat, CD
112	Të lexuarit- tekst letrar	“Fjalimi i Skënderbeut” M. Barleti	Punë me tekstin	Bisedë, Parashikim, Lexim zinxhir, Rrjeti i Diskutimit	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, materiale interneti, vepra të Marin Barletit
113	Të lexuarit- tekst letrar	“Fjalimi i Skënderbeut” M. Barleti	Punë me tekstin	Imagjinatë e drejtuar, Punë e drejtuar, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, materiale nga interneti, vepra të Marin Barletit
114	Të folurit	Debati. Rregullat e debatit	Mbroj mendimin tim mbështetur në argumente	Harta e koncepteve, Punë e pavarur, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
115	Të dëgjuarit	Dëgjimi i një debati	Organizoj një debat	Stuhi mendimesh, Dëgjim i vëmendshëm, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
116	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
117	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime	Ushtrime	Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor

118	Të lexuarit- tekst joletrar	Punë me projekt: Guida turistike	Turizmi	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim, Hulumtim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
119	Të shkruarit	Punë me projekt: Guida turistike	Turizmi	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim, Hulumtim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
120	Të shkruarit	Punë me projekt: Guida turistike	Turizmi	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim, Prezantim	Vlerësim i vazhduar	Teksti, Interneti
121	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Rrethorët e vendit dhe i kohës	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
122	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Rrethorë i mënyrës dhe i sasisë	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
123	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Rrethorë i shkakut dhe i qëllimit	Ushtrime	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
124	Të lexuarit- tekst letrar	“Tregtar flamujsh” E. Koliqi	Punë me tekstin	Lexim me pyetje, Diskutim, Rrjeti semantik, Krahasimi, Punë në çift	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, vepra e Ernest Koliqit, materiale në internet
125	Të lexuarit- tekst letrar	“Tregtar flamujsh” E. Koliqi	Punë me tekstin	Lexim me pyetje, Diskutim, Rrjeti semantik, Krahasimi, Punë në çift	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, vepra e Ernest Koliqit, materiale në internet
126	Përdorimi i drejtë i	Ushtrime për	Ushtrime	Stuhi mendimesh, Punë e	Vlerësim i	Teksti mësimor

	gjuhës	rrethorët		pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	vazhduar	
127	Të lexuarit- tekst letrar	“Fermer i ndershëm ish im atë” R. Bërns	Punë me tekstin	Imagjinata e drejtuar, Punë e drejtuar, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
128	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Përsëritje				
129	Të shkruarit	Test për tremujorin e dytë		Punë e pavarur	Vlerësim përmbledhës	Test për tremujorin e dytë
130	Të lexuarit - tekst letrar	“Fermer i ndershëm ish im atë” R. Bërns	Punë me tekstin	Imagjinata e Drejtuar, Punë e drejtuar, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
131	Të shkruarit	Të shkruajmë prozë poetike	Shkruajmë	Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, fletore

Plani i tremujorit të tretë (prill-qershor)

Nr.	Kompetenca për fushë	Tema mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia	Vlerësim	Burimi
132	Të dëgjuarit	Gjuha jonë, gjuha shqype	Punë me tesktin	Bisedë, Diskutim, Diagrami i Venit	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, materiale nga interneti, “Mrizi i Zanave”, Fishta, “Lulet e verës”, Naim Frashëri, CD
133	Të lexuarit - tekst letrar	“Ay mal” M. Frashëri	Punë me tekstin	Bisedë, Punë në grupe, Procedura, Hulumtim, Diskutime	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, hartë gjeografike vepra e Mit’hat Frashërit, materiale nga interneti
134	Të lexuarit - tekst letrar	“Ay mal” M. Frashëri	Punë me tekstin	Imagjinata e drejtuar, Punë e drejtuar, Punë ne grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor hartë gjeografike, vepra e Mit’hat Frashërit, materiale nga interneti
135	Të shkruarit	Ese përshkuese: “Vendlindja ime”	Punë e pavarur	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
136	Të lexuarit: tekst letrar	“Zoti të dhashtë”	Punë me tekstin	Bisedë, Lexim në	Vlerësim i	Teksti mësimor.

		Migjeni		heshtje, Grupe eksperte në role.	vazhduar	Vepra “Novelat të qytetit të veriut”
137	Të lexuarit- tekst letrar	“Zoti të dhashtë” Migjeni	Punë me tekstin	Punë në dyshe, Diskutim, Empatia	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, materiale nga interneti, CD, film
138	Të dëgjuarit	Dëgjojmë këshilla	Dëgjim me kujdes	Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
139	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e përbërë	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
140	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Fjalja e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
141	Të lexuarit- tekst joletrar	Kronika	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, INSERT, Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor. kronika të ndryshme, lajme, CD
142	Të lexuarit- tekst joletrar	Kronika	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, INSERT, Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, kronika të ndryshme, lajme, CD
143	Të lexuarit- tekst letrar	Shkruani një kronikë	Lexim dhe diskutim i një tregimi	Përgatitja e skedës, Diskutim, Bisedë	Vlerësim i vazhduar	Vepra të autorëve të ndryshëm
144	Të lexuarit- tekst letrar	“Makbethi” U. Shekspir	Shfaqja e një fragmenti nga tragjedia	Diskutim, Lexim në role	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, CD

145	Të lexuarit- tekst letrar	“Makbethi” U. Shekspir	Interpretim në role	Interpretim, Diskutim, Analizë	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, CD
146	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Fjalja e përbërë me nënrenditje	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
147	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime përmbledhëse	Punë me tekstin	Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
148	<i>Të lexuarit: tekst letrar</i>	Bisedë letrare 3	Lexim dhe diskutim i një tregimi	Përgatitja e skedës, Diskutim, Bisedë	Vlerësim i vazhduar	Vepra të autorëve të ndyshëm
149	Të folurit	Bisedë letrare	Lexim dhe diskutim i një tregimi	Përgatitja e skedës, Diskutim, Bisedë	Vlerësim i vazhduar	Vepra të autorëve të ndyshëm
150	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Përdorimi i drejtë i gjuhës
151	Të lexuarit- tekst letrar	“Bulina” N. Prifti	Punë me tekstin	Bisedë, DRTA (diskutim)	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, materiale në internet, pamje nga filmi
152	Të lexuarit- tekst letrar	“Bulina” N. Prifti	Punë me tekstin	Interpretim në role, Diagrami i Venit, Argumentim idesh, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, materiale në internet, pamje nga filmi
153	Të folurit	Të duam kafshët	Mbroj mendimin	Hulumtim, Punë në	Vlerësim i	Testi mësimor,

			tim mbështetur në argumente	grupe, Bashkëbisedim	vazhduar	materiale në internet, pamje nga natyra, hartë gjeografike
154	Të lexuarit- tekst letrar	“Të mbjellim nga një dru” Agim Deva	Punë me tekstin	Leximi i poezisë, Diskutim, Punë e drejtuar	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
155	Të shkruarit	Realizimi i një posteri për mjedisin	Punë në gupe	Diskutim, Punë e pavarur, Turi i galerisë	Vlerësim i vazhduar	Interneti
156	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Mënyrat e fjalëformimit të fjalëve në gjuhën shqipe	Lloje të ndryshme fjalësh të parme ose jo të parme	Punë me fisha, Lexim i drejtuar, Punë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
157	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Ushtrime përmbledhëse për formimin e fjalëve	Punë me tekstin	Praktikë e drejtuar, Praktikë e pavarur, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
158	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Familja e fjalëve	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
159	Të lexuarit- tekst letrar	“Rruga e kthimit” P. Marko	Punë me tekstin	Parashikim me terma paraprakë, Lexim zinxhir, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, vepra nga Petro Marko, harta gjeografike
160	Të lexuarit- tekst letrar	“Rruga e kthimit” P. Marko	Punë me tekstin	Punë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, vepra nga Petro

						Marko, harta gjeografike
161	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Fusha leksikore	Punë me tekstin	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
162	<i>Përdorimi i drejtë i gjuhës</i>	Sinonimet, antonimet, homonimet	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
163	<i>Përdorimi i drejtë i gjuhës</i>	Ushtrime për sinonimet, antonimet, homonimet	Ushtrime	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor
164	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja	Punë me fisha	Stuhi mendimesh, Punë në grupe, Diskutim	Vlerësim i vazhduar	
165	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Diktim				
166	Të lexuarit- tekst letrar	“Zoga” N. Mjeda	Punë me tekstin	Lexim dhe pyetje, Diskutim, Punë në çifte	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, foto me pamje të stinës së pranverës
167	Të lexuarit- tekst letrar	“Zoga” N. Mjeda	Punë me tekstin	Bisedë, Shkrim i lirë	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, fletore
168	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Përsëritje				
169	Të shkruarit	Testim për tremujorin	Të shkruarit	Testim për	Të shkruarit	Testim për

		e tretë		tremujorin e tretë		tremujorin e tretë
170	Të lexuarit- tekst letrar	“Kronikë në gur” I. Kadare	Punë me tekstin	Lexim dhe pyetje, Diskutim, Rrjeti semantik, Krahasim, Punë në çifte	Vlerësim i vazhduar	Teksti mësimor, vepra “Kronikë në gur”, pamje nga Gjirokastra, hartë gjeografike
171	Të lexuarit- tekst letrar	“Kronikë në gur” I. Kadare				
172	<i>Të lexuarit: tekst joletrar</i>	Njoftime të ndryshme	Gazeta	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim.	Vlerësim i vazhduar	Interneti
173	<i>Të lexuarit: tekst joletrar</i>	Njoftime të ndryshme	Televizione	Stuhi mendimesh, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Diskutim.	Vlerësim i vazhduar	Libra të ndryshëm
174	Të lexuarit- tekst joletrar	Ftesa	Modele ftesash personale dhe zyrtare	Diskutim dhe krahasim	Vlerësim i vazhduar	Interneti
175	Të shkruarit	Ftesa		Punë e pavarur	Vlerësim i vazhduar	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi/ja:

shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit;

- dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komente të bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
- lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;
- veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyre me shkrim; shkruan një tekst deri në 500 fjalë (letër, udhëzim, kërkesë, ese etj.), duke respektuar rregullat gjuhësore;
- shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare ose të huaj, për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë;
- përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

- parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media;
- shpreh mendimin për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme;
- harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit;
- zgjidh një problem (gjuhësor) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse, përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (gjuhësor), duke paraqitur rezultate të njëjta;

- përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive ose krijimeve artistike.

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi/ja:

1. përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
2. zbaton në mënyrë të pavarur udhëzime të dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
3. shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar;
4. ndërlihdh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike;
5. përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijes;
6. parashtron pyetje (“pse?”, “çfarë?”, “si?”, “kur?”) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur;
7. menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

1. përgatit planin e punës për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses;
2. zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;
3. përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme grafike, ilustrime (të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve);
4. bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);
5. merr pjesë si anëtar i një jurie (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi artistik, duke u bazuar në kritere të paracaktuara.

Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

1. merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., dhe raporton (me gojë, me shkrim) për përvojat personale të fituara.

Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

1. zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë;

2. shpjegon (në forma të ndryshme të shprehuri) domosdoshmërinë e respektimit, zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raporte të shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të ndryshme interesi;

3. merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

1. përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;

2. analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik);

3. zhvillon aftësinë mediatike për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre (p.sh., dallon nëse një material i marrë nga interneti është fakt dhe burimi është primar ose sekondar).

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës

Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësi/ja:

a. kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to;

b. jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.

Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësi/a:

- a. zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij;
- b. merr pjesë në biseda shoqërore me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura, duke pyetur dhe duke iu përgjigjur pyetjeve;
- c. identifikon materiale të ndryshme dhe i përdor për të dhënë mesazhe ose porosi nëpërmjet reklamave e lajmërimeve, dhe bën prezantimin e tyre në media.

Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësi/ja:

- a. interpreton tekstet duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst dhe idetë e nënkuptuara;
- b. dallon informacionin e rëndësishëm në tekst;
- c. lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato.

1. Tekste letrare:

Nxënësi/ja:

- a. analizon në tekste të ndryshme poetike, tregimtare dhe dramatike gjuhën e figurshme;
- b. dallon temën dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën, subjektin në një tekst tregimtar e dramatik;
- c. dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre;
- d. shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe pjesë nga teksti.

2. Tekste joletrare:

Nxënësi/ja:

- a. dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme;
- b. kupton tiparet e strukturës dhe organizimit në tekste të ndryshme (paragrafë, tituj, nëntituj etj.).

❖ Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësi/ja:

- a. përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore, drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara;
- b. mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.

❖ Përdorimi i drejtë i gjuhës

Nxënësi/ja:

- a. dallon dhe përdor fjalitë e thjeshta dhe të përbëra, si dhe përcakton llojin e tyre;
- b. dallon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali;
- c. përcakton klasat e fjalëve dhe kategoritë e tyre gramatikore;
- d. dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- e. dallon fushën leksikore, familjen e fjalëve, kuptimin e parë, si dhe kuptimet e tjera të tyre;
- f. përdor mirë gjuhën standarde shqipe.

Metoda të mësimdhënies në klasë, të klasifikuara sipas veprimtarive të të nxënit

Zhvillimi i fjalorit

Analiza e tipareve semantike Harta e konceptit/përkufizimit Organizuesi grafik i analogjisë Parashikimi me terma paraprakë Përvijimi i të menduarit (koncepteve)

Diskutimi i ideve

Di-Dua të di-Mësova më shumë
Diskutim për njohuritë paraprake
Organizuesi grafik i analogjisë
Përvijimi i të menduarit (koncepteve)
Shpjegimi i përparuar
Sistemi ndërveprues i shënimeve

Të nxënit bashkëpunues

Rrjeti i diskutimit
Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues
Të nxënit me këmbime
Ruaje fjalën e fundit për mua
Rishikimi në dyshe
Shpjegimi i përparuar
Sistemi ndërveprues i shënimeve

Nxitja e diskutimit

Analiza e tipareve semantike
Diagrama piramidale
Di-Dua të di-Mësova më shumë
Diskutim për njohuritë paraprake
Leximi i drejtuar
Organizuesi grafik i analogjisë
Parashikimi me terma paraprakë
Rishikimi në dyshe
Rrjeti i diskutimit
Ruaje fjalën e fundit për mua
Shpjegimi i përparuar
Sistemi ndërveprues i shënimeve
Të nxënit me këmbime
Udhëzuesit e të lexuarit ndërveprues

Të lexuarit ndërveprues

Diagrama piramidale
Imagjinata e drejtuar
Leximi i drejtuar
Mbajtja e strukturuar e shënimeve
Parashikimi me terma paraprakë
Përmbledhja pohim/mbështetje
Pyetja sjell pyetjen

Pyetje autorit
Rrjeti i diskutimit
Ruaje fjalën e fundit për mua
Shënime mbi shënime
Sistemi ndërveprues i shënimeve
Të nxënit me këmbime
Udhëzuesit e të lexuarit ndërveprues

Nxitja për të përsosur të shkruarit

Diagrama piramidale
Di-Dua të di-Mësova më shumë
Ditaret e të nxënit
Parashikimi me terma paraprakë
Përmbledhja pohim/mbështetje
Rrjeti i diskutimit
Shënime mbi shënime
Ditari dypjesësh/trepjesësh

Paraqitja grafike e informacionit


INSERT
Pema e mendimit
Diagrami i Venit
Ditari dypjesësh/trpjesësh

Marrë nga “Metodat e mësimdhënies”

Analiza e tipareve semantike
Diagrama piramidale
Di-Dua të di-Mësova më shumë
Harta e konceptit/përkufizimi
Mbajtja e strukturuar e shënimeve
Organizuesi grafik i analogjisë
Përmbledhja pohim/mbështetje
Përvijimi i të menduarit (koncepteve)
Rrjeti i diskutimit
Shënime mbi shënime
Ndërtimi i shprehive studimore
Ditaret e të nxënit
Leximi i drejtuar
Marrëdhëniet pyetje - përgjigje
Mbajtja e strukturuar e shënimeve
Pyetja sjell pyetjen
Pyetje autorit
Rishikimi në dyshe
Shënime mbi shënime
Sistemi ndërveprues i shënimeve
Udhëzuesit e të lexuarit ndërveprues

Planifikimi ditor (ditari)

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Bisedojmë rreth pushimeve		Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit ndërtojnë pemën e mendimit të fjalës "pushime".	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> 1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; 2. dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e të tjerëve rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime; 3. komunikon me efikasitet dhe shfrytëzon në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mundësitë e të shprehurit. Kompetenca personale: Merr pjesë ose drejton punën në grup. Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> 1. përdor drejt gjuhën standarde gjatë të folurit; 2. kupton dhe zbaton në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; 3. diskuton dhe bashkëvepron me të tjerët gjatë punës në grup. 			Fjalët kyç: pushime verore, vende, shtëpi, shoqëri.
Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"			Lidhja me fushat kurikulare: Gjeografi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pema e mendimit; Bisedë e drejtuar; Punë e pavarur; Diskutim.			
Përshkrimi kontekstual i situatës: Në dyshe, nxënësit ndërtojnë pemën e mendimit të fjalës "pushime". Veprimet në situatë: <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja uron nxënësit për vitin e ri shkollor. Prezanton shkurt se çfarë përmban programi i klasës së shtatë. - Në dyshe, nxënësit ndërtojnë pemën e mendimit të fjalës "pushime". 			



- a) llojet e pushimeve;
- b) vendet turistike;
- c) aktivitetet;
- d) sezoni kur mund të bëhen.

- Mësuesi/ja drejton pyetjet:

Ku i kaluat pushimet?

Si i kaluat ato?

A ju mori malli për shtëpinë? Cili shok apo shoqe ju mungoi më shumë? Pse?

Veprimtari praktike:

- Ndahet klasa në grupe sipas preferencave që kanë për pushimet dhe së bashku hartojnë një listë ku argumentojnë pse përzgjedhja e tyre është më e mirë.

Secili grup prezanton pushimet që ka zgjedhur.

Mësuesi/ja drejton pyetjen: Si e keni pritur ditën e parë të shkollës?

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situates

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dëgjojnë me vëmendje të tjerët; bashkëpunojnë në grup; diskutojnë për një temë të dhënë ose rreth një pyetjeje duke iu përmbajtur asaj.

Detyrë shtëpie: Shkruani një paragraf argumentues me temë "Çfarë prisni nga ky vit shkollor?".

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Rrëfime personale (Në Oslo)		Situata e të nxënit: Nxënësit ndërtojnë fjali me fjalët kyç që mësuesi/ja i ka shkruar në tabelë.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e të tjerëve rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime; komunikon me efikasitet dhe shfrytëzon në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mundësitë e të shprehurit. <p>Kompetenca personale: Merr pjesë ose drejton punën në grup.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> merr njohuri rreth kryeqytetit të Norvegjisë; zhvillon qëndrime dhe vlera; zbaton aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të shkruara, të folura dhe mediatike. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>pushime verore, vende, shtëpi, shoqëri.</p>
<p>Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Gjeografi</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë; Bisedë e drejtuar; Punë e pavarur; Diskutim.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja shkruan në dërrasë fjalët: kryeqytet i Norvegjisë, bregdeti jugor, gadishull, hapësira të gjelbra, muzeume, anije vikinge, turistë.</p> <p>Nxënësit ndërtojnë fjali me fjalët kyç që mësuesi/ja i ka shkruar në tabelë.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <p>(Kjo orë mësimi zhvillohet me librat mbyllur.)</p>			

- Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të mbyllin libra dhe të mbajnë hapur vetëm një fletore. Prezanton temën e mësimit dhe e shkruan në tabelë. Në një tabak ka shkruar fjalët: kryeqytet i Norvegjisë, bregdeti jugor, gadishull, hapësira të gjelbra, muzeume, anije vikinge, turistë dhe u kërkon nxënësve të krijojnë fjali me to.

- Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe i udhëzon që gjatë dëgjimit të pjesës të mbajnë shënimet (pjesa do të lexohet dy herë).

Veprimtari praktike

Gjatë leximit të parë, nxënësit mbajnë shënime sipas grupeve:

grupi I - veprimet që bën shkrimtari, duke i renditur ato sipas radhës kronologjike;

grupi II - njerëzit;

grupi III - mënyrën e jetesës;

grupi IV - turistët;

grupi V - emra vendesh;

grupi VI - përshtypje personale.

Pas dëgjimit, mësuesi/ja u jep nxënësve 1' kohë për të rishikuar shënimet. Një përfaqësues i grupit flet rreth detyrës së dhënë, duke plotësuar me detaje dhe sqarime.

Pas leximit të dytë, nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

Çfarë ju mbeti në mendje nga ky rrëfim?

Cila ishte pjesa me të cilën autori kishte vështirësi të përshtatej? Pse?

Çfarë e dallon Oslon nga qytetet e tjera?

Po të huajt, si dalloheshin?

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dëgjojnë me vëmendje të tjerët; bashkëpunojnë në grup; mbajnë shënime për pjesën që dëgjojnë duke përzgjedhur materialin sipas kërkesës së dhënë.

Detyrë shtëpie: Shkruani një paragraf përshkruar me temë "Qyteti që më ka lënë mbresa".

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Teksti letrar dhe teksti joletrar		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Liston karakteristikat e tekstit letrar dhe joletrar. - Zbërthen strukturën e teksteve. - Krahason tekstet letrare dhe joletrare. - Analizon këto tekste në formë dhe përmbajtje. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>teksti letrar, teksti joletrar, përmbajtje, strukturë, analizë, veçori gjuhësore, elemente komunikimi.</p>
<p>Burimet: tksti mësimor “Gjuha Shqipe 7”, tabela, shkumësa me gjyra, fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, tekste joletrare, modele.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Diagrami i Venit; Organizues grafik; Punë në grupe; Tryeza e rrumbullakët.</p>			
<p>Organizimi i ores së mësimimit</p> <p>Hapi I: Mësimi nis me informacione të dhëna nga mësuesi/ja (mbi tekstin joletrar, mbi funksionin dhe qëllimin e tij). Në tabelë, mësuesi/ja shkruan karakteristikat e tekstit joletrar dhe letrar. Kërkon nga nxënësit të rikujtojnë karakteristikat e tekstit letrar. Të gjitha karakteristikat, mësuesi/ja i liston në tabelë dhe i fton nxënësit të plotësojnë Diagramin e Venit, të flasin mbi të përbashkëtat, të veçantat e tekstit letrar e joletrar. Nxënësit diskutojnë rreth teksteve duke ilustruar diskutimet e tyre me fragmente nga tekstet.</p>			

Hapi II: Mësuesi/ja ndan klasën në grupe. Secili grup ka një tekst joletrar dhe një tekst letrar, me të cilët ndërton pyetje dhe jep përgjigje rreth tyre. Pyetjet janë specifike, si: “cila është tema?”, “cila është ideja”, mesazhi, referenti dhe gjuha e përdorur në këto tekste. Përfaqësuesi i grupit lexon përgjigjet.

Hapi III: Mësuesi/ja plotëson organizuesin grafik dhe bën pjesë të punës edhe nxënësit.

Hapi IV: Tryezë e Rrumbullakët, ku vetë nxënësit do të zgjedhin shokët që plotësojnë karakteristikat, duke i shoqëruar me ilustrime nga tekstet (të përzgjedhura më përpara).

Nxënësit e zgjedhur falënderojnë shokët për vlerësimin.

Hapi V: Mësuesi/ja i fton nxënësit që të punojnë ushtrime në tekst. Ushtrimet synojnë përvetësimin praktik të elementeve të përmendur më lart.

Hapi VI: Mësuesi/ja udhëheq zgjidhjen e ushtrimeve, duke plotësuar tabelën e ushtrimeve, skemën e komunikimit.

Hapi VII: Vlerësimi i orës së mësimit. Diskuton me nxënësit duke i bërë pjesëmarrës edhe ata.

Nxënësit pyeten:

Si u ndjetë?

a. i interesuar b. i përfshirë c. i kontrolluar d. i painteresuar

Çfarë do t’ju mbetet në mendje nga ky mësim?

a. informacioni b. idetë e rëndësishme c. shprehitë

Karakteristikat e llojit të tekstit joletrar:

1. Funkzioni i tekstit: praktik

2. Qëllimi i tekstit: ____

3. Skema e komunikimit: ____

4. Tema që trajtohet: ____

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ndërtoni një tekst letrar dhe joletrar.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Grupet e zanoreve dhe diftongjet në gjuhën shqipe		Situata e të nxënit: Nxënësit ndërtojnë në dyshe fjali me fjalët: ndiej, dyer, dua, edukues, botues, dragua, përziej.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Nxënësi/ja:			
1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi;			
2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim;			
3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;			
4. shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë;			
5. përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalët kyç:
Nxënësi/ja:			grupe zanoresh, diftongje, rrokje, shqiptim.
1. dallon grupet e zanoreve dhe diftongjet;			
2. formon emra dhe mbiemra nga foljet;			
3. përdor saktë fjalët që kanë grupe zanoresh dhe diftongje në gjuhën e folur dhe të shkruar.			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare:
			TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënit me këmbime (punë në dyshe); Diskutim për njohuritë paraprake; Rishikimi në dyshe.			
Përshkrimi kontekstual i situatës			
Nxënësit në dyshe ndërtojnë fjali me fjalët: ndiej, dyer, dua, edukues, botues, dragua, përziej.			
Veprimet në situatë:			

1. Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit dhe shkruan në tabelë fjalët: ndiej, dyer, dua, edukues, botues, dragua, përziej, dhe u kërkon nxënësve të ndërtojnë fjali me to (punë në dyshe).

1. Në dyshe, nxënësit ndërtojnë fjali me fjalët e dhëna.

2. Mësuesi/ja drejton pyetjet:

- Çfarë është rrokja (Një tingull zanor ose një grup tingujsh, i përbërë nga një zanore e nga një a më shumë bashkëtingëllore, që shqiptohen me një të nxjerrë të frymës.)?
- Si përcaktohet numri i rrokjeve të një fjale (Numrin e rrokjeve të një fjale e gjejmë në bazë të numrit të zanoreve.)?
- Sa rrokje kanë fjalët me të cilat ndërtuat fjalitë?

3. Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin duke nënvizuar njohuritë e reja.

4. Mësuesi/ja shkruan në dërrasë fjalët: racion, pozicion, arte marziale, delegacion, kampion, parcial, aksion, piano, dhe shpjegon diftongun, kuptimin dhe probleme që sjell në drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e fjalëve.

5. Në dyshe, punohen ushtrimet sipas kërkesave. Ushtrimet 2 dhe 3 zhvillohen nga dy nxënës në dërrasë.

6. Diskutohen ushtrimet me gjithë klasën. Arrihet në përfundimin që, grupet e zanoreve duhet të shkruhen dhe të shqiptohen të plota.

Vlerësimi: për përgjigjet në faza të ndryshme të mësimit, punën në dyshe, përdorimin e gjuhës së saktë dhe termave të rinj të marrë në mësimit.

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; për zgjidhjen dhe shpjegimin e ushtrimeve; për përdorimin e saktë të grupeve të zanoreve në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 5, sipas kërkesës. Mund të kërkohet nga nxënësit që të shkruajnë një artikull gazete në Word, duke nënvizuar me komandën Underline grupet e zanoreve.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Theksi i fjalës dhe fjalisë		Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit punojnë për të vendosur theksin e fjalëve dhe përcaktojnë se në cilën rrokje bie ai (në rrokjen e parafundit, të fundit etj.).	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë; përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> lexon saktë fjalët duke vënë theksin në rrokjen e theksuar; përcakton saktë fjalët që mbartin theksin logjik në fjali dhe i lexon me intonacionin e duhur; shpjegon ndryshimet që ndodhin në kuptimin e fjalisë në qoftë se e zhvendosim theksin nga një fjalë në një tjetër. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>theksi i fjalës, rrokje e theksuar, theksi i fjalisë.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Teknologjia e komunikimit</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënit me këmbime; Lojë me role; Diskutim për njohuritë paraprake, Marrëdhëniet pyetje - përgjigje.</p>			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Nxënësit në dyshe punojnë për të vendosur theksin e fjalëve dhe përcaktojnë se në ç'rrokje bie ai (në rrokjen e parafundit, të fundit etj.).

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja shkruan në dërrasë fjalët: udhëtimi, dallohet, rruga, pamje, statuja, fshati, vogëlushe, kaçurrela, pranverë.
- Në dyshe, nxënësit vendosin theksin e fjalëve dhe përcaktojnë në cilën rrokje bie ai.
- Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit dhe e shkruan në dërrasë.
- Diskutohet rreth pikave: Ç'është theksi i fjalës? Mbi cilin tingull bie theksi në fjalët e gjuhës shqipe? Një nxënës lakon emrin **fëmijëria** dhe një tjetër zgjedh foljen **punoj** në kohën e tashme. Ç'ndodh me theksin?
- Një nxënës lexon pjesën mbi theksin e fjalës. Ushtrimi 1 punohet në libër për vendosjen e theksit të fjalëve. Diskutohet rreth pyetjes që shtrohet në ushtrimin 2.
- Tre nxënës lexojnë me role pjesën e dhënë në ushtrimin 3. Nxënësit e tjerë nënvizojnë fjalët që mbartin theksin logjik në fjali.
- Duke u nisur nga ky ushtrim, mësuesi/ja shpjegon mësimin për theksin e fjalisë. Theksohet se, ndryshe nga theksi i fjalës, theksi i fjalisë ndryshon duke rënë mbi fjalën që duam ta nxjerrim në pah dhe ta theksojmë.
- Lexohet me zë ushtrimi 3. Nxënësit ndryshojnë theksin e fjalisë duke e zhvendosur mbi fjalë të tjera. Nxënësit argumentojnë mbi ndryshimet që sjell kjo, duke patur parasysh çfarë do të kumtojë folësi.

Vlerësimi: për përgjigjet në dyshe, diskutimet, pjesëmarrjes, përdorimin e një gjuhe të saktë dhe të pasur me fjalë dhe terma që i përkasin fushës së gjuhësisë.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; lexojnë saktë duke vendosur drejt theksin e fjalës dhe të fjalisë.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 5, sipas kërkesës. Mund të kërkohej që detyra të përgatitet në Word duke përdorur komandat: Underline, Bold ose Italic për të dalluar fjalët që marrin theksin e fjalisë.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Enciklopedia (ora e parë)		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja prezanton para nxënësve dy -tri enciklopedi të shtypura, të cilat mund t'i marrë në bibliotekën e shkollës	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ liston mënyrat e renditjes së fjalëve në enciklopedi; ❖ përshkruan qëllimin e ruajtjes së enciklopedive; ❖ përdor fjalorët enciklopedikë. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>enciklopedi elektronike, enciklopedi e shkruar, rend alfabetik.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, interneti</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Lexim i drejtuar</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja prezanton enciklopeditë duke u shpjeguar nxënësve renditjen e fjalëve në to dhe qëllimin e shkrimit të tyre.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i enciklopedive të shkruara dhe elektronike. - Leximi i materialit në tekstin mësimor. - Diskutim. - Shpjegim nga ana e mësuesit/es se si mund të gjejmë fjalën që kërkojmë në enciklopedi. - Përdorimi i enciklopedisë nga nxënësit 			

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit dallojnë llojet e enciklopedive dhe gjejnë shpjegimin e fjalëve në to, duke treguar mënyrën e renditjes së tyre.

Detyrë shtëpie: Sillni në klasë, nëse keni, enciklopedi të shtypura.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa:VII
Tema mësimore: Enciklopedia (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Nxënësit prezantojnë para klasës enciklopeditë e shtypura ose enciklopedi elektronike të sjella dhe nga interneti	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> ❖ gjen fjalët sipas mënyrës së renditjes në enciklopedi; ❖ përdor fjalorët enciklopedikë; ❖ shpjegon kuptimet e fjalëve që mësuesi/ja kërkon. 		enciklopedi elektronike, enciklopedi e shkruar.	
Burimet: testi “Gjuha shqipe 7”, interneti		Lidhja me fushat kurikulare:	
		TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Prezantim; Diskutim; Punë e pavarur.			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Nxënësit prezantojnë enciklopeditë e sjella dhe gjejnë në to shpjegimin e fjalëve që u kërkon mësuesi/ja. Më pas diskutojnë rreth mënyrës së renditjes së tyre</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i enciklopedive që nxënësit kanë sjellë. - Gjetja e shpjegimit të fjalëve që mësuesi/ja u kërkon në tabelë. - Shpjegimi i mënyrës së renditjes së fjalëve (sipas alfabetit ose lëndës). 			

- Diskutim.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit dallojnë llojet e enciklopedive dhe gjejnë shpjegimin e fjalëve në to, duke treguar mënyrën e renditjes së tyre.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Fabula (ora e parë)		Situata e të nxënit: leximi nga mësuesi/ja i dy-tri fabulave nga autorë të ndryshëm.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ liston veçoritë e fabulës; ❖ krahason dy fabulat; ❖ identifikon dhe analizon personazhet. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>personazhe: kafshë ose bimë, moral, vese, personifikim.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, libër me fabula (Ezopi, La Fonten, Dritëro Agolli etj.)</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Teatër, Qytetari</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Kllaster; Diskutim.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja lexon dy - tri fabula të shkëputura nga autorë të ndryshëm të huaj ose shqiptarë.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhja e temës me njohuritë e marra për fabulën. - Plotësimi i kllasterit për veçoritë e fabulës. - Leximi i fabulave nga ana e nxënësve. - Diskutim rreth strukturës së saj. - Identifikimi i personazheve. - Shpjegimi i simbolikës: 			

- ariu – "njeri i fuqishëm", por jo i zgjuar;
- dhelpira – "njeri inteligjent", por i djallëzuar;
- gomari – "njeri jo i zgjuar".
- Gjetja e moralit në fabulën e parë.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: përcaktojnë veçoritë dhe strukturën e fabulave; shprehin idetë dhe mendimet e tyre gjatë analizës së personazheve dhe nxjerrjes së moralit.

Detyrë shtëpie: Shkruani një fabul.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Fabula (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Leximi i disa punimeve të nxënësve.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ shpjegon figurën letrare të personifikimit; ❖ shkruan një fabul; ❖ vlerëson punën e tij dhe të shokut/shoqes. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>personazhe: kafshë ose bimë, moral, strukturë, personifikim.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, libër me fabula (Ezopi, La Fonten, Dritëro Agolli etj.)</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Teatër, Qytetari</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Shkrim i lirë; Diskutim; Bisedë.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të lexojnë fabulat që kanë shkruar si detyrë shtëpie. Diskutohen punimet duke bërë dhe vlerësimet për punën e njëri-tjetrit.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leximi i fabulave të përgatitura nga ana e nxënësve. - Diskutimi rreth personazheve, strukturës dhe moralit. - Vlerësime për punët e njëri-tjetrit. - Punimi i rubrikës "Gjuha dhe stili": 			

a - Përcaktimi i fjalëve kyç për sistemin e drejtësisë: gjyqtar, gjykatë, e pandehur, dëshmitarë.

b - Shpjegimi i përdorimit të figurës së personifikimit: komunikimi mes kafshëve e bimëve (shpirtëzimi i tyre).

c - Kuptimi jo i drejtpërdrejtë ose ndryshe alegorik në fabula: përcjellja e mesazhit për njerëzit.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të shkruar fibula; bashkëbisedojnë me moshatarët, realizojnë interpretimet e tyre rreth fabulave dhe analizojnë gjuhën e që përdoret në to.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Dëgjojmë fabula		Situata e të nxënimit: Dëgjimi me vëmendje i fabulave në CD dhe i fabulave të tekstit të lexuara nga mësuesi/ja.	
<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ dëgjon me vëmendje fabulat; ❖ e ritregon atë duke qenë sa më afër versionit origjinal; ❖ diskuton rreth personazheve dhe mesazhit të secilës fabul. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>ritregim, dëgjues i vëmendshëm.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, materialet ndihmëse në CD</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Teatër, Qytetari</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Bisedë.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja vendos në magnetofon ose laptop CD-në me fabula. U kërkon nxënësve që të marrin pozicionin e përshtatshëm të trupit dhe të dëgjojnë me vëmendje, me qëllim ritregimin e materialit që do dëgjojnë.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendosija e CD-së me fabula. - Leximi i fabulave të tekstit nga ana e mësuesit/es. - Ritregimi i tyre nga ana e nxënësve. - Diskutim rreth personazheve, strukturës dhe moralit. 			

- Vlerësim për njëri-tjetrin, se sa dëgjues të mirë janë.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: ritregojnë sa më saktë fabulat, bashkëbisedojnë me moshatarët, realizojnë interpretimet e tyre rreth personazheve të fabulave dhe analizojnë gjuhën që përdoret në to.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Lahutari Bedri Dedja		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tregon bukur përrallën. - Gjen në përrallë fragmentet që u bëjnë përshtypje. - Mban qëndrim ndaj veprimit <p>a. Ç'është liria? b. Sa e rëndësishme është ajo?</p> <p>Dallon elementin fantastik të përrallës dhe plotëson pemën e mendimit me veçoritë e përrallës.</p> <p>Analizon përrallën në formë dhe përmbajtje.</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>lahuta, liria, përrallë, përmbajtje, personazhe, tematika, element fantastik.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, skeda, tabela, shkumësa me ngjyra, përralla, materiale nga interneti.</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Ruaje fjalën e fundit për mua; Diskutimi ; Pema e mendimit; Punë në çift.</p>			

Organizimi i orë së mësimi

Hapi I. Ritregimi i përrallës. Mësuesi/ja ndan klasën në tre grupe.

Mësuesi/ja vendos një karrige në qendër të klasës, përzgjedh nga një nxënës nga çdo grup për të rrëfyer përrallën, njëri pas tjetrit. Nxënësit e tjerë dëgjojnë me vëmendje rrëfimin e tre përfaqësuesve dhe në fund zgjedhin rrëfimtarin më të mirë.

Hapi II. Në këtë hap, mësuesi/ja u shpërndan nxënësve skedat e përgatitura dhe i udhëzon të gjejnë në përrallë fragmentet që u bëjnë përshtypje. Fjalitë e përzgjedhura i shkruajnë në një anë të skedës, kurse në anën tjetër shkruajnë komentin për të. Mësuesi/ja u kërkon të lexojnë vetëm fjalitë e përzgjedhura. Nxënësit që lexojnë pjesët e përzgjedhura drejtojnë edhe pjesën e orës së mësimi. Ata i ftojnë nxënësit e tjerë të bëjnë komentet në një fletë (në varësi të dëshirës së tyre). Komentet e tyre nuk ka të drejtë t'i komentojnë nxënësit që nuk morën pjesë.

Hapi III. Kalohet tek rubrika mbi interpretimin e tekstit. Nxënësit fillimisht diskutojnë mbi konceptin e lirisë sa e rëndësishme është ajo për njeriun. Pse Lahutari e kërkonte lirinë dhe në ç'mënyrë kërkonte ta fitonte atë. Mësuesi/ja fton nxënësit për të bërë portretin e Lahutarit. Nxënës të talentuar në pikturë e vizatojnë atë. Nxënës të tjerë realizojnë atë nëpërmjet imazhit të krijuar nga leximi i tekstit apo nga vështrimi i fotografisë në tekst.

Hapi IV. Kalohet tek rubrika "Të studiojmë gjuhën e tekstit".

Nxënësit rikthehen në tekst, gjejnë figura letrare, fjalët kyç me të cilat fillon e mbaron përralla. "Na ishte se ç'na ishte..."

Mësuesi/ja i fton nxënësit të tregojnë shembuj nga përralla të tjera se si fillojnë dhe mbarojnë ato. Formula e përrallave zgjon tek lexuesi tërheqjen e vëmendjes. Kërkohet nga nxënësit të ndërtojnë Pemën e mendimit. Për këtë, mësuesi/ja i vendos nxënësit të punojnë në çift.

Hapi V. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe tregojnë veçoritë jo vetëm të kësaj përralle, por dhe të përrallave të tjera që kanë lexuar.

Dëgjojnë mendimet e nxënësve dhe më pas mësuesi/ja plotëson Pemën e mendimit në tabelë. Gjuha e përrallës është e thjeshtë, e gjallë veprimet e personazheve, trillim i gjerë poetik, fantazia e guximshme, e pasur me elementin e aventurës, struktura e ndërtimit është e shkurtër dhe ato fillojnë me një formulë të gatshme dhe mbarojnë me një fund të lumtur. **PËRRALLA** ka këto elemente => 1) trillim i gjerë poetik; 2) fantazia e guximshme; 3) kthesa të papritura; 4) fillojnë me një formulë të gatshme; 5) gjuha e përrallës është e thjeshtë dhe e gjallë nga ana figurative.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie. Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Të shkruajmë një përrallë		Situata e të nxënit: Shkruajmë me fantazi	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkruan tekste duke përdorur elemente fantastike. - Zbaton rregullat e të shkruarit të përrallës. - Plotëson hyrjen dhe mbylljen e përrallës. - Vlerëson rëndësinë e mesazheve që përcjellin përrallat. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>përrallë, element fantastik, personazhe, strukturë, organizim, përmbajtje.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor “Gjuha Shqipe 7”, përralla , tabak me ngjyrë , bojëra uji , fletore , ngjitëse, gërshtë.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Punë në grupe ; Turi i galerisë.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Hapi I: E gjithë ora mësimore organizohet në dy faza:</p> <p>Faza e parë do të jetë faza përgatitore për të ndihmuar nxënësit të shkruajnë një përrallë. Kjo fazë udhëhiqet nga mësuesi/ja.</p> <p>Faza e dytë. Punë e pavarur. Nxënësit zgjedhin idetë e tyre për të shkruar përrallën. E shkruajnë atë në fletore.</p> <p>Hapi II: Faza e parë. Nxënësit punojnë në mënyrë individuale . Mësuesi/ja shënon në tabelë veçoritë e përrallave, të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - temat e përrallave, personazhet e përrallave, elementët realë dhe fantastik të përrallave, mesazhet e përrallave. Diskutohen këto elemente duku i ilustruar me përralla të marra nga interneti. <p>Klasa ndahet në grupe dhe secili grup thotë idenë e tij që shkroi në fletore, por duke zbatuar veçoritë e përrallave. Përfaqësuesi i secilit grup afishon në tabelë punën e</p>			

bërë dhe ua prezanton atë grupeve të tjera. Nxënësit diskutojnë rreth punëve të realizuara dhe mbajnë një qëndrim të caktuar.

Hapi III: Nxënësit, siç janë të ndarë në grupe, zbërthejnë kuptimin e përrallës, diskutojnë mbi hyrjen dhe mbylljen e saj. Japin shembuj edhe formulime të tjera që i kanë hasur gjatë leximit të përrallës . Në përfundim të detyrës organizohet turi i galerisë . Punimet e tyre, nxënësit i afishojnë në muret e klasës , secili nxënës mund të lëvizë në klasë dhe lexon punimet e shokëve. Në fund vlerësohet punimi më i mirë.

Mësuesi/ja bën vlerësimin e punës së nxënësve dhe i motivon ata për angazhimin gjatë orës.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Shkruani një përrallë dhe respektoni elementet e strukturës.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Prometeu Eskili Ora e parë e mësimit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësues/ja i ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temë.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Flet rreth veprave të periudhës së Antikitetit.</p> <p>Nxit nxënësit drejt një leximi të mjaftueshëm e të vetëdijshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth përmbajtjes.</p> <p>Zbërthen elementin mitologjik, çfarë ato përfaqësojnë në vetvete.</p> <p>Shkruan përmbledhjen e tregimit.</p> <p>Ritregon përmbajtjen, flasin mbi mesazhin që përcjell personazhi i Prometeut.</p>			<p>Fjalët kyç:</p> <p>miti, mitologjia, antikiteti, Zeusi.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, fletore, materiale nga interneti, foto, vepra “Prometeu”, CD, videoprojektor</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Minikonkurs; Lexim në heshtje; Punë e drejtuar.</p>			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: Mësuesi/ja zhvillon një minikonkurs me nxënësit, ku secili do të thotë më shumë tituj tregimesh që janë në përshtatje me temën dhe me personazhe nga heronj të letërsisë së periudhës së Antikitetit. Në fillim lihen nxënësit disa minuta t’i shkruajnë e pastaj i lexojnë. Në tabelë shkruhen disa prej titujve të ndarë në dy kolona: autorë shqiptar dhe të huaj; autorë të cilët kanë marrë tema dhe personazhe nga mitologjia shqiptare dhe mitologjia e periudhës së Antikitetit. Nga titujt e letërsisë së Antikitetit, mësuesi/ja veçon tregimin “Prometeu”, që është përshtatje në prozë. Nëse ky titull nuk ka dalë nga nxënësit jepet nga mësuesi/ja.

Hapi II: Pas kësaj, mësuesi/ja zbulon pjesën e tekstit me titull: “Prometeu”. Bëhet leximi zinxhir i pjesës nga nxënës të ndryshëm. Gjatë leximit, nxënësit nënvizojnë fjalët e panjohura, të cilat shpjegohen më pas nga mësuesi/ja.

Hapi III: Nxënësit rikthehen në tekst për të lexuar edhe një herë pjesën, tashmë në heshtje, me qëllim që t’u përgjigjen pyetjeve të përgatitura më parë nga mësuesi/ja. Pyetjet e hartuara, mësuesi/ja i shkruan në tabelë, ndërsa nxënësi në fletore (shkruhen pyetjet, pastaj vazhdon hapi tjetër). Qëllimi i pyetjeve është t’i nxisë nxënësit ndërkohë që ata lexojnë në heshtje pjesën e shkëputur nga teksti.

Hapi IV: Diskutohen përgjigjet. Roli i mësuesit/es në këtë moment është ai i drejtuesit.

Hapi V: Vendosen nxënësit ta ritregojnë bukur përmbajtjen e tekstit, duke u përqendruar në të gjitha variantet që kanë lexuar. Nxënësit do të flasin mbi kohën dhe vendin ku zhvillohen ngjarjet, duke e vendosur në kontekstin e letërsisë së antikitetit dhe pikërisht të periudhës së mitit dhe mitologjisë. Diskutohet mbi personazhet në këtë pjesë: Prometeu, Zeusi, Herakliu. Nxënësit diskutojnë mbi shkakun e dënimit të Prometeut. *Prometeu i vodhi zjarrin Zeusit për të ndihmuar njerëzit. Ai i bëri qëndresë hakmarrjes së Zeusit, i cili dha urdhër ta prangosnin në shkëmbin e Kaukazit.* Nxënësit do të përqendrohen në pjesët më domethënëse të tekstit ku do të shprehin dhe qëndrimin e tyre.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Përshkruani figurën e Prometeut. Listoni karakteristikat që kanë veprat në periudhën e Antikitetit.

Planifikimi ditor (ditar)

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Klasat e fjalëve		Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit punojnë për të dalluar klasat e fjalëve dhe për t'i klasifikuar ato në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Nxënësi/ja:			
1. ndërlihdh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike;			
2. dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime, propozime;			
3. punon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim për të nxënë një temë, një veprim, aktivitet a detyrë që i kërkohet;			
4. shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë;			
5. përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalët kyç:
Nxënësi/ja:			fjalë të ndryshueshme, të pandryshueshme, klasa fjalësh (pjesë ligjërata).
1. dallon klasat e fjalëve;			
2. shpjegon dallimin klasë e ndryshueshme, klasë e pandryshueshme;			
3. përshkruan një figurë të dhënë dhe bën klasifikimin e fjalëve në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.			
Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"			Lidhja me fushat kurikulare: TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Rimarrje njohurish; Tabela e koncepteve; Diagrami i Venit; Të nxënit me këmbime; Praktikë e pavarur.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Në dyshe, nxënësit punojnë për të dalluar klasat e fjalëve dhe për t'i klasifikuar në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme (Rimarrje njohurish)

Veprimet në situatë:

Në fletë formati, mësuesi/ja përgatit fisha për çdo çift nxënësish, ku shkruan fjalinë e mëposhtme dhe vizaton tabelën si më poshtë:

Kur dëgjoja njerëzit që thoshin "Mirëmbërëma!", menjëherë më shkante mendja tek oborri i shtëpisë së Babazotit.

Fjalët	Klasat	Të ndryshueshme	Të pandryshueshme
kur	lidhëz kohore		+
dëgjoja	folje	+	

(Në pamundësi të përgatitjes së fishave përdoret tabela. Nxënësit punojnë në dyshe në fletore.)

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit.
- Në dyshe, nxënësit punojnë për plotësimin e fishave të përgatitura ose në fletore.
- Diskutohet për zgjidhjen e ushtrimit.
- Mësuesi/ja ndërton në tabelë Diagramin e Venit për të përcaktuar dallimet dhe ngjashmëritë midis pjesëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. Nxënësit lexojnë mësimin dhe plotësojnë diagramin. Diskutohet rreth plotësimit të tij.

Veprimtari praktike

- Në dyshe punohen ushtrimet 1–6, sipas kërkesave.
- Ushtrimet diskutohen me gjithë klasën (Mësuesi/ja bën kujdes që të aktivizojë të gjithë nxënësit, duke drejtuar pyetjet sipas nivelit të tyre.).

Vlerësimi: për përgjigjet me gojë, punën e pavarur, diskutimet, përdorimin e një gjuhe të saktë dhe fjalor të pasur.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë klasat e fjalëve dhe i ndajnë në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Detyre shtëpie: ushtrimi 6. Nxënësi përshkruan figurën me 5 - 6 fjali, duke i ndarë fjalët në dy shtylla: të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Nxënësi mund ta paraqesë tabelën të punuar në programin Word.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime përmbledhëse për klasat e fjalëve		Situata e të nxënit: 2-3 nxënës lexojnë detyrën e shtëpisë; bëhet përshkrimi i figurës me 5-6 fjali dhe ndarja në tabelë e fjalëve në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: 1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; 2. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; 3. shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.) duke ndërvepruar në grup ose në klasë; 4. merr pjesë, drejton punën në grup, ndihmon pjesëtarët e grupit, raporton për punën në grup, mban qëndrim kritik, vlerësues për punën e shokëve apo të shoqeve.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: 1. klasifikon fjalët në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme; 2. përcakton klasat e fjalëve në gjuhën shqipe; 3. argumenton pse janë pjesë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.		Fjalët kyç: fjalë të ndryshueshme, të pandryshueshme, klasa fjale (pjesë ligjërate).	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”		Lidhja me fushat kurikulare: TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh; Të nxënit me këmbime; Marrëdhëniet pyetje - përgjigje.			
Përshkrimi kontekstual i situatës 2-3 nxënës lexojnë detyrën e shtëpisë; përshkrimi i figurës me 5-6 fjali dhe ndarja në tabelë e fjalëve në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. Veprimet në situatë: Mësuesi/ja prezanton temën e mësimi.			

2-3 nxënës lexojnë detyrën e shtëpisë; përshkrimi i figurës me 5-6 fjali dhe ndarja në tabelë e fjalëve në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Mësuesi/ja drejton pyetjet:

Cilat janë klasat e fjalëve?

Cilat janë klasat e ndryshueshme?

Cilat janë klasat e pandryshueshme?

Pse klasifikohen klasat e fjalëve në këtë mënyrë?

Veprimtari praktike

Ndahet klasa në grupe me nga 4-6 vetë (sipas bankave) dhe udhëzohen të zgjidhin ushtrimet, sipas kërkesave.

Gr. I - ushtrimet 1 dhe 4.

Gr. II - ushtrimet 2 dhe 4.

Gr. III - ushtrimet 3 dhe 4.

Gr. IV - ushtrimet 6 dhe 4.

Gr. V - ushtrimet 7 dhe 4.

Gr. VI - ushtrimet 8 dhe 4.

Nxënësve u lihet rreth 10' kohë për të diskutuar rreth ushtrimeve. Secili nxënës mban shënime në librin e tij dhe në fletoren e klasës. Mësuesi/ja kontrollon punën nga një grup në tjetrin.

Diskutohen ushtrimet me gjithë klasën. Në ushtrimin 4 argumentohet pse fjalët e dhëna përdoren herë në një klasë dhe herë në një tjetër. Ushtrimi 5 kryhet me ndihmën e mësuesit/es (Mësuesi/ja sqaron kur përemri kush përdoret si i pacaktuar, p.sh.: Më thuaj, a erdhi kush? Kush, në këtë rast, zëvendësohet me një përemër tjetër të pacaktuar, të tipit ndonjë; fjala vetëm përdoret si ndajfolje mënyre kur ka kuptimin pa të tjerët dhe si pjesëz kur përdoret për të veçuar ose kufizuar. Vetëm Mira erdhi.).

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; arrijnë të dallojnë klasat e fjalëve dhe t'i klasifikojnë në pjesë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 9. Ese me temë: "Miku im më i mirë ". Plotësohet tabela me 10 fjalë të ndryshueshme dhe 10 të pandryshueshme. Ushtrimi mund të punohet edhe në programin Word.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: "Besa e Kostandinit" M. Kuteli		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tregimin me ndalesa për t'iu përgjigjur pyetjeve të shkruara; - pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja; - plotëson hartën e tregimit; - ritregon përmbajtjen e përrallës; - analizon strukturën e përrallës në formë dhe përmbajtje; - zbërthen kuptimin gjuhësor të shprehjeve. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>fjala e dhënë, baladë, shqiptar, familja, marrëdhënia motër-vëlla, kodi moral.</p>	
<p>Burimet: teksti "gjuhë shqipe 7, Libri: "Si të shkruajmë ese" B. Musai, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, vepra Mitrush Kuteli</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lexim dhe pyetje; Harta e tregimit; Diskutim.</p>			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: Mësuesi/ja i njuh nxënësit me temën e re të mësimit, autorin e përrallës, Mitrush Kutelin pseudonimi letrar i Dhimitër Paskos, me librin “Tregime te moçme Shqiptare” nga është shkëputur përralla, si dhe me kompetencat që do arrihen këtë orë mësimi.

Hapi II: Titullin e përrallës, mësuesi/ja i shkruan në tabelë. Mësuesi/ja cakton mënyrën se si do të lexohet përralla nga nxënësit. Gjatë të lexuarit, mësuesi/ja për çdo pjesë të përrallës në tabelë shkruan pyetjet:

- Pse ju pëlqen ky tregim?

Përgjigjet e nxënësve mund të jenë:

- Ka elemente të legjendës.

- Ka elemente fantastike.

Kostandini mbajti fjalën e dhënë. Fjala e dhënë është shumë e rëndësishme.

Hapi III: Më poshtë, duke lexuar, në vazhdim shkruhen këto pyetje:

- Cila ishte dëshira e Kostandinit?

- Çfarë i premtoi ai zonjës Mëmë?

- Gjatë leximit të pjesës, në vazhdim shkruhen këto pyetje?

- Çfarë ndodhi gjatë luftës?

- Çfarë kërkoi zonja Mëmë tek varri i Kostandinit .Nxënësit diskutojnë dhe u japin përgjigje pyetjeve të shkruara në tabelë.

Hapi IV: Në vazhdim të leximit të tregimit, mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen:

- Pse u ngrit Kostandini nga varri?

Besa e Kostandinit -> vendi, tema, mesazhi, personazhet, koha, ngjarja. Diskutoni mesazhin/synimin që mund të ketë patur ndërmend autori. Pasi grafiku është plotësuar dhe diskutuar, mësuesi/ja bën vlerësimin e punës së nxënësve.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Dëgjojmë përralla		Situata e të nxënit: Dëgjimi me vëmendje i përrallës së tekstit të lexuar nga mësuesi/ja për të parë sa dëgjues të mirë janë.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ dëgjon me vëmendje përrallën; ❖ e ritregon atë duke qenë sa më afër versionit original; ❖ diskuton rreth personazheve. 			<p>Fjalët kyç: ritregim, dëgjues i vëmendshëm.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare: Teatër</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Dëgjim i drejtuar; Diskutim; Bisedë etj.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve: A ju pëlqejnë përrallat? Sa nga ato që ju kanë treguar gjyshërit a prindërit mbani mend? Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të mbyllin tekstin, të marrin pozicionin e duhur për të qenë dëgjues sa më të mirë dhe lexon përrallën.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbyllja e tekstit mësimor. 			

- Përqendrim në dëgjimin sa më me vëmendje të përrallës.
- Leximi i përrallës së tekstit nga ana e mësuesit/es.
- Ritregimi i ngjarjeve të saj nga ana e nxënësve.
- Listimi i kërkesave të plakës.
- Diskutimi rreth personazheve: plaka, plaku, zogu.
- Formulimi i mesazhit të përrallës.
- Vlerësimi për njëri-tjetrin se sa dëgjues të mirë janë.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: ritregojnë sa më saktë ngjarjen; japin interpretimet e tyre rreth personazheve të përrallës dhe analizojnë gjuhën e saj.

Detyrë shtëpie: Shprehni me shkrim mendimet tuaja. A është grykësia një ves i dëmshëm për njeriun?

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Emri dhe karakteristikat e tij		Situata e të nxënit: Nxënësit të ndarë në grupe plotësojnë pemën e mendimit me njohuritë që dinë për emrin si pjesë e ligjëratës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: Kompetencat e të nxënit: <ol style="list-style-type: none"> zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim për të nxënë një temë, një veprim, aktivitet a detyrë që i kërkohet; ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike; përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme. Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë dhe me shkrim, si dhe me forma të tjera të komunikimit; dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur dhe komenton sipas kërkesës me gojë dhe me shkrim. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon emrat e gjinive të ndryshme në një tekst të dhënë; kthen emrat dhe grupet emërore nga numri njëjës në shumës; përdor në fjali emra në gjini, numër dhe rase të ndryshme. 			Fjalët kyç: emri, gjinia, numri, mbaresa, përcaktori.
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare: TIK


Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pema e mendimit; Të nxënit me këmbime; Praktikë e pavarur; Rishikimi në dyshe.

Përshkrimi kontekstual i situatës

Nxënësit të ndarë në grupe, plotësojnë pemën e mendimit me njohuritë që dinë për emrin si pjesë e ligjëratës.

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në dërrasë. Më pas u kërkon nxënësve që, në dyshe, të plotësojnë pemën e mendimit për emrin, duke dhënë dhe shembuj.



a. Emërton frymorë, objekte, dukuri të natyrës. - Shembuj

b. Janë të përgjithshëm dhe të përveçëm. - Shembuj

c. Janë të gjinisë femërore, mashkullore dhe asnjane. - Shembuj

d. Përdoren në numrin njëjës dhe shumës. - Shembuj

e. Përdoren në 5 rase. - Shembuj

f. Dalin në trajtën e shquar dhe të pashquar. - Shembuj _____

- Nxënësit lexojnë në heshtje informacionin që jepet në libër mbi gjininë e emrit.

- Mësuesi/ja thekson se, për të dalluar gjininë e emrit, duhet që këtë emër ta çojmë në trajtën përfaqësuese (numri njëjës, trajta e shquar, rase emërore), ose të përdoret si një kryefjalë në njëjës, trajta e shquar që t'i përgjigjet pyetjeve: “cili?”, “cila?”, si dhe përcaktorët.

- Mësuesi/ja zhvillon me nxënësit ushtrimin 1 (Praktikë e drejtuar). Fillimisht, nxënësit nënvizojnë emrat, me ndihmën e mësuesit/es ndajnë temën nga mbaresa. Përcaktojnë gjininë e emrave duke i çuar në rasën emërore, trajta e shquar, njëjës, ose duke u mbështetur te fjalët përcaktuese.

Veprimtari praktike

- Në dyshe, nxënësit punojnë ushtrimet 2 - 5 sipas kërkesave (Të nxënit me këmbime). Diskutohen ushtrimet me gjithë klasën.

- Në tekstin e dhënë, në njohuritë e reja, nxënësit nënvizojnë emrat dhe përcaktojnë numrin e tyre.

- Mësuesi/ja shpjegon mënyrat se si formohet numri shumës i emrave. Theksohet që, për të përcaktuar mënyrën se si formohet numri shumës i emrave, atyre u vihet përpara një dhe disa.

- Nxënësit punojnë në libër për zhvillimin e ushtrimeve 7 - 9, sipas kërkesave.

Gjatë diskutimit të ushtrimeve me gjithë klasën përcaktohet dhe mënyra e formimit të numrit shumës të emrit.

(Kujdes! Emri **element** del me dy forma shumësi: **elemente** - secila pjesë që formon një të tërë; **elementë** - njeri, përfaqësues i një shtrese a i një klase shoqërore.)

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën në pavarur, për pjesëmarrjen dhe përgjigjet sipas niveleve.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë gjininë dhe numrin e emrit, si dhe shpjegojnë se si i dallojnë.

Detyrë shtëpie: ushtrimet 6 dhe 10, sipas kërkesave. Klasa ndahet në dy grupe dhe secilit grup i jepet një ushtrim. Mund të paraqesin si detyrë shtëpie një detyrë të bërë në Word, ku të paraqesin në tabelë ndarjen e emrit sipas tri gjinive dhe 4 mënyrat e formimit të numrit shumës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Trajta dhe lakimi i emrave		Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit plotësojnë tabelën e lakimit të emrave.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja <ol style="list-style-type: none"> dallon trajtën, lakimin dhe rasën e emrit; vendos emrat në formën e duhur; përshkruan një ditë të veçantë të jetës së tij duke përdorur emrat në forma të ndryshme. 		Fjalët kyç: emër, trajta e shquar, trajta e pashquar, lakimi I, II, III, rasa.	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”		Lidhja me fushat kurikulare: TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutimi për njohuritë paraprake; Lexim i drejtuar; Marrëdhëniet pyetje-përgjigje.			
Përshkrimi kontekstual i situatës Në dyshe, nxënësit plotësojnë tabelën e lakimit të emrave.			
Veprimet në situatë:			

- Mësuesi/ja ndan klasën në tre grupe dhe secilit prej tyre i jep për detyrë të lakojë nga një emër në të dy numrat dhe dy trajtat, sipas gjinive:

Grupi I

Rasa	Njëjës e pashquar	Njëjës e shquar	Shumës e pashquar	Shumës e shquar
emërore	një mik			
gjinore				
dhanore				
kallëzore				
rrjedhore				

Grupi II

Rasa	Njëjës e pashquar	Njëjës e shquar	Shumës e pashquar	Shumës e shquar
emërore	një këngë			
gjinore				
dhanore				
kallëzore				
rrjedhore				

Grupi III

Rasa	Njëjës e pashquar	Njëjës e shquar	Shumës e pashquar	Shumës e shquar
emërore	një lis			
gjinore				
dhanore				
kallëzore				
rrjedhore				

- Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth pyetjeve:

- Në sa trajta përdoret emri në gjuhën shqipe?

- Si e dallojmë trajtën e shquar dhe të pashquar?

- Në sa lakime ndahen emrat?
- Si e bëjmë ndarjen e emrave në lakime?
- Nxënësit lexojnë në heshtje njohuritë për trajtën dhe lakimin e emrit, duke nënvizuar njohuritë e reja dhe konceptet që nuk i kanë të qarta.
- Mësuesi/ja sqaron pikat kryesore që duhen shpjeguar rastet kur emri përdoret në trajtë të shquar dhe bashkë me nxënësit punojnë ushtrimin 6, sipas kërkesës.
- Nxënësit punojnë në libër ushtrimet 1-5, 7 dhe 8 sipas kërkesave. Pasi i përfundojnë, këmbëjnë librat dhe bëjnë korrigjimet për njëri-tjetrin. Ushtrimet lexohen me zë.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë trajtën e shquar dhe të pashquar; shpjegojnë përdorimin e trajtës së shquar.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 9, sipas kërkesës. Detyra mund të prezantohet në programin Word.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime përmbledhëse për emrin		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja drejton pyetje rreth emrit dhe kategorive të tij gramatikore (Stuhi mendimesh).	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon emrin, përcakton gjininë, numrin dhe rasën; kthen emrat nga numri njëjës në shumës dhe tregon mënyrën e formimit të shumësit; përdor saktë emrat në forma të ndryshme gramatikore. 			Fjalët kyç: emri, numri, trajta, rasa, lakimi.
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare: TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh; Praktikë e drejtuar; Të nxënit me këmbime (punë me grupe).			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja drejton pyetje rreth emrit dhe kategorive të tij gramatikore:

- a. Ç'është emri?
- b. Si i klasifikojmë emrat sipas gjinive?
- c. Si veprojmë për të gjetur gjininë dhe lakimin e emrit?
- d. Si e formojnë numrin shumës emrat?
- e. Kur përdoret një emër në trajtën e shquar?

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe u kërkon dy-tre nxënësve të lexojnë detyrën e shtëpisë.
- Mësuesi/ja drejton pyetje rreth emrit dhe kategorive gramatikore të tij.
- Me nxënësit zhvillon ushtrimin 1 (Praktikë e drejtuar).

Veprimtari praktike

- Mësuesi/ja ndan klasën në gjashtë grupe dhe secilit i jep përkatësisht ushtrimet: 2, 3, 4, 6, 7 dhe 8 të punohen sipas kërkesave. Nxënësit ponojnë 5' për zgjidhjen e ushtrimeve. Më pas ushtrimet diskutohen me gjithë klasën. Ndërkohë, kur një pjesëtar i një grupi lexon ushtrimin, të tjerët plotësojnë librat e tyre, bëjnë korrigjimet përkatëse, nëse është e nevojshme.
- Ushtrimin 5 mësuesi/ja e zhvillon në bashkëpunim me nxënësit. Emrat e dhënë e formojnë shumësin në 2 forma të ndryshme, në varësi të kuptimit të tyre: rreth - rathë, rreth – rrethe; brinjë - brinjët, brinjë – brinjat; grykë - grykët, grykë – grykat; pikë - pikët, pikë - pikat.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; për bashkëpunimin në grup; arrijnë të dallojnë emrat dhe kategoritë e tij gramatikore; kryejnë veprimet e ndryshme në lidhje me kërkesat e dhëna.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 9, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Gjeniu i vogël Stefan Cvajg Ora e parë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Tregon disa nga mbresat që u kanë mbetur nga dëgjimi i muzikës klasike të Moxartit</p> <p>Njih kuptimin e pjesës dhe e vendos atë në kuptimin e së tërës.</p> <p>Shpjegon fjalët e panjohura dhe analizon fragmentin.</p> <p>U përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së saj dhe shpreh qëndrimin e tij.</p> <p>Portretizon personazhin dhe zbërthen karakterin e tij në dy kohë.</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>piano, muzikant, vegël muzikore, kompozitor, gjeni.</p>	
Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletë pune, tabak i bardhë, bojëra uji, materiale nga interneti		Lidhja me fushat kurikulare:	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Veprimtari: Lexim-mendim i drejtuar me tabelë; Punë parapërgatitore.</p>			

Organizimi i orë së mësimi

Hapi I. Njihen nxënësit me titullin dhe autorin e tregimit, të cilat shkruhen në tabelë. I jepet secilit nxënës fleta e punës e përgatitur. U shpjegohet nxënësve se si do të veprojnë më tej. Do të lexojnë tregimin të ndarë në dy pjesë, sipas ndarjes që ka bërë mësuesi/ja. U kujtohet nxënësve që është shumë e rëndësishme të mos e lexojnë përtej pikave të ndalimit. Ata do të bëjnë parashikime dhe pastaj do të lexojnë, për të vërtetuar parashikimet që kanë bërë.

Hapi II. Nxënësit lexojnë titullin e tregimit dhe, mbështetur në të, parashikojnë se për kë flet tregimi. Çfarë do të ndodhë me Moxartin? Pse mendojnë ashtu? Mendimet shkruhen në kolonë.

Hapi III. Nxënësit lexojnë deri te ndalesa e parë, kur të arrijnë deri aty, ata shikojnë parashikimin e tyre në fillim dhe të thonë çfarë ndodhi në të vërtetë. Mendimet e tyre i shkruajnë në kolonë. “Çfarë ndodhi?”

Hapi IV. Mësuesi/ja rishikon parashikimet. Nxënësit sjellin provat që i çojnë në këto parashikime. Nxënësit lexojnë dhe krahasojnë parashikimet e tyre me atë çfarë ndodh me të vërtetë.

Hapi V. Në përfundim, nxënësit krahasojnë parashikimet e fundit që kanë bërë me atë që ndodh në të vërtetë në tregim.

Hapi VI. Kalohet te rubrika “Të kuptojmë përmbajtjen”. Nxënësit tregojnë dy raste: Moxarti fëmijë në pianon e tij; Moxarti në Vjenë në pallatin e Kryedukeshës. Nxënësit punojnë ushtrimet. Tregojnë rolin e babait në formimin e Moxartit. Ilustrime nga teksti. Talenti i Moxartit, muzikanti me famë botërore. Nxënësit mund të dalin në një mesazh, të cilin e shkruajnë në një tabak të bardhë me bojëra uji dhe e afishojnë në muret e klasës.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Gjeniu i vogël Stefan Cvajg Ora e dytë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Përcaktoni karakteristikat për të qenë i talentuar në fushën e artit dhe të muzikës.</p> <p>Tregon raste kur janë njohur me shokë dhe shoqe të talentuara.</p> <p>Plotëson skemën e komunikimit me elementet e dhënë.</p> <p>Liston veçoritë e dialogut midis Moxartit dhe babait të tij, Leopold, duke argumentuar e ilustruar me pjesë nga teksti.</p> <p>Zbulon mesazhin e pjesës.</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>piano, muzikant, vegël muzikore, kompozitor, gjeni.</p>	
Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletë pune, tabak i bardhë, bojëra uji, materiale nga interneti.		Lidhja me fushat kurikulare:	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Veprimtari: lexim-mendim i drejtuar me tabelë; Punë parapërgatitore.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Mësimi nis me rubrikën *Të kuptojmë tekstin*. Punohen ushtrimet dhe punohet në grup. Nxënësit argumentojnë çdo përgjigje të zgjedhur. Komentojnë dhe interpretojnë mbi temën, idenë dhe personazhet e tregimit.

Ushtrimet mbi *gjuhën dhe stilin*.

Nxënësit përqendrohen në fragment në detajet, fjalët kyç dhe figurat stilistikore, të cilat i nënvizojnë në tekst.

Nxënësit sjellin shembuj nga teksti, por, për çdo figurë stilistikore, nxënësi rikujton konceptin e figurës përkatëse.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të tregojnë se ç'është mesazhi. Dëgjohen mendimet e nxënësve e më pas lexojnë informacionin e dhënë për mesazhin. Nxënësit gjejnë në mënyrë individuale idenë e pjesës.

E shkruajnë idenë në fletore e më pas e lexojnë. Pasi dëgjohen disa ide, ideja më e saktë shkruhet në tabelë nga mësuesi/ja.

Mësuesi/ja si punë përgatitore ka përgatitur disa fleta pune për çdo nxënës të cilat përmbajnë pyetje mbi fragmentin në tekst.

- Zbuloni karakteristikat e dialogut që zhvillohet midis personazheve, mënyrën e përjetimit emocional të Moxartit gjatë rritjes së tij. Nxënësit përgjigjen për pyetjet në fletën e punës:

- Formuloni mesazhin që përcjell ky fragment.

- Bëni komentin tuaj rreth tij.

- Gjeni figurat letrare dhe zbërtheni kuptimin stilistikor të tyre.

Mësuesi/ja dëgjon me vëmendje përgjigjen e nxënësve dhe nxit debatin midis tyre, mendimin kritik e krijues.

Për çdo përgjigje, mësuesi/ja shënon në tabelë pikat kryesore dhe në fund bën përmbledhjen e çdo pyetjeje.

Mësuesi/ja hap pas hapi vlerëson dhe motivon nxënësit aktive duke përcaktuar fazat e angazhimit të tyre.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet, vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime në tekstin mësimor.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ç'është eseja? Ora parë e mësimit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përkufizon çfarë është eseja; - dallon përdorimin e gjuhës në këto tekste; - zbërthen elementet e strukturës dhe të përmbajtjes; - analizon esenë në formë dhe përmbajtje. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>ese, strukturë, përmbajtja, teza, argument, detaje, paragrafe.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, libri “Si të shkruajmë ese” B. Musai, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutojmë; Punë në çifte; Shkrimi komentues.</p>			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: Mësuesi/ja i njeh nxënësit me temën e re të mësimit si dhe me kompetencat që do realizohen së bashku brenda orës.

Mësuesi/ja shpjegon se tek eseja e rëndësishme është struktura e saj (Mësues/ja e paraqet grafikisht strukturën në tabelë).

PYETJE:

Ç'kuptojmë me strukturë?

Ç'kuptojmë me paragrafë?

Mësues/ija ngre pyetjet dhe çështje për diskutim, i drejton nxënësit te shembulli që ka përzgjedhur.

U thotë të lexojnë me vëmendje esenë të paraqitur në videoprojektor dhe të dallojnë strukturën e saj: hyrjen – zhvillimin- mbylljen

Hapi II: Nxënësit plotësojnë grafikun e paraqitur në tabelë me informacionet e zbuluara nga teksti i esesë.

Struktura→ Hyrja: paraqet problemin, ngre pikëpyetje mbi problemin.

 Zhvillimi: zbërthim i plotë i temës nga ana ideore.

 Mbyllja: konkluzionet dhe përfundimet e temës.

Secili element është i ndarë me paragrafë dhe bëhet i dallueshëm sepse paragrafi fillon me kryeradhë.

Pohimet e tyre nxënësit i ilustronë me shembuj të marra nga eseja.

Hapi III: Nxënësit në këtë hap punojnë në çift.

Ata krahasojnë esenë ku dallojnë strukturën e saj: HYRJEN - ZHVILLIMIN - MBYLLJEN.

Për secilin nga këto elemente të structures, nxënësit i ngjyrosin ato me ngjyra të ndryshme për t'i dalluar.

Hapi IV: Mësuesi/ja vlerëson punën e tyre.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese me titull: “Nëse do të mund të isha dikush tjetër, do të doja të isha...”

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ese: “Këshilla mbi artin e të shkruarit”, Faik Konica		Situata e të nxënit: Punë me tekstin joletrar	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Përcakton karakteristikat e llojit të tekstit.</p> <p>Zbërthen ndërtimin gjuhësor të tekstit.</p> <p>Analizon esenë në formë dhe përmbajtje.</p> <p>Reflekton mbi mesazhet që përcjell autori.</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>strukturë, këshilla, art i të shkruarit, përfundime, ide, përmbajtje.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, materiale nga interneti, informacione mbi llojet e esëve, ese të Faik Konicës, tabela, shkumësa me ngjyra.</p>		<p>Lidhja me fushat kurrikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Përmbledhje e strukturuar; Hartë idesh; Diskutim.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Punë parapërgatitore</p> <p>Mësuesi/ja përgatit 4 skeda (8 x 10cm) në të cilat fton nxënësit të plotësojnë me informacion pyetjet e shkruara aty.</p> <p>SKEDA 1 – rikujtoni ç’është eseja.</p> <ul style="list-style-type: none"> - elementet përbërës të saj <p>SKEDA 2 - struktura e esesë: <u>HYRJE-ZHVILLIM- MBYLLJE</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërtimi ideor i esesë <p>SKEDA 3 – sintaksa e përdorur në një ese</p>			

- stili dhe origjinaliteti

SKEDA 4 - organizimi i esesë

-tema, ideja, mesazhi

Informacioni i hulumtuar nga mësuesi/ja përdoret në fillim të orës së mësimit. Këto skeda u shpërndahen nxënësve para se mësuesi/ja t'i njohë me temën e re.

Hapi I. Mësuesi/ja i njeht nxënësit me temën e re, të cilën e shkruan në tabelë. Gjatë kësaj kohe, nxënësit lexojnë informacionin në skeda. Mësuesi/ja bën një përmbledhje të strukturuar të mësimit mbi të dhënat kryesore që lidhen me përmbajtjen e esesë. Nxënësit lexojnë njëri pas tjetrit skedat dhe plotësojnë çdo pyetje me njohuri të marra gjatë orës së mësimit mbi esenë.

Hapi II. Nxënësit lexojnë esenë e Konicës dhe, duke u nisur nga pyetjet e skedave, bëjnë ilustrimin e tyre me informacionin nga eseja: “Ca këshilla mbi artin e të shkruarit “. Plotësojnë konceptet e hartës me ilustrime nga eseja.



Hapi III. Nxënësit diskutojnë mbi elementet e esesë dhe i shpjegojnë konceptet së bashku nën udhëheqjen e mësueses/it.

Ilustrojnë nga eseja elementet e strukturës, zërthimin ideor, stilin dhe origjinalitetin, sintaksën e drejtshkrimit.

Hapi IV. Me anë të tekstit të esesë mësuesi/ja u kërkon nxënësve të zërthejnë skemën e komunikimit:

dërguesi-marrësi-kanali-kodi-referenti-mesazhi.

Secili nga këto elemente ilustrohet me tekstin e dhënë.

Mësuesi/ja bën vlerësimin e nxënësve të cilët ishin aktive gjatë orës së mësimit.

Motivon nxënësit që u aktivizuan dhe në përgatitjen e skedave.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Shkruani një nga ese ku të shpjegoni pse është i rëndësishëm ndikimi i artit dhe kulturës në formimin tuaj.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Të shkruajmë një ese		Situata e të nxënimit: Shkruajmë një tekst joletrar	
<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zbaton elementet e strukturës së esesë. - Dallon llojet e eseve dhe karakteristikat e tyre. - Shkruan të gjitha llojet e eseve. - Respekton formën dhe përmbajtjen e esesë. - Shkruan pa gabime drejtshkrimore. 			<p>Fjalët kyçe:</p> <p>ese, përmbajtje, strukturë, paragraf, mesazh.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor “Gjuha Shqipe 7”, llojet esesh, modele, rregullat e shkrimit të esesë dhe libri: "Të shkruajmë ese"</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Punë në grupe; Diskutim; Konkurs.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimimit</p> <p>Hapi I: Ndahen nxënësit në grupe. Më pas jepen detyra për secilin nxënës brenda grupit.</p> <p>Mësuesi/ja të marrë parasysh kohën që u duhet nxënësve për të përgatitur materialet që u kërkohen. Mësuesi/ja i kujton secilit nxënësi karakteristikat e esesë, të cilat duhet t’i zbatojë. Këto karakteristika, mësuesi/ja i shkruan në tabelë:</p>			

Nxënësi 1 - Shkruan një ese letrare. Nxënësi

2 - Shkruan një ese përshkruese. Nxënësi 3

- Shkruan një ese argumentuese.

Mësuesi/ja rekomandon disa tema për esetë dhe i shkruan ato në tabelë.

Hapi II: Kjo etapë zhvillohet në dy faza: Faza e parë - Grupet kanë të qartë llojet e esëve që do të shkruajnë dhe karakteristikat për secilën. Struktura e esesë është e qartë: hyrje, zhvillim, mbyllje. Nxënësit e zbatojnë këtë strukturë në esetë e përcaktuara. Secili grup jep idenë që ka për zbërthimin e temës së shkruar në tabelë nga mësuesi/ja, mënyrën se si do të punojë me temën.

Komenton hapat e të shkruarit të esesë, të cilat janë të shkruara në një tabak letre, të vendosura në tabelë. Secili grup punon për të shkruar esenë në mënyrë të pavarur.

Hapi III: Faza e dytë - Grupet tashmë e kanë përfunduar punën e tyre dhe esetë janë gati. Mësuesi/ja zhvillon një konkurs për të zgjedhur punimin e hartuar më bukur e në mënyrë sa më interesante, zgjidhen anëtarët e jurisë (nxënësit mund të merren edhe nga klasat e tjera paralele për të qenë sa më objektiv në vlerësimin e tyre). Përfaqësuesi i secilit grup prezanton esenë, të cilën më pas e afishon në muret e klasës ose në tabelë. Në fund, juria shpall fitues grupin që ka punuar më mirë, duke mos harruar të falënderojë të gjithë nxënësit për përkushtimin e realizimit të esesë.

Mësuesi/ja bën konkluzionet e orës së mësimit dhe motivon nxënësit për aktivizimin në të gjitha etapat.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese me temë: “Dashuria për prindërit e mi është dashuri e madhe”.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Mbiemri		Situata e të nxënit: Nxënësit lexojnë tekstin në dyshe, nënvizojnë mbiemrat dhe plotësojnë kolonën Di të tabelës Di-Dua të di-Mësova më shumë me njohuritë që kanë rreth mbiemrit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon mbiemrat; përshtat mbiemrat me emrat; shpjegon si formohen mbiemrat e gjinisë femërore dhe mbiemrat në numrin shumës. 		Fjalët kyç: mbiemë, gjini, numër, përshtatje.	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”		Lidhja me fushat kurikulare: TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Di-Dua të di-Mësova më shumë; Praktikë e pavarur; Rishikim në dyshe.			
Përshkrimi kontekstual i situatës Nxënësit lexojnë tekstin në dyshe, nënvizojnë mbiemrat dhe plotësojnë kolonën Di të tabelës Di-Dua të di-Mësova më shumë me njohuritë që kanë			

rreth mbiemrit.

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit. Shkruan temën në dërrasë dhe pyet nxënësit se ç'është mbiemri. Përkufizimin e shkruan në dërrasë. U thotë nxënësve të lexojnë tekstin në fillim të mësimit, të nënvizojnë mbiemrat dhe të flasin për ato njohuri që dinë rreth mbiemrit. Mësuesi/ja plotëson në dërrasë pjesën Di të tabelës Di-Dua të di-Mësova më shumë. Nxënësit plotësojnë në fletore.

- Nxënësit shkruajnë në fletore pyetje që do të donin t'i sqaronin për mbiemrin, te kolona Dua të di, pyetjet më pas lexohen me zë. Mësuesi/ja zgjedh disa pyetje dhe i shkruan në dërrasë.

- Nxënësit lexojnë mësimin për mbiemrin dhe shkruajnë njohuritë e reja në kolonën Mësova më shumë. Njohuritë diskutohen me gjithë klasën. Diskutohet për ndonjë paqartësi që kanë nxënësit, më pas ata japin shembuj për çdo rast të dhënë në mësimit, si për: formimin e gjinisë femërore të mbiemrave, formimin e numrit shumës dhe për përshtatjen me emrat.

Veprimtari praktike

- Në dyshe punohen ushtrimet 1, 2, 3 në libër, sipas kërkesave. Nxënësit këmbëjnë librat dhe bëjnë korrigjimen për punët e njëri-tjetrit. Ushtrimet diskutohen me gjithë klasën.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë mbiemrat; flasin për kategoritë e tyre gramatikore; shpjegojnë mënyrën e formimit të numrit shumës, gjinisë femërore.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 4, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

<p>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: 3</p>	<p>Klasa: VII</p>
<p>Tema mësimore: Shkallët e mbiemrit</p>		<p>Situata e të nxënimit: Mësuesi/ja prezanton në PowerPoint pamje nga mali i Korabit, Dajtit dhe Everestit. Nxënësit ndërtojnë fjali, ku të krahasojnë këto male me njëri-tjetrin (Në mungesë të pajisjeve të informatikës, shkruhen fjalitë e mëposhtme në dërrasë: Drita ka një vëlla të vogël. Vëllai i Dritës është shumë i shkathët. Beni është më i aftë se Petriti. Beni është po aq i aftë sa Petriti Beni është djalë shumë i këndshëm. Kjo bluzë është borë e bardhë.)</p>	
<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> dallon shkallët pohore, krahasore e sipërore të mbiemrit; shpjegon se si jepet cilësia në secilën prej tyre; 		<p>Fjalët kyç: mbiemër, shkallë pohore, krahasore, sipërore.</p>	

<p>3. përdor mjetet me të cilat ndërtohen shkallët krahasore e sipërore të mbiemrit; 4. përdor drejt në fjali mbiemra në shkallën pohore, krahasore e sipërore.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”</p>	<p>Lidhja me fushat kurikulare: TIK, Gjeografi</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë; Shpjegim; Tabela e koncepteve.</p>	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja prezanton në PowerPoint pamje nga mali i Korabit, Dajtit, Everestit. Nxënësit ndërtojnë fjali ku të krahasojnë këto male me njëri-tjetrin, duke përdorur lidhëzat më... sesa, jo aq... sa, më ... nga (Në mungesë të pajisjeve të informatikës, shkruhen fjalitë në dërrasë.</p> <p>Drita ka një vëlla të vogël. Vëllai i Dritës është shumë i shkathët. Beni është më i aftë se Petriti. Beni është po aq i aftë sa Petriti Beni është djalë shumë i këndshëm. Kjo bluzë është borë e bardhë.).</p> <p>Për secilën fjali, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të tregojnë se si është dhënë cilësia e emërtuar nga mbiemri. P.sh.: në fjalinë e pare, nxënësit kanë dalluar mbiemrin e ëmbël dhe shpjegojnë se ky mbiemër tregon thjesht një cilësi (pa bërë asnjëlloj krahasimi).</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pas këtyre përgjigjeve ndërhyjnë mësuesi/ja duke sqaruar se, të gjithë mbiemrat që japin thjesht cilësi, pa bërë asnjëlloj krahasimi, janë në shkallën pohore. - Kërkohet nga nxënësit të formojnë fjali duke përdorur mbiemra të ndryshëm në shkallën pohore. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe me dy shkallët e tjera. - Tërheqim vëmendjen në mënyrë që mësuesi/ja të tregojë kujdes në shkallën krahasore, për ta shpjeguar atë sa më qartë: <ul style="list-style-type: none"> a. dy anët e krahasimit: kur cilësitë që shprehin mbiemrat në të dyja anët janë të njëjta, kur njëra cilësi është më e lartë se cilësia në anën tjetër, kur njëra cilësi është më e ulët se ajo në anën tjetër; b. mjetet që shërbejnë për të ndërtuar shkallën krahasore dhe sipërore. Kështu, për shkallën krahasore kemi: aq ... sa, më ... se, më pak ... se; për shkallën sipërore: shumë, jashtëzakonisht, mjaft, tepër etj. - Së fundi, mësuesi/ja së bashku me nxënësit plotësojnë tabelën e konceptit për shkallët e mbiemrit. 	

Shkalla pohore	Shkalla krahasore	Shkalla sipërore	Veprimtari praktike Punohe n
Mbiemri në shkallën pohore shpreh thjesht një cilësi të emrit, pa e krahasuar atë me një qenie a send tjetër.	Cilësia e një qenieje a sendi krahasohet me cilësinë e një qenie a të një sendi tjetër. a. krahasore e sipërisë (më... sesa) b. krahasore e barazisë (po aq... sa) c. krahasore e ultësisë (më pak.... se)	Mbiemri e jep cilësinë në shkallë shumë të lartë, pa e krahasuar me cilësi të ndonjë sendi apo frymori tjetër: • Shumë, jashtëzakonisht, mjaft, tepër etj., + një mbiemër. • Mbiemra që kanë kuptim sipëror: i jashtëzakonshëm, i pafund, i paanë. • Shprehje të tipit: borë i bardhë, flakë i kuq, dyllë i verdhë etj.	

ushtrimet 1-3 në tekst. Për ushtrimet 1 dhe 3, mësuesi/ja mund të përdorë tabelën e mëposhtme:

Mbiemri	Pohore	Krahasore	Sipërore
e re shumë e bardhë	+		+

Ushtrimi 2 plotësohet në libër sipas kërkesës.

Në përfundim të çdo ushtrimi diskutohen përgjigjet e dhëna nga nxënësit, të cilat plotësohen nëse është e nevojshme dhe vlerësohen nga mësuesi/ja.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë mbiemrin; përcaktojnë shkallën dhe shpjegojnë si janë formuar.

- **Detyrë shtëpie:** ushtrimi 4. Nxënësi mund ta punojë ushtrimin në programin **Word**.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për mbiemrin		Situata e të nxënit: Nxënësit plotësojnë në dyshe pemën e mendimit, ku në qendër është fjala MBIEMRI, duke shfrytëzuar informacionin e marrë gjatë dy temave të fundit mësimore.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj, dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon mbiemrat në fjalitë e dhëna duke përcaktuar shkallën në të cilën janë përdorur; përcakton saktë gjininë, numrin dhe rasën e mbiemrave; përshkruan ditëlindjen e tij/saj duke përdorur mbiemra në shkallë të ndryshme. 			Fjalët kyç: mbiemër, gjini, numër, rasë, shkallë.
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pema e mendimit; Tabela e koncepteve; Marrëdhëniet pyetje – përgjigje; Rishikim në dyshe.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Nxënësit plotësojnë në dyshe pemën e mendimit, ku në qendër është fjala MBIEMRI, duke shfrytëzuar informacionin e marrë gjatë dy temave të fundit mësimore.

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të plotësojnë pemën e mendimit, ku në qendër është fjala MBIEMRI. Nxënësit punojnë individualisht në fletoret e tyre, duke shfrytëzuar informacionin e marrë gjatë dy temave të fundit mësimore.
- Pas përfundimit të punës, nxënësit flasin për informacionin e përfshirë.

Veprimtari praktike

Punohen ushtrimet 1-5 në tekst. Për ushtrimin 1, pasi t'i kenë vendosur mbiemrat në kllapa në formën e duhur, mësuesi/ ja kërkon nga nxënësit të përcaktojnë me gojë: gjininë, numrin, rasën dhe shkallën.

Në ushtrimin 2, nxënësit, pasi nënvizojnë mbiemrat në fjalitë e dhëna, plotësojnë tabelën e mëposhtme për të përcaktuar shkallët e tyre.

Mbiemri	Pohore	Krahasore	Sipërore

Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe me ushtrimin 3. Në ushtrimin 4, nxënësit dallojnë mbiemrat dhe bëjnë analizën e tyre duke i vendosur në tabelën e koncepteve:

Mbiemri	I nyjshëm/i panyjshëm	Gjinia	Numri	Rasa	Shkalla

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë mbiemrat; përcaktojnë gjininë, numrin, rasën dhe shkallën; argumentojnë përgjigjet e tyre.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 6, sipas kërkesës në libër.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Letra formale		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja prezanton letrën formale në tekst duke kërkuar që nxënësit të dallojnë strukturën e saj dhe mënyrat e dërgimit.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ liston llojet e letrave sipas karakteristikave të tyre; ❖ dallon elementet e strukturës së letrës formale; ❖ përcakton rregullat e shkrimit të një letre formale; ❖ diskuton rreth mënyrave të dërgimit të letrave formale personave që duam. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>letër formale, strukturë, postë elektronike, person zyrtar.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, modele letrash zyrtare</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Edukim figurativ, TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lexim i drejtuar; Diskutim.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja prezanton letrën formale në tekst duke kërkuar që nxënësit të dallojnë strukturën e saj dhe mënyrat e dërgimit. Gjithashtu, diskutohet rreth rregullave që duhet të ndjekim kur shkruajmë një letër zyrtare.</p> <p>Veprimet në situatë:</p>			

- Prezantimi i letrës zyrtare në tekst.
- Përcaktimi i strukturës së letrës zyrtare kur dërgohet me postë dhe kur dërgohet me postë elektronike.
- Diskutim rreth rregullave që duhet të kemi parasysh kur shkruajmë një letër zyrtare.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës


Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: dallojnë formën dhe gjuhën e përshtatshme në një letër zyrtare; përcaktojnë mënyrat e dërgimit të një letre zyrtare dhe personave që mund t'iu dërgohet ajo.

Detyrë shtëpie: Shkruani një letër zyrtare ose personale sipas dëshirës, duke patur kujdes në veçoritë e secilës.

Planifikimi ditor (ditar)

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë letër formale		Situata e të nxënimit: Shkrimi i një letre zyrtare drejtuar stafit drejtues në shkollë ose kryetarit/es së Bashkisë.	
<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ liston llojet e letrave sipas karakteristikave të tyre; ❖ dallon elementet e strukturës së letrës formale; ❖ përcakton rregullat e shkrimit të një letre formale; ❖ shkruan një letër zyrtare. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>letër formale, strukturë, postë elektronike, zyrtar.</p>	
<p>Burimet: teksti mësimor, internet, kompjuteri</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Edukim figurativ, TIK</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lexim i drejtuar; Diskutim</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Lidhja me njohuritë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilat janë elementet e strukturës së një letre zyrtare? - Kujt mund t'i drejtohet ajo? - Cilat janë mënyrat e dërgimit të saj? <p>Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të lexojnë tri-katër letra formale ose personale që kishin për të bërë si detyrë shtëpie. Ata dallojnë strukturën që ka secila prej tyre.</p> <p>Veprimet në situatë:</p>			

- Leximi i tri-katër letrave personale a zyrtare.
- Përcaktimi i strukturës së letrës zyrtare dhe asaj personale.
- Plotësimi i Diagramit të Venit për të bërë krahasimin e tyre.
- Diskutim rreth rregullave që duhet të kemi parasysh kur shkruajmë një letër zyrtare.
- Shkrimi i letrës zyrtare nga nxënësit.
- Leximi i disa letrave.
- Dërgimi me email i dy-tri letrave, ku janë ngritur probleme të ndryshme drejtuar stafit të shkollës.



Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: dallojnë strukturën e letrës zyrtare, përdorin gjuhën e përshtatshme për këtë lloj letrë, shkruajnë një letër zyrtare dërguar stafit drejtues ose kryetarit/es së Bashkisë.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Përemri dhe llojet e tij	Situata e të nxënit: Nxënësit ndërtojnë në dyshe fjali, duke plotësuar foljet me përemra të ndryshëm.		
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon përemrat dhe përcakton llojin e tyre; plotëson fjalitë dhe zëvendëson gjymtyrët emërore me format e sakta të përemrave vetorë; përshkruan shokun ose shoqen duke përdorur përemra të ndryshëm. 		Fjalët kyç: përemër, përemër vetor, pronor, lidhor, dëftor, pyetës, i pacaktuar, vetvetor.	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”		Lidhja me fushat kurikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim për njohuritë paraprake; Të nxënit me këmbime; Tabela e koncepteve.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

a) Nxënësit ndërtojnë në dyshe fjali duke plotësuar foljet me përemra të ndryshëm dhe formojnë fjali me ta:

_____ vizatova _____

_____ këndoje _____

_____ ftoi _____

_____ përgatitën _____

b) Nxënësit përsëritin përemrat që kanë mësuar në klasën e gjashtë.

Veprimet në situatë:

Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në tabelë. Më pas fton nxënësit të listojnë në fletore llojet e përemrave që kanë mësuar.

Mësuesi/ja i shkruan në tabelë duke dhënë disa shembuj për secilin.

- Nxënësit plotësojnë foljet e dhëna me nga dy përemra të përdorur para e prapa foljes dhe ndërtojnë fjali.

- Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin dhe nënvizojnë çështjet kryesore.

- Mësuesi/ja drejton pyetjet:

- Çfarë tregon përemri vetor?
- Cilat janë dallimet e përemrave vetorë të vetës së parë dhe të dytë nga përemrat e vetës së tretë?

Veprimtari praktike

Nxënësit punojnë ushtrimet 1-4.

Ushtrimet 1 dhe 4 mund të punohen në tabelë:

Përemri	Lloji
ty	vetor
unë	vetor
e imja	pronor

Pasi nxënësit përfundojnë rishikimin në dyshe të ushtrimeve, diskutohen me gjithë klasën.

Vlerësimi: për përgjigjet në dyshe, punën e pavarur, diskutimet, vlerësimi i punës së njëri-tjetrit.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë përemrat e llojeve të ndryshme dhe i përdorin në formën e duhur.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 5, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja prezanton në PowerPoint tabelën e lakimit të përemrave vetorë. Në mungesë të videoprojektorit, tabela ndërtohet në dërrasë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara; shpjegon si janë formuar trajtat e shkurtra të bashkuara; përdor saktë trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara në gjuhën e folur dhe të shkruar. 			Fjalët kyç: përemri vetor, lakim, trajtë e shkurtër, trajta të shkurtra të bashkuara, dhanore, kallëzore.
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Prezantim në PowerPoint; Të nxënit me këmbime (punë në grup); Shpjegim i kombinuar me diskutim; Praktikë e drejtuar; Praktikë e pavarur; Tabela e koncepteve.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja prezanton në PowerPoint tabelën e lakimit të përemrave vetorë (Në mungesë të videoprojektorit, tabela ndërtohet në dërrasë, ose i udhëzon nxënësit të shohin tabelën e paraqitur në libër.).

- Nxënësit, të ndarë në grupe prej 4-5 vetash, punojnë për të nxjerrë veçoritë e përemrit vetor sipas tabelës së lakimit.

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në dërrasë. I udhëzon nxënësit që të punojnë në grupe për të nxjerrë veçoritë e përemrit vetor sipas tabelës së lakimit. Ndërkohë, në dërrasë ndërton tabelën për rasën dhanore dhe kallëzore:

dhanore	mua më	ty të	atij i	asaj i	neve na	juve ju	atyre u	atyre u
kallëzore	mua më	ty të	atë e	atë e	ne na	ju ju	ata i	ato i

Qarkon trajtat e shkurtra të rasës dhanore: më, të, i, na, ju, u dhe vetëm trajtat e vetës së tretë njëjës dhe shumës të rasës kallëzore: e, i.

Shpjegon ndërtimin e trajtave të shkurtra të bashkuara duke theksuar:

a. trajtat e shkurtra të bashkuara ndërtohen gjithmonë nga një trajtë e rasës dhanore dhe e dyta e rasës kallëzore;

b. kur shpjegohet si janë formuar trajtat e shkurtra të bashkuara gjithmonë i drejtojmë foljes pyetjet: pyetja e rasës dhanore, “Kujt?”; rasës kallëzore, Kë?;

c. për trajtat e shkurtra të bashkuara: ia, jua, ua formohen nga trajtat i + e, ju + e, u + e kur kundrinori i drejtë është në numrin njëjës, por i + i, ju + i, i + i kur kundrinori i drejtë është në numrin shumës.

Veprimtari praktike

- Mësuesi/ja punon së bashku me nxënësit ushtrimin 1. U kërkohet nxënësve të qarkojnë trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara.

Përcaktohet veta, numri dhe rasa (gjinia për vetën e tretë).

- Nxënësit punojnë në dyshe për zgjidhjen e ushtrimeve 2 dhe 3. Ushtrimet diskutohen me gjithë klasën.

- Mësuesi/ja punon ushtrimin 4 me nxënësit. Nxënësit gjejnë trajtat e shkurtra të bashkuara, nën drejtimin e mësuesit/es, që i plotëson në tabelë dhe nxënësit i shkruajnë në fletore, më pas shpjegojnë si janë ndërtuar ato.

- Po, m'i more javën e kaluar. Kujt ia more? Mua më. Kë më more? Ato (florinjte) i.

Ushtrimi 5 mund të punohet në tabelën e koncepteve:

Trajta e shkurtër	Veta	Numri	Rasa	Gjinia për vetën e tretë
Ku <u>i</u> ke sytë? (Kë?)	III	shumës	kallëzore	mashkullore

I foli bahçevani (Kujt)	III	njëjës	dhanore	mashkullore	
<p>Ushtrimi diskutohet me gjithë klasën. Në qoftë se nxënësit nuk arrijnë ta përfundojnë ushtrimin, u kërkohet ta përfundojnë në shtëpi.</p>					
<p>Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.</p> <p>Vlerësimi i situatës</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara; përcaktojnë vetën, numrin, rasën dhe gjininë; shpjegojnë si janë formuar trajtat e shkurtra të bashkuara; i përdorin saktë në gjuhën e folur dhe të shkruar.</p> <p>Detyrë shtëpie: ushtrimi 6.</p>					

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

<p>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: 3</p>	<p>Klasa: VII</p>
<p>Tema mësimore: Ushtrime për trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor</p>		<p>Situata e të nxënit: Mësuesi/ja drejton pyetje rreth njohurive që kanë nxënësit për trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara (Stuhi mendimesh).</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.) duke ndërvepruar në grup ose në klasë. <p>Kompetenca personale: Nxënësi/ja, merr pjesë, drejton punën në grup, ndihmon pjesëtarët e grupit, raporton për punën në grup.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> dallon trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara; shpjegon si janë formuar trajtat e shkurtra të bashkuara; përdor saktë trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara në gjuhën e folur dhe të shkruar. 		<p>Fjalët kyç: trajta të shkurtra të bashkuara, dhanore, kallëzore, veta, numri, rasa, “Kujt?”, “Kë?”.</p>	
<p>Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh; Praktikë e drejtuar; Tabela e koncepteve; Të nxënit me këmbime (Punë në grup); Diskutim.</p>			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja drejton pyetjet rreth njohurive që kanë nxënësit për trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara (Stuhi mendimesh).

Veprimet në situatë:

Mësuesi/ja drejton pyetjen e mëposhtme:

Në cilat rasa përemri vector del me trajtë të shkurtër?

Cilat trajta të shkurtra bashkohen për të formuar trajtat e shkurtra të bashkuara?

Me cilat pyetje bëjmë zberthimin e trajtave të shkurtra të bashkuara?

Ku e kanë pozicionin trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara kur folja është në kohën e ardhme, në mënyrën lidhore, kushtore dhe në mënyrën urdhërore? Në dërrasë, mësuesi/ja ndërton tabelën:

Trajta e shkurtër	Veta	Numri	Rasa	Gjina për vetën e tretë
Skënderbeu e pyeti. (Kë?)	III	njëjës	kallëzore	mashkullore
Milo Shini i tha me gjysmë goje: (Kujt?)	III	njëjës	dhanore	mashkullore

Mësuesi/ja bashkë me nxënësit punojnë ushtrimin 1. U kërkon nxënësve të qarkojnë trajtat e shkurtra dhe të përcaktojnë nëpërmjet pyetjeve vetën, numrin, rasën dhe gjininë, për vetën e tretë, dhe plotësojnë tabelën e koncepteve.

Veprimtari praktike

Pasi mbarojnë ushtrimin i ndan nxënësit në grupe dhe u cakton detyrat:

Grupi I - ushtrimet 2 dhe 7. Grupi II - ushtrimet 3 dhe 8. Grupi III - ushtrimet 4 dhe 6. Grupi IV - ushtrimin 5.

U lihet nxënësve 5' - 8' kohë.

Më pas ushtrimet diskutohen me gjithë klasën. Mësuesi/ja kujdeset që, gjatë përgjigjeve, të aktivizojë të gjithë nxënësit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara; përcaktojnë vetën, numrin, rasën dhe gjininë; shpjegojnë si janë formuar trajtat e shkurtra të bashkuara; i përdorin saktë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 9.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Folja në mënyrën kushtore		Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit ndërtojnë fjali për situatën e dhënë në fisha.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon foljet në mënyrën kushtore; zgjedhon foljet në të dyja kohët e kësaj mënyre; përdor saktë foljet në mënyrën kushtore në gjuhën e folur dhe të shkruar. 		Fjalët kyç: folje, mënyra kushtore, kushti, rrjedhimi i mundshëm, koha, veta, numri.	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”		Lidhja me fushat kurikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë; Shpjegim i kombinuar me diskutim; Praktikë e pavarur; Rishikim në dyshe.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja shpërndan në fisha situatën: Dje luante Kombëtarja Shqiptare, kështu që Miri, si i apasionuar pas futbollit, e kaloi gjithë pasditen duke diskutuar me dy shokët e tij. Ai harroi fare që të nesërmen kishte shkollë dhe, për më tepër, kishte provim në matematikë. "Do ngrihem nesër herët të përsëris diçka", - mendoi ai në darkë. Mirëpo në mëngjes nuk i doli gjumi. Kuptohet, në provim nuk bëri asgjë. Tani ai ndihej i penduar që e kishte kaluar kohën kot dje.

Ndërtoni fjali ku të përdorni lidhëzat: po, po qe se, në qoftë se, duke përdorur folje në kohën e pakryer dhe më se të kryer të mënyrës lidhore (p.sh.: të mësoja - e pakryer, të kisha mësuar - më se e kryer).

(Në mungesë të fishave, mësuesi/ja e shkruan situatën në një tabak të bardhë ose cakton një nxënës ta shkruajë në dërrasë para se të fillojë mësimi.)

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mëimit dhe e shkruan në tabelë.
- Shpërndan fishat dhe udhëzon nxënësit që të punojnë në dyshe sipas kërkesës së dhënë.
- Nxënësit lexojnë fjalitë dhe mësuesi/ja zgjedh disa prej tyre dhe i shkruan në dërrasë.
- Mësuesi/ja qarkon lidhëzat kushtore dhe nënvizon foljet në lidhore dhe kushtore.
- Nxënësit lexojnë në heshtje njohuritë për mënyrën kushtore. Plotësojnë tabelën e ushtrimit 2.
- Për fjalitë e shkruara në dërrasë përcaktojnë kushtin dhe përfundimin e mundshëm. Mësuesi/ja thekson që mënyra kushtore dhe lidhore, të dyja, tregojnë veprime të mundshme, në ndryshim nga mënyra dëftore që tregon veprime, gjendje a situata të sigurta.

Veprimtari praktike

- Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimet 1, 3 dhe 4 sipas kërkesës. Për ushtrimin 4 plotësojnë në fletore tabelën e koncepteve, të cilën mësuesi/ja e ndërton në dërrasë.

Folja	Mënyra	Koha	Veta	Numri
do të kisha ardhur	kushtore	e kryer	veta I	njëjës

Ushtrimet diskutohen me të gjithë klasën.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë foljet në mënyrën kushtore; përcaktojnë kohën vetën dhe numrin. **Detyrë shtëpie:** ushtrimi 5, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: “Gjaku i arbërit” (ora e parë)		Situata e të nxënimit: Shfaqje në projektor e fragmentit të dramës “Gjaku i arbërit” (për 10’) dhe rikujtimi i njohurive të marra në klasën e gjashtë për veçoritë e tekstit dramatik.	
<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ portretizon personazhet kryesorë; ❖ tregon vendin dhe kohën kur zhvillohet ngjarja; ❖ shpjegon kuptimin e fjalëve dialektore; ❖ përshkruan me ndihmën e fjalëve kyç atmosferën e dasmës; ❖ interpreton me emocion rolin e caktuar. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>besë, arbër, luftë, troje.</p>	
<p>Burimet: teksti mësimor, CD-ja me materiale</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Teatër, TIK</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh; Lexim në role; Kllaster; Diskutim.</p>			

Organizimi i orës së mësimit


- Rikujtoni njohuritë e marra për tekstin dramatik.

Diskutim

- A keni qenë në teatër?
- Ku ndryshon shfaqja teatrale nga kinematografia?
- Ç'drama keni lexuar?
- Cilët dramaturgë shqiptarë e të huaj njihni?

Ndërtimi i njohurive të reja

- Shfaqja për 10' e fragmentit të shkëputur nga drama qëllim krijim e idesë për mjedisin, kohën, kostumet.
- Lexim në role i fragmentit të dramës.
- Punimi i rubrikës "Të kuptojmë përmbajtjen".



me

Vlerësimi:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të portretizuar personazhe, përcaktojnë elementet e tekstit dramatik; shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë leximit në role.

Detyrë shtëpie:

Grupi i aktorëve: Punoni për të interpretuar me ndjenjë rolin e caktuar nga mësuesi/ja.

Grupi i skenës: Sillni materiale për dekorimin e skenës.

Grupi i kostumografisë: Sillni veshje të ndryshme për aktorët.

Grupi i fundit: Sillni materiale me të dhëna për jetën dhe veprën e Fadil Krajës.

Planifikimi ditor (ditar)

Fusha: Gjuha dhe komunikimi		Lënda: Gjuha shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: "Gjaku i arbërit" (ora e dytë)			Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>				
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ interpreton me emocion rolin e caktuar; ❖ shpreh ndenjat që përjeton gjatë interpretimit në dramë; ❖ realizon kostumet sipas kohës dhe moshës së personazheve; ❖ dekoron skenën në përshtatje me kohën dhe ngjarjen. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>personazh kryesor, dialog, monolog, fjalët e autorit (didaskalitë), skenograf, kostumograf.</p>		
<p>Burimet: teksti mësimor, kostumet, materialet e dekorimit të skenës</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ndërkurikulare:</p> <p>Teatër, Edukim figurativ, Edukim muzikor</p>		
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në grupe; Interpretim në role; Diskutim.</p>				
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Punë parapërgatitore - Nxënësit janë ndarë orën e parë në grupe. - Punë përgatitore <p>Nxënësit sipas grupeve dhe me ndihmën e mësuesit/es përgatisin skenën, aktorët, muzikën.</p> <p>Interpretim</p> <p>Aktorët interpretojnë rolet e tyre, kurse mësuesi/ja bën vlerësimet, njëkohësisht dhe nxënësit japin vlerësimet e tyre rreth punës së grupeve. Lexohen nga grupi i fundit materialet për jetën dhe krijimtarinë e autorit.</p>				

Diskutim

- A patët vështirësi gjatë punës në grup?
- Cili ishte grupi që ishte përgatitur më mirë?
- Cili nga aktorët interpretoi më bukur?
- A ishte një eksperiencë e bukur për ju kjo shfaqje? Pse?
- Punimi i rubrikës “Gjuha dhe stili”.

Vlerësimi:**Vlerësimi i situatës**


Situata quhet e realizuar kur nxënësit shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë interpretimit në role; realizojnë skenën sipas kërkesave; përgatisin kostumet; diskutojnë dhe japin gjykimin për interpretimin e vet apo të shokëve e shoqeve.

Detyrë shtëpie: Mësoni të ritregoni ngjarjen në dramë me fjalët tuaja.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha:Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Kthejmë në prozë një tekst dramatik		Situata e të nxënit: Shkrim i lirë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje. Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën; Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: ❖ përdor fjalor të pasur dhe gjuhë të figurshme me qëllim që të ndikojë te lexuesi; ❖ përdor gjatë të shkruarit gjuhën standarde dhe respekton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore .			Fjalët kyç: prozë, hyrje, zhvillim, mbyllje.
Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7", një tregim.			Lidhja me fushat kurikulare: Teatër
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Shkrim i lirë.			
Përshkrimi kontekstual i situatës Mësuesi/ja lexon një tregim. Nxënësit rikujtojnë veçoritë e prozës dhe strukturën e tregimit, njohuri të marra në klasën e gjashtë. Lexohen rregullat që nxënësit duhet të ndjekin për të kthyer fragmentin e tekstit dramatik në tregim. Veprimet në situatë: - Bashkëbisedim rreth elementeve të strukturës së një tregimi (rikujtojmë njohuritë).			



- Lexohen rregullat e shkrimit të prozës.
- Leximi i modelit të hyrjes së tregimit duke u mbështetur në ngjarjet që ndodhin në fragmentin e dramës.

Hyrja e tregimit:

Atë ditë, kulla e Nënëmadhes gjëmonte nga gëzimi e hareja. Po martohej Rina, motra e vetme e nëntë vëllezërve. Dasmorët kuvendonin e qeshnin. Nënëmadhja ndiqte gjithçka, jepte ndonjë porosi, përsëndeste të ftuarit, por nuk ishte e qetë. Kthente kokën nga rruga e në sy i kalonte një hije trishtimi. Pesë djemtë që ishin në luftë, akoma nuk po vinin.

Zhvillimi

Mbyllja

- Udhëzimi i nxënësve për të bërë një mbyllje me imagjinatë.
- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.
- Lexim i disa punimeve nga nxënësit.
 - Vlerësimi i punës së njëri-tjetrit dhe mësuesit/es.

Vlerësimi i orës:

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të rrëfyer ngjarjen; shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë shkrimit, bëjnë një mbyllje logjike të tregimit.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Mënyra habitore		Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit nënvizojnë në tekstin e ushtrimit 1 foljet që shprehin habinë e folësit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon foljet në mënyrën habitore; zgjedhon foljet në të dyja kohët e kësaj mënyre; përdor saktë foljet në mënyrën habitore në gjuhën e folur dhe të shkruar. 			Fjalët kyç: mënyra habitore, koha, veta, numri, pjesore e shkurtuar, folja ndihmëse kam.
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Shpjegim i kombinuar me praktikë të drejtuar; Praktikë e pavarur; Tabela e koncepteve; Rishikimi në dyshe.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në dyshe për të nënvizuar në tekstin e ushtrimit 1 foljet që shprehin habinë e folësit.

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në dërrasë. Thekson se, në disa raste, veprime, gjendje apo situata të vërteta shkaktojnë habinë e folësit.
- Nxënësit lexojnë foljet në mënyrën habitore, të cilat i gjetën në ushtrimin 1.
- Mësuesi/ja shkruan në dërrasë foljet: lexuake, kënduakëshe, paskam bërë, paskësh drejtuar dhe u kërkon nxënësve të mundohen të shpjegojnë si formohet mënyra habitore e foljes.
- Theksohet se, për të formuar mënyrën habitore me pjesoren e shkurtuar të foljes kryesore + foljen ndihmëse **kam**, në të tashmen ose të pakryerën që i ngjitet foljes. Kohët e përbëra formohen me foljet ndihmëse **kam** ose **jam** në habitore + pjesorja e foljes kryesore.
- Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin dhe nënvizojnë çështjet kryesore.

Veprimtari praktike

- Nxënësit punojnë me ushtrimet 2, 3, 4 në libër, sipas kërkesave. Për ushtrimin 4, nxënësit plotësojnë tabelën e koncepteve që mësuesi/ja e ndërton në tabelë.

Folja	Mënyra	Koha	Veta	Numri
paske stërvitur	habitore	e kryer	II	njëjës

Pasi përfundohen ushtrimet në libër dhe fletore, diskutohen me gjithë klasën.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situates

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme; përcjellin informacionin; dallojnë foljet në mënyrën habitore; përcaktojnë vetën numrin dhe kohën; zgjedhojnë foljet në mënyrën habitore dhe i përdorin foljet e kësaj mënyre në situata të ndryshme.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 5, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: A jam dëgjues i mirë?		Situata e të nxënit: Dëgjimi me vëmendje i dy shkrimeve të ndryshme për qytetin e Gjirokastrës në tekst, të lexuara nga mësuesi/ja për të parë sa dëgjues të mirë janë.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ rikujton rregullat që duhet të ndjekë gjatë të dëgjuarit; ❖ ritregon informacionin që mban mend pas dëgjimit të tekstit; ❖ vlerëson veten se sa dëgjues i mirë është. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>ritregim, dëgjoj, rregulla.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”</p>		<p>Lidhja me fushat kurrikulare: Teatrin</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pyetje – përgjigje; Dëgjim i drejtuar; Diskutim; Bisedë etj.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - A keni qenë në qytetin e Gjirokastrës? - Nëse po, çfarë mbani mend nga ky qytet? - Çfarë keni lexuar për të? <p>Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të mbyllin tekstin mësimor, të marrin pozicionin e duhur për të qenë dëgjues sa më i mirë dhe u lexon në fillim informacionin e marrë nga Wikipedia për qytetin e Gjirokastrës.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbyllja e tekstit mësimor. 			

- Përqendrim në dëgjimin sa më me vëmendje të tekstit informues dhe atij rrëfyes.
- Leximi i teksteve nga ana e mësuesit/es.
- Ritregimi i tyre nga ana e nxënësve.
- Krahasimi i dy shkrimeve me ndihmën e Diagramit të Venit.
- Vetëvlerësimi i nxënësit se sa dëgjues i mirë është.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: ritregojnë sa më saktë informacion; bëjnë interpretimet e tyre rreth teksteve dhe analizojnë gjuhën e përdorur.

Detyrë shtëpie: Përshkruaj vendlindjen tënde në mënyrë artistike ose informuese.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Mënyra dëshirore dhe urdhërore		Situata e të nxënit: Nxënësit në grupe formojnë fjali me foljet e dhëna.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon foljet në mënyrën dëshirore dhe urdhërore; zgjedhon foljet në kohët e këtyre mënyrave; përdor saktë në fjali foljet në këto dy mënyra. 			Fjalët kyç: mënyra dëshirore, mënyra urdhërore, koha, veta, numri.
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë; Diagrami i Venit; Praktikë e pavarur; Të nxënit me këmbime; Tabela e koncepteve.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe u kërkon të ndërtojnë fjali me foljet: **dalsh, u bëfsh, paç mbaruar, lexo, puno dhe bëj.**

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton mësimin e ri dhe shkruan temën në dërrasë iu kërkon nxënësve të ndërtojnë fjali me foljet e dhëna, të lexojnë mësimin dhe në Diagramin e Venit të plotësojnë të përbashkëtat dhe dallimet e foljeve në mënyrat dëshirore dhe urdhërore.

a. Të dyja mënyrat shprehin dëshirën ose vullnetin e folësit.

b. Mënyra dëshirore shpreh vullnetin apo dëshirën e folësit në formën e urimit ose të mallkimit, ka dy kohë, përdoret në fjali dëshirore.

c. Mënyra urdhërore shpreh dëshirën ose vullnetin e folësit në formën e urdhërit, kërkesës, lutjes, sugjerimit etj., përdoret në fjali nxitëse, ka vetëm formën e vetës së dytë njëjës dhe shumës të kohës së tashme.

- Diskutohen fjalitë, si dhe njohuritë e reja me gjithë klasën.

Veprimtari praktike

- Ushtrimet 1 dhe 4 zhvillohen në tabelë. Nxënësit punojnë në dyshe.

Folja	Mënyra	Koha	Veta	Numri
bëfsh	dëshirore	e tashme	II	njëjës
thuj	urdhërore	e tashme	II	njëjës

Ushtrimet 2, 3 dhe 5 zhvillohen në fletore, sipas kërkesave.

Në përfundim të ushtrimeve, diskutohen me gjithë klasën.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësim i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë foljet në mënyrat dëshirore dhe urdhërore; zgjedhojnë foljet në mënyrën dëshirore; përcaktojnë vetën, kohën dhe numrin; përdorin saktë këto dy mënyra në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 6, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime përmbledhëse për foljet e mënyrës kushtore, dëshirore, urdhërore		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja drejton pyetje (Stuhi mendimesh) rreth njohurive të nxënësve për foljen.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Nxënësi/ja:			
1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi;			
2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim;			
3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;			
4. shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalët kyç:
Nxënësi/ja:			folje, mënyrë, kohë, vetë, zgjedhim.
1. dallon foljet, përcakton mënyrën, kohën, vetën dhe numrin;			
2. klasifikon foljet në zgjedhime dhe i zgjedhon ato në mënyrat kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore;			
3. bën një përshkrim me temë "Pushimet e mia", ku përdor foljet në mënyrat kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore.			
Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh; Praktikë e drejtuar; Praktikë e pavarur; Marrëdhëniet pyetje - përgjigje.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja drejton pyetje (Stuhi mendimesh) rreth njohurive që kanë marrë nxënësit për foljen.

Çfarë është folja?

Ç'veçori ka ajo?

Si i ndajmë foljet në zgjedhime?

Sa mënyra ka folja?

Ç'tregon folja në mënyrat kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore?

Si ndërtohen këto mënyra?

Sa kohë kanë ato?

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit dhe u drejton pyetje nxënësve për të përsëritur dhe rikujtuar njohuritë e tyre rreth foljes.

Veprimtari praktike

- Nxënësit ndahen në 4 grupe dhe secili grup punon nga 2 ushtrime, të cilët i zhvillojnë në libër sipas kërkesave.

Për ushtrimin 3, mësuesi/ja sqaron se, mënyra dëftore ka dy kohë, të cilat janë të njëjta për nga forma me dy kohët e mënyrës kushtore. Për të dalluar nëse folja është në mënyrën dëftore apo kushtore duhet parë nëse ajo tregon një veprim a gjendje të vërtetë, në këtë rast folja është në mënyrën dëftore, apo një veprim të mundshëm, një supozim, pendesë, apo dëshirë dhe folja është në mënyrën kushtore.

- Në përfundim, ushtrimet diskutohen me gjithë klasën.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë foljet; përcaktojnë mënyrën, kohën, vetën dhe numrin; përcaktojnë zgjedhimin; përdorin saktë foljet në mënyrat kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 9, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa:VII
Tema mësimore: Ishuj në qiell Artur Klark Ora e parë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësues/ja i ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u bazuar në fjalët kyç. - Përcakton kohën, vendin ku zhvillohen ngjarjet në tekst. - U përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. - Tregon me fjalët e tij brendinë e pjesës, duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti. - Analizon tregimin në formë dhe përmbajtje. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>kozmos, kozmonaut, hapësirë qiellore, anije kozmike.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, hartë gjeografike, CD, videoprojektor, foto, materiale nga interneti, vepra.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bashkëbisedim; Hartë koncepti; Parashikimi me terma paraprakë; Provë në tregim; Punë në grupe; Harta e tregimit.</p>			

Artur Klark (*Arthur Clarke*) lindi më 1917-ën, në Britaninë e Madhe; është marrë më studime shkencore të mirëfillta, si: astronomi, telekomunikacion, biologji detare etj.

Ka shkruar shumë romane e tregime fantastiko-shkencore, të cilat janë përkthyer në shumë gjuhë të botës:

“Rërat e marsit”, “Qyteti me yje”, “Ishulli i delfinëve”.

Punë parapërgatitore: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të hulumtojnë mbi universin, yjet, planetët, teoritë e formimit të botës etj. Për këtë ai/ajo e ndan klasën në 6 grupe. Secili grup do të hulumtojë rreth temës së caktuar nga mësuesi/ja. Burimet e informacionit mund të jenë të ndryshme: Gjeografia 6, revista shkencore, interneti, enciklopedia për fëmijë etj.

Vizatoni në skedën tuaj një zarf ku të shkruani: Adresa ime në hapësirë.

Organizimi i orës së mësimit

Grupi I –Të sjellë kuriozitete, pamje të ndryshme të universit dhe informacione rreth këtyre çështjeve:

- Ç’kuptim ka për ju universi?
- A njihen përmasat që zë universi?
- Po numri i yjeve që lëvizin pa pushim në këtë hapësirë të pafund, a njihet?

Grupi II - Të sjellë kuriozitete, pamje të ndryshme dhe informacione rreth detyrave:

- Ç’janë yjet dhe planetët?
- Sa lëvizje kryejnë planetët në hapësirë?

Grupi III.

- Të sjellë kuriozitete, pamje të ndryshme dhe informacione rreth:
 - Teorive të ndryshme të formimit të botës (fetare e shkencore).
 - Në ç’mënyrë është krijuar bota sipas teorisë *Big Bang*?

Grupi IV. - Të sjellë kuriozitete, pamje të ndryshme që tregojnë mungesën e forcës së mungesës dhe informacione rreth:

- Ç’është forca e rëndesës?
- Çfarë do të ndodhte nëse do të mungonte forca e rëndesës?

Grupi V. Bën maketin e Sistemit tonë Diellor, ku përcakton vendndodhjen e secilit planet rreth Diellit

(shfrytëzoni mjete të ndryshme rrethore, si: gogla, fruta (portokall), tela të butë për të dhënë idenë e unazave.)

Grupi VI. Nxënësit e këtij grupi do të plotësojnë tabelën e mëposhtme. Kjo tabelë të vizatohet e të plotësohet me një tabak të madh letre me bojëra uji.

Emri i Planetit	Veçoritë e tij	Diametri (kilometra)	Largësia prej Diellit(kilometra)	Koha që duhet për t'u rrotulluar rreth diellit

Vlerësimi: Për përgjigjet në grup, p.pavarur,diskutimet, vlerësim i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: "Udhëtimi im në univers"

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ishuj në qiell Artur Klark Ora e dytë e mësimit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u bazuar në fjalët kyç.</p> <p>Përcakton kohën, vendin ku zhvillohen ngjarjet në tekst.</p> <p>U përgjigjet pyetjeve rreth brendisë së tekstit.</p> <p>Tregon me fjalët e tij brendinë e pjesës duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti.</p>			<p>Fjalët kyç:</p> <p>kozmos, kozmonaut, hapësirë qiellore, anije kozmike.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, hartë gjeografike, CD, videoprojektor.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bashkëbisedim; Hartë koncepti; Parashikim me terma paraprakë; Provë në tregim; Punë në grupe; Harta e tregimit.</p>			

Hapi I. Veprimtaria mësimore do të ndahet në dy pjesë:

Pjesa e parë do të quhet: *Dëshiroj dhe unë të udhëtoj në hapësirë.*

Në këtë pjesë, nxënësit, të ndarë në grupe, do të paraqitin para shokëve gjithë informacionin e hulumtuar.

Mësuesi/ja dëgjon me vëmendje grupet njëri pas tjetrit. I përgëzon për dëshirën (për të bashkëpunuar në grup), mënyrën e prezantimit të punës së tyre para shokëve.

Hapi II. Mësuesi/ja shtron pyetjet: - A ju ka ngacmuar ndonjëherë ideja e udhëtimit në hapësirë? Nëse po, me çfarë do të dëshironit të udhëtoni? (nxënësit janë të lirë në zgjedhje, sipas fantazisë së tyre.) Më pas, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të vizatojnë në skedën një zarf, ku të shkruajnë: “Adresa ime në hapësirë”.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

<p>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: 3</p>	<p>Klasa:VII</p>
<p>Tema mësimore: Shkruani një tregim fantastiko-shkencor</p>		<p>Situata e të nxënit: Shkruajmë me fantazi</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon llojet e tregimeve fantastiko- shkencore; - liston rregullat e të shkruarit të tregimeve; - shkruan tregime fantastiko-shkencore; - përdor fjalor të pasur që lidhet me temën. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>tregim fantastik, strukturë, elemente të tregimit, përmbajtja, rrëfim, element fantastik,</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, model kronike, tabela, shkurtesa me ngjyra, modele artikuj gazeta</p>			<p>Lidhja me fushat kurrikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë me grupe; Diskutim; Punë individuale; Turi i galerisë.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I: Do të jetë faza përgatitore për të ndihmuar nxënësit të imagjinojnë udhëtime fantastiko-shkencore siç ka ndodhur në tregimin: “Ishuj në qiell”, Artur Klark.

Hapi II: Do të jetë punë e pavarur, ku nxënësit pasi janë njohur me rregullat e të shkruarit tregimit fantastiko-shkencor punojnë për të zbërthyer këto elemente në një tregim.

Le t’i shohim më konkretisht mënyrën e realizimit të secilës fazë:

Faza e parë. Nxënësit punojnë individualisht për të shkruar një tregim fantastiko-shkencor të strukturuar brenda këtyre elementëve.

TEMA HYRJA ZHVILLIMI I NGJARJES MBYLLJA

Nxënësit përshkruajnë mjedisin në kozmos duke u nisur nga tregimi “Ishuj në qiell”.

Nxënësit në një tabak vendosin përmbajtjen e tregimit ku shumë i rëndësishëm është element i fantazisë. Analiza që i bëjnë këtij elementi duke e ilustruar nga tregimi “Ishuj në qiell”, shikohet në mënyrën se si realizohet ai. Përdoret figura letrare e hiperbolës.

Hapi III: Nxënësit shkruajnë një tregim “Një udhëtim në Galaktikë”, Ku mësuesi/ja ju shpjegon se duhen respektuar elementet e structures, por edhe elementet e përmbajtjes. Tregimi fantastiko-shkencor ka një gjuhë specifike. Mësuesi/ja i orienton nxënësit me sintaksën dhe fjalorin e fjalëve të përdorura në tregimet fantastiko-shkencore.

Hapi IV: Në përfundim të detyrës organizohet Turi i Galerisë. Kjo metodë ka si qëllim paraqitjen e punëve të nxënësve të afishuara në vende të dukshme dhe që nxënësit kanë të drejtën e leximit të tyre. Kështu që në fund të orës, punimet e tyre nxënësit i afishojnë në muret e klasës. Secili nxënës mund të lëvizë nëpër klasë dhe të lexojë punimet e shokëve.

Në fund vlerësohet punimi më i mirë.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie: Kërkoni në internet një tregim fantastiko-shkencor. Dalloni elementet e strukturës dhe hapat e zbatimit të të shkruarit të tregimit fantastiko- shkencor.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Çapkën i madh ky Tom Sojeri Mark Tuein (Ora e parë)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parashikon ngjarjet e tregimit nisur nga titulli dhe fragmenti i lexuar. - Tregon raste të tilla edhe nga jeta e tij. - Krahason parashikimin me përfundimin e tregimit. - Analizon marrëdhëniet midis fëmijëve dhe të rriturve. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>çapkën, aventura, shoqëri, familje.</p>
<p>Burimet: fletë pune, tabak i bardhë, bojëra uji.</p>			<p>Lidhja e fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Veprimtari; Lexim - mendim i drejtuar me tabelë</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Punë përgatitore: Përgatiten fletore pune për çdo nxënës.

Hapi I. Njihen nxënësit me titullin dhe autorin e tregimit, të cilat shkruhen në tabelë.

I jepet secilit nxënësi fleta e punës që është përgatitur për ta. Në pamundësi të përgatitjes së saj, mësuesi/ja e vizaton tabelën në dërrasën e zezë. U shpjegohet nxënësve se si do të veprojnë më tej. Do të lexojnë tregimin duke e ndarë në 2 pjesë, sipas ndarjes që bën mësuesi/ja.

Pjesa e parë: Fjala e parë në tekst deri te fjalia 15.

Pjesa e dytë: Nga fjalia e parë në fragmentin e dytë e deri në fund.

U rikujtohet nxënësve që të mos lexojnë përtej pikave të ndalimit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet, vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Çapkën i madh ky Tom Sojeri Mark Tuein (Ora e dytë)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parashikon ngjarjet e tregimit duke u nisur nga titulli dhe fragmenti i lexuar. - Tregon raste të tilla edhe nga jeta e tij. - Krahason parashikimin me përfundimin e tregimit. - Analizon marrëdhëniet midis fëmijëve dhe të rriturve. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>çapkën, aventura, shoqëri, familje.</p>	
<p>Burimet: fletë pune, tabak i bardhë, bojëra uji.</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Lexim-mendim i drejtuar me tabelë</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi II. Nxënësit lexojnë titullin e tregimit dhe, mbështetur në të, parashikojnë se çfarë do të ndodhë në tregim. I shkruajnë parashikimet e tyre në kolonën “Çfarë mendoni se do të ndodhë?” dhe arsyet se pse mendojnë ashtu i shkruajnë në kolonën “Pse mendoni kështu?”.

Hapi III. U kërkohet nxënësve të lexojnë deri te ndalesa e parë dhe, kur të kenë arritur deri aty, të kthehen e të shikojnë parashikimin që kishin bërë në fillim dhe të thonë se çfarë ndodhi në të vërtetë. Mendimet e tyre i shkruajnë në kolonën “Çfarë ndodhi?”.

Hapi IV. Mësuesi/ja i rishikon parashikimet dhe pyet se cilat janë vërtetuar deri tani. Ai/ajo u kërkon nxënësve të lexojnë me zë pjesë nga teksti që vërtetojnë ose nuk vërtetojnë parashikimet e tyre.

Hapi V. Nxënësit parashikojnë se çfarë do të ndodhë në pjesën tjetër të tekstit, sjellin provat që i çojnë në këto parashikime dhe i vendosin parashikimet e tyre në vendin përkatës. Më pas vazhdojnë të lexojnë dhe të krahasojnë parashikimet e tyre me atë që ndodhi në të vërtetë, lexojnë me zë në tekst provat që mbështetin ato parashikime dhe lexojnë më tej pjesën e fundit.

Hapi VI. Në përfundim, ata duhet të krahasojnë parashikimet e fundit që kanë bërë me atë që ndodhi në të vërtetë në tregim. Rezultatet e krahasimit shënohen në vendin e duhur në tabelë. Bëhet vlerësimi i orës së mësimi

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Format e pashtjelluara të foljes		Situata e të nxënit: Nxënësit punojnë në dyshe. Gjejnë kryefjalët në tekstin e dhënë në fillim të mësimit dhe ndryshojnë vetën dhe numrin e tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Nxënësi/ja:			
1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi;			
2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim;			
3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;			
4. shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalët kyç:
Nxënësi/ja:			forma të pashtjelluara të foljes, pjesore, përcjellore, paskajore, mohore.
1. dallon format e pashtjelluara të foljes;			
2. plotëson fjalitë duke përdorur format e dhura të pashtjelluara;			
3. bën një përshkrim duke përdorur format e pashtjelluara të foljes.			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim për njohuritë paraprake; Shpjegim i kombinuar me mbajtjen e strukturuar të shënimeve; Praktikë e pavarur; Rishikim në dyshe; Diskutim.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Nxënësit punojnë në dyshe. Gjejnë kryefjalët në tekstin e dhënë në fillim të mësimit dhe ndryshojnë vetën dhe numrin e tyre.

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja prezanton temën e re mësimore dhe u kërkon nxënësve që në dyshe të gjejnë kryefjalët në tekstin në fillim të mësimit dhe të ndryshojnë vetën dhe numrin e tyre.
- Nxënësit dallojnë se cilat gjymtyrë ndryshojnë me ndryshimin e kryefjalës dhe cilat jo.
- Mësuesi/ja shpjegon format e pashtjelluara të foljes, mënyrat se si formohen ato.
- Në dyshe, nxënësit plotësojnë tabelën e koncepteve:

Pjesore	Mohore	Paskajore	Përcjellore
Shërben: <ul style="list-style-type: none">• për të formuar format e tjera të pashtjelluara;• formon kohët e përbëra të foljes;• ndihmon për të formuar mbiemra.	<ul style="list-style-type: none">• Formohet nga pjesorja duke marrë pjesëzën mohuese pa;• shërben për të treguar moskryerjen e një veprimi në të ardhmen ose në të shkuarën.	<ul style="list-style-type: none">• Formohet me pjesëzën për të + pjesoren e foljes;• shërben për të emërtuar një veprim si proces pa e lidhur atë me një vetë të caktuar.	<ul style="list-style-type: none">• Ndërtohet duke vendosur para pjesores pjesëzën duke;• shpreh një veprim që shoqëron veprimin e foljes kryesore të fjalisë. Zakonisht, të dyja veprimet kryhen njëkohësisht.

Veprimtari praktike

- Mësuesi/ja punon me nxënësit ushtrimin 1.
 - Në dyshe, nxënësit punojnë ushtrimet 2–6, sipas kërkesave.
- Në përfundim, ushtrimet diskutohen me gjithë klasën.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën në pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë format e pashtjelluara të foljes dhe i përdorin ato saktë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 7, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për format e pashtjelluara të foljes		Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit ndërtojnë pemën e mendimit për format e pashtjelluara të foljes.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> dallon format e pashtjelluara të foljes; plotëson fjalitë duke përdorur format e duhura të pashtjelluara; krijon një ese duke përdorur format e pashtjelluara të foljes. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>format e pashtjelluara të foljes, pjesore, mohore, paskajore, përcjellore.</p>	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”		Lidhja me fushat kurikulare:	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pema e mendimit; Marrëdhëniet pyetje - përgjigje; Rishikim në dyshe; Diskutim.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Në dyshe, nxënësit ndërtojnë pemën e mendimit për format e pashtjelluara të foljes.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <p>- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimin, e shkruan në tabelë dhe u kërkon nxënësve që të plotësojnë në dyshe pemën e mendimit për format e pashtjelluara të foljes.</p>			

- Një nxënës ngrihet dhe plotëson pemën e mendimit në tabelë.

Veprimtari praktike

- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në libër për të zhvilluar ushtrimet sipas kërkesave. Në dyshe kontrollojnë punët e njëri-tjetrit.

- Në përfundim, ushtrimet diskutohen me gjithë klasën.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme; përcjellin informacionin; dallojnë format e pashtjelluara të foljes dhe i përdorin ato saktë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 7, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Tekst udhëzues		Situata e të nxënit: Prezantim i një recete gatimi, një manuali përdorimi dhe rregullave për të qenë të sigurt në internet.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalët kyç:
<ul style="list-style-type: none"> ❖ dallon karakteristikat e tekstit udhëzues; ❖ respekton formën e përshtatshme gjatë të shkruarit; ❖ shpjegon hapat që ndjek kur luan një lojë në kompjuter. ❖ vlerëson punët e të tjerëve. 			<ul style="list-style-type: none"> udhëzime receta manuale përdorimi rend kronologjik
Burimet: teksti mësimor, receta gatimi ose ilaçesh, manuale përdorimi			Lidhja me fushat kurikulare:
			TIK, Aftësim teknologjik
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lexim i drejtuar; Diskutim.			
Përshkrimi kontekstual i situatës			
Mësuesi/ja prezanton një recetë gatimi:			
Përbërësit:			
Baza: 250g miell, 5g maja e thatë (ose gjysmë pakete e vogël), 300g ujë ose lëng, (lëngu përfitohet nga shtrydhja dhe kullimi direkt i perimeve të freskëta, si: spinaq, mente, borzilok, domate, specat, lakër të kuqe, karota, etj.). Mund ta përziëni ujin për t'i dhënë ngjyrë me shafran, kafe, kakao, lëng lëkure patëllxhani. Përdorni fantazinë tuaj, ½ lugë kafe sheqer, 2 lugë kafe kripë, 1 lugë gjelle vaj vegjetal ose ulliri.			

Përgatitja: Përzienu ujini ose lëngun e vakët (jo të nxehtë) me majanë dhe sheqerin, pastaj lëreni të pushojë për 10-15 minuta. Shtoni miellin, kripën, vajin dhe bëni një brumë të fortë (si brumë byreku). Bëni çdo brumë që doni me ngjyra të ndryshme, veç e veç - mos bëni një brumë të bardhë dhe ta ngjyrosni me vonë. Lëreni çdo brumë të vijë rreth 1 orë ose derisa të dyfishohet në volum.

Mbulojeni me një pecetë ose mbështjellëse plastike në një vend të ngrohtë. Bëni të paktën 5 brumëra me shije dhe ngjyra të ndryshme. Hapni çdo brumë në formë të njëjtë drejtkëndore, p.sh. 10 x 20cm, dhe vëri shtresat njëri sipër tjetrit sipas fantazisë suaj në ngjyra. Pritni në rripa prej 3 cm për së gjati dhe rrotulloni çdo rrip në anë, formë spirale.

Keni fituar kështu 3-4 bukë, të cilat i vëmë në tepsi dhe i lëmë të vijnë edhe një herë. Furrën e kemi nxehur mirë në 220 gradë para se t'i vëmë bukët të piqen në tepsi, afërsisht 30-40 minuta.

Manual përdorimi i një dekoderi digjital

Ky dekoder digjital është prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë, por gjithsesi duhen respektuar masat e sigurisë për të pasur një funksionim sa më të mirë të dekoderit. Je i lutur të mbash shënim udhëzimet në vijim për të shmangur rrezikun e një shoku elektrik!

- Ky dekoder vepron me furnizim me energji të jashtme në rangun 100 deri 240V AC, 50/60 Hz. Përdor një prizë standarde në mur; burimi i energjisë DC nuk duhet të përdoret. Mos harro se kontakti me furnizimin me energji elektrike 110-240 Volt AC, mund të jetë vdekjeprurës.
- Sigurohu që të gjitha lidhjet elektrike të jenë bërë si duhet para se të lidhësh dekoderin me energjinë elektrike. Gjithmonë s'takoje dekoderin përpara se të lidhësh ose shkëputësh ndonjë kabull.
- Sa herë të lidhësh dekoderin me energjinë elektrike, lidh fillimisht kordonin me panelin e dekoderit, para se të vësh në prizë adaptuesin.
- Sa herë ta heqësh dekoderin nga priza, fillimisht duhet hequr priza e murit përpara se të hiqet skaji tjetër fundor i kordonit nga furnizuesi me energji elektrike, që ndodhet në pjesën e pasme të dekoderit.
- Mos provo kurrë ta riparosh vetë dekoderin. Mund të ndodhë ndonjë shok elektrik fatal nëse dekoderi riparohet nga persona të paautorizuar.
- Bëj kujdes nëse njësia bie në kontakt me ujin. Hiqe menjëherë nga priza, nëse është e mundur.

Veprimet në situatë:

- Prezantimi i recetës së gatimit dhe manualit të përdorimit.
- Diskutim rreth veçorive të tyre, si: foljet në mënyrën urdhërore, veta e dytë njëjës ose shumës, sintaksë e thjeshtë, renditje e veprimeve në rend kronologjik.
- Lexim i rregullave që duhet të ndjekim për të qenë të sigurt në internet.
- Diskutim rreth këtyre rregullave.

Vlerësimi i orës:

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të dallojnë veçoritë e tekstit udhëzues dhe të diskutojnë rreth tyre.

Detyrë shtëpie: Një grup sjell një recetë gatimi karakteristike të vendlindjes së tij.

Një grup sjell manualin se si të përdorim një pajisje elektronike.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë udhëzime për një lojë në kompjuter		Situata e të nxënit: Punë e pavarur	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ dallon karakteristikat e tekstit udhëzues; ❖ respekton formën e përshtatshme gjatë të shkruarit; ❖ shpjegon hapat që ndjek kur luan një lojë në kompjuter; ❖ vlerëson punët e të tjerëve. 		<p>Fjalët kyç: udhëzime, receta, manuale përdorimi, rend kronologjik.</p>	
<p>Burimet: teksti mësimor, modele letrash zyrtare</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare: Edukim figurativ</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e pavarur; Diskutim.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Rikujtojmë njohuritë</p> <p>Përmendni disa tekste që bëjnë pjesë te teksti udhëzues.</p> <p>Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që t'u përgjigjen pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilat janë karakteristikat gjuhësore të tekstit udhëzues? - Si renditen veprimet në këto udhëzime? - Cilat janë disa rregulla që mësuat për të qenë të sigurt në internet? <p>Veprimet në situatë:</p>			

- Leximi i detyrës së shtëpisë.
- Diskutim rreth pyetjeve të mësipërme.
- Diskutim rreth rregullave që duhet të kemi parasysh për të qenë të sigurt në internet.
- Punë e pavarur: shkrimi i rregullave që duhet të ndjekim gjatë zhvillimit të një loje në internet.
- Leximi i disa punimeve.
- Diskutim rreth këtyre punimeve.
- Vlerësimi për punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: dallojnë formën dhe gjuhën e përshtatshme në një udhëzim për luajtjen e një loje në internet; diskutojnë dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie:

Shkruani rregullat e një manuali (dekoder, kompjuter).

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “Xhevahiri i fjalës”, Zhuljana Jorganxhi		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ shpjegon kuptimin e titullit dhe tregon efektet që përcjell te lexuesit; ❖ diskuton rreth marrëdhënieve mes shoqeve; ❖ analizon figurën letrare të metaforës; ❖ shkruan një poezi për shoqen/shokun. 			<p>Fjalët kyç: shoqe, dashuri, mall, reciproke.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, këngë festivali me tekst të Zhuljana Jorganxhi, CD-ja me materiale ndihmëse për mësuesin/en</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare: TIK, Histori</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Kllaster; Diskutim; Shkrim i lirë.</p>			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme.

Plotësimi i kllasterit për veçoritë e tekstit poetik.

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimet në situatë:

- Dëgjimi i këngës me tekst të Zhuljana Jorganxhi.
 - Diskutim rreth pyetjes: A keni shok/shoqe të ngushtë?
 - **Prezantimi i poezisë**
- Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e poetes.
- Mendime rreth titullit të poezisë dhe lidhjes së tij me përmbajtjen.
 - Shpjegimi i figurës së metaforës.
 - Formulimi i mesazhit të poezisë.
 - Punimi i rubrikës "Të zbëthejmë tekstin".

Reflektim mbi rezultatet e arritura

Punohet rubrika "Gjuha dhe stili".

- Efekti stilistikor që krijon përsëritja e fjalës "xhevahir" është përforcimi i vlerës së fjalës.
- Foljet që tregojnë marrëdhënien reciproke: gjeta - gjete, kërkuj - kërkon, gjej – gjen.
- Avantazhi i përdorimit të vargut të lirë është mundësia për të shprehur lirshëm ndjenjat, pa u kujdesur për numrin e rrokjeve apo rimën.



Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: përcaktojnë veçoritë e tekstit poetik; shprehin idetë dhe mendimet e tyre gjatë analizës së poezisë dhe nxjerrjes së mesazhit.

Detyrë shtëpie: Shkruani një poezi për shokun/shoqen tuaj.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Lidhëzat dhe llojet e tyre		Situata e të nxënit: Nxënësit gjejnë në dyshe lidhëzat në fjalitë e ushtrimit 3 dhe dallojnë cilat janë bashkërenditëse dhe cilat janë nënrenditëse.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> dallon lidhëzat në fjali; përcakton llojin e tyre sipas funksionit dhe formimit; përdor saktë lidhëzat në gjuhën e folur dhe të shkruar. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>lidhëzat, lidhëza bashkërenditëse, lidhëza nënrenditëse, të thjeshta, të përngjitura, shprehje lidhëzore.</p>	
Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"		Lidhja me fushat kurikulare:	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënit me këmbime (punë në dyshe); Organizuesi grafik; Praktikë e pavarur; Rishikimi në dyshe.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Nxënësit gjejnë në dyshe lidhëzat në fjalitë e ushtrimit 3 dhe dallojnë cilat janë bashkërenditëse dhe cilat janë nënrenditëse.</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>- Mësuesi/ja u bën të njohur nxënësve temën e re mësimore, të cilën e shkruan në tabelë. Më pas përcakton çështjet kryesore që do të trajtohen në mësim dhe i shkruan në tabelë: Ç'janë lidhëzat? Cili është roli i tyre në fjali? Sa lloje lidhëzash njihni? Ku ndryshojnë lidhëzat bashkërenditëse nga</p>			

lidhëzat nënrenditëse? Si i ndajmë lidhëzat për nga formimi?

- Nxënësit punojnë për të gjetur lidhëzat në fjalitë e ushtrimit 3 dhe dallojnë cilat janë bashkërenditëse dhe cilat janë nënrenditëse.

- Nxënësit lexojnë mësimin në heshtje dhe plotësojnë Organizuesin grafik: Lidhëzat dhe veçoritë e tyre.

Ç'janë lidhëzat?	Roli i tyre	Bashkërenditëse	Nënrenditëse	Ku ndryshojnë lidhëzat bashkërenditëse nga lidhëzat nënrenditëse?	Si ndahen për nga mënyra e formimit të tyre?
Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.	Lidhin dy gjymtyrë të një fjalie, dy fjali dhe shprehin marrëdhënie të ndryshme sintaksore.	shtuese veçuese kundërshtuese përmbyllëse		Krijojnë marrëdhënie: - barazie, - varësie.	Të thjeshta: e , dhe, ose, apo etj. Të përngjitura: derisa, sesa, kurse, ndonëse, pasi etj. Shprehje lidhëzore: në qoftë se, me qëllim që, edhe pse etj.

- Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që t'u përgjigjen pyetjeve të shkruara në dërrasë.

Veprimtari praktike

- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për të zhvilluar ushtrimet 1, 2, 4, 5 sipas kërkesave.

Për ushtrimin 2 mund të përdoret tabela:

Lidhëzat	Të thjeshta	Të përngjitura	Shprehje lidhëzore
kur	+		
pasi		+	

Pasi mbarohen, ushtrimet diskutohen me të gjithë klasën.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësim i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë lidhëzat, i ndajnë ato në bashkërenditëse dhe nënrenditëse, i ndajnë sipas formimit dhe i përdorin saktë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 6.

Planifikimi ditor (ditar)

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Llojet e lidhëzave bashkërenditëse e nënrenditëse		Situata e të nxënimit: Mësuesi/ja drejton pyetje mbi njohuritë e nxënësve rreth lidhëzave dhe llojeve të tyre (Stuhi mendimesh).	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: 1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; 2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; 3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; 4. shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: 1. dallon lidhëzat në fjali; 2. përcakton llojin e tyre sipas funksionit dhe formimit; 3. përdor saktë lidhëzat në gjuhën e folur dhe të shkruar.			Fjalët kyç: lidhëzat, lidhëza bashkërenditëse, lidhëza nënrenditëse, të thjeshta, të përngjitura, shprehje lidhëzore.
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh; Praktikë e drejtuar; Punë e pavarur; Diskutim.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja drejton pyetje mbi njohuritë e nxënësve rreth lidhëzave dhe llojeve të tyre (Stuhi mendimesh):

Ç'janë lidhëzat?

Përse shërbejnë?

Si i klasifikojmë ato për nga përdorimi?

Si i klasifikojmë për nga formimi?

Jepni shembuj me lidhëza bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton temën e re mësimore dhe e shkruan në dërrasë.
- Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin dhe nënvizojnë lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse.
- Mësuesi/ja punon me nxënësit ushtrimin 1. Nxënësit qarkojnë lidhëzat dhe përcaktojnë llojin.

Veprimtari praktike

- Nxënësit punojnë në punë të pavarur për të zgjidhur ushtrimet 2-4, sipas kërkesave. Ushtrimi 4 mund të zhvillohet në tabelë:

Lidhëza	E parme	E përngjitur	Shprehje
që megjithatë edhe pse	+	+	+

Pasi nxënësit të kenë mbaruar me ushtrimet, diskutohet rreth tyre duke u përqendruar aty ku ata hasin vështirësi.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë lidhëzat, i ndajnë ato në bashkërenditëse dhe nënrenditëse; i ndajnë sipas formimit dhe i përdorin saktë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 5, sipas kërkesës. Të ndërtojnë tabela për lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse.

Diktim

(Në këtë diktim trajtohet drejtshkrimi i zanores **ë**, diftongjet dhe grupet e bashkëtingëlloreve.)

Nga maja e atyre **shkëmbinjve/shkëmbijve** _____ pa përpara tij tokën dhe hodhi **syt/sytë** _____ **larg/largë** _____. Para **tij/tijë** _____ shtrihej një **rrafshinë/rrafshin** _____ e **pafundë/pafund** _____, e sheshtë, e ngrirë, e mbuluar me **dëbor/dëborë** _____. Aty - këtu ndonjë **kaçubë/kaçub** _____ dridhej nga era. Nuk dukeshin rrugët. Nuk dukej asgjë. As edhe ndonjë kasolle bariu. Vende-vende të zinte syri rrotullare të zbardheme dëbore të **imtë/imët** _____, që i çonte peshë era. Një **varg/vargë** _____ kodrinash të **valëvitura/valvitura** _____, që mezi dukeshin në mjegull, shkriheshin e bëheshin njësh me horizontin. Ajo pllajë e madhe, e zhveshur **humbte/humte** _____ nën tisin e **bardh/bardhë** _____ të dëborës. Heshtje e **thell/thellë** _____. Gjithçka rreth e rrotull dukej e pakufishme dhe e heshtur si varri.

Fëmija u **kthye/kthy** _____ nga deti.

Deti, ashtu si toka, ishte krejt i bardhë: toka, e bardhë nga dëbora, deti nga shkuma. Nuk mund të ketë asgjë më të **trishtushme/trishtueshme** _____ sesa drita që shkaktonte ajo bardhësi e **dyfisht/dyfishtë** _____. **Nganjëherë/Nganjëher** _____ shndërritjet e natës kanë një kthjelltësi të **çuditëshme/çuditshme** _____: deti dukej sikur ishte prej çeliku dhe **shkëmbijtë shkëmbinjte** _____ prej ebanози të zi.

Nga maja ku gjendej **fëmija/fmija** _____, gjiu i Portlendit, që vezullonte turbull në mes të **gjysmërrethit/gjysëmrrrethit** _____ të **kodërave/kodrave** _____ të tij, kishte thujse po atë pamje që ka në hartë; ajo panoramë nate dukej një vegim fantastik. Një rruzull i zbehtë në një **errësirë/errësirë** _____ që sa vinte shtoej; hëna merr **nganjëherë/nganjëher** _____ një pamje të tillë. Në **tër/tërë** _____ bregun, nga një kep te tjetri, nuk të zinte syri as edhe një dritë që të tregonte ndonjë vatër të ndezur, ndonjë dritare të ndriçuar, ndonjë **shtëpi/shpi** _____ të banuar. **Errësirë/Errësirë** _____ e thellë në tokë dhe në qiell, asnjë pishtar poshtë, asnjë yll lart. Aty - këtu faqja e sheshtë e gjiut çohet **pesh/peshë** _____ nga valët. Era e prishte dhe e zhubroste atë **pasqyr/pasqyrë** _____. Anija dukej ende në gjiun e detit.

Marrë nga "Njeriu që qesh"

Viktor Hygo

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Pasthirrmat		Situata e të nxënësve: Dy nxënës interpretojnë një dialog ku janë përdorur pasthirrmat të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon pasthirrmat; plotëson fjalitë me pasthirrmat e duhura; përdor saktë pasthirrmat në gjuhën e folur dhe të shkruar. 			Fjalët kyçe: pasthirrmë, intonacion, emocionuese, nxitëse.
Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"			Lidhja me fushat kurikulare: TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lojë me role; Shpjegim i kombinuar me diskutim; Punë e pavarur; Diskutim.			
Përshkrimi kontekstual i situatës Dy nxënës interpretojnë një dialog ku janë përdorur pasthirrmat.			
...Ne bënim sikur i shijonim e i lëvdonim: "Ohoho, sa të mira, sa të mira!" Aty, në shtëpi, kishim edhe qilarë për të			

	<p>mbledhur zahirenë e dimrit: gjalpë e djathë, turshi në qypat, peta e trahan... Edhe hambarë. Shtëpi, kjo i do të gjitha.</p> <p>Po aty, në shtëpi, nuset tona prisnin e përcillnin krushqinë e farefisën, të afërmit e të largmit, nga lëngu deri te stërlëngu.</p> <p>I prisnin me të puthura e urime, siç bënin më të mëdhenjtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mirë, ndajnatë, moj nus' e Çilit! - Misardhe, misardhe, të lumshin këmbët! Urdhëro e hyr brenda! - Ju ardhçin të mirat, po s'mund të hyj e të rri se kam djalin në djep e më qan. Ardha vetëm t'ju shoh. 	
<p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në dërrasë. Fton dy nxënës të lexojnë një pjesë të marrë nga rrëfenja "Vendosa të shkoj në kurbet", të shkrimtarit Mitrush Kuteli. Nxënësit e tjerë mbajnë shënim pasthirrat që dëgjojnë. - Mësuesi/ja shpjegon mësimin duke u mbështetur tek pyetjet: <ul style="list-style-type: none"> • Çfarë shprehin pasthirrat? • Si mund të ndryshojnë kuptimet e pasthirrës Ooooo në kontekste të ndryshme? Ç'rol luan intonacioni? • Në sa grupe mund t'i ndajmë pasthirrat? <p>Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin dhe kalojnë në zgjidhjen e ushtrimeve.</p> <p>Veprimtari praktike</p> <p>Nxënësit plotësojnë në libër ushtrimet 1-4 sipas kërkesave. Pasi përfundohen ushtrimet, ato diskutohen me gjithë klasën.</p>		
<p>Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.</p> <p>Vlerësimi i situatës</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë pasthirrat dhe i përdorin ato saktë në gjuhën e folur dhe të shkruar.</p> <p>Detyrë shtëpie: ushtrimi 5. Në programin <i>Word</i> mund të krijojnë një tabelë ku jepen veçoritë e pasthirrmave.</p>		

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Pjesëzat		Situata e të nxënit: Nxënësit plotësojnë në dyshe tabelën e koncepteve me fjalët e duhura nga fjalitë që mësuesi/ja i ka përgatitur në një tabak ose që i ka shkruar në dërrasë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon pjesëzat, duke i grupuar sipas llojit; zëvendëson pjesëzat me të tjera, duke ruajtur kuptimin; përdor saktë pjesëzat në gjuhën e folur dhe të shkruar. 		Fjalët kyç: pjesëza, fjalë e pandryshueshme, dëftuese, saktësuese, përforcuese, përfruese.	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”		Lidhja me fushat kurikulare: TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Tabela e koncepteve; Marrëdhëniet pyetje–përgjigje; Shpjegim; Praktikë e pavarur.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Nxënësit plotësojnë në dyshe tabelën e koncepteve me fjalë nga fjalitë që mësuesi/ja i ka përgatitur në një tabak ose që i ka shkruar në dërrasë. Në ecje, ato gati sa nuk prekeshin. Por ai ishte krejtësisht i qetë. Oh, sa të gjata ishin ato tre minuta!

emër	mbiemër	folje	ndajfolje	përemër	numëror	parafjalë	pjesëz	lidhëz	pasthirmë

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit dhe e shkruan në dërrasë.
- Nxënësit plotësojnë në dyshe tabelën e koncepteve me fjalë nga fjalitë që mësuesi/ja i ka përgatitur në një tabak ose që i ka shkruar në dërrasë.
- Mësuesi/ja drejton pyetjet:

Ku dallojnë pjesëzat nga fjalët e tjera të pandryshueshme?

Çfarë nuancash kuptimore shprehin ato?

Mësuesi/ja shpjegon rolin e pjesëzave në fjali, llojet e tyre, si dhe rastet kur një fjalë mund të jetë pjesëz, ndajfolje, emër, lidhëz.

Veprimtari praktike

Nxënësit punojnë në dyshe për zgjidhjen e ushtrimeve 1-4 sipas kërkesave.

Për ushtrimin 2, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të shpjegojnë klasifikimin e fjalëve si pjesëza, ndajfolje apo emra.

Për ushtrimin 3 mund të përdorin tabelën:

Pjesëza	Dëftuese	Përforcuese	Përafruese
vetëm	+		

Në përfundim të çdo ushtrimi diskutohen përgjigjet e dhëna nga nxënësit, të cilat plotësohen nëse është e nevojshme dhe vlerësohen nga mësuesi/ja.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë pjesëzat dhe i përdorin ato saktë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyre shtëpie: ushtrimi 5. Në programin *Word* mund të krijojnë një tabelë ku të tregojnë veçoritë e pjesëzave.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Vrarja e ndërgjegjes Azis Nesin Ora e parë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Lexon për të kuptuar përmbajtjen e tekstit për tu dhënë përgjigje pyetjeve të shtruara rreth tij.</p> <p>Përshkruan ndjenjat që lindin kur lexon tekstin.</p> <p>Përcakton kohën dhe vendin ku zhvillohet ngjarja.</p> <p>Gjen detajet në tekst me anë të cilave përshkruhen personazhet.</p> <p>Shpjegon shprehjet e dhëna dhe i vendos ato në kontekstin e fragmentit</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>ndërgjegjja, marrëdhënie, përmbajtje, shoqëri, varësi.</p>	
Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletore, materiale nga interneti.		Lidhja me fushat kurikulare:	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bisedë; Leximi zinxhir; Diskutim; punë e drejtuar.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I: Mësimi nis me rubrikën “Të kuptojmë tekstin”. Punohet me ushtrimet mbi përmbajtjen e tekstit. Nxënësit diskutojnë mbi bisedën e mësuesit atë ditë. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të diskutojnë mbi marrëdhënien e mësuesit me nxënësit. Çfarë ndodh rreth tyre çdo ditë në shkollë? Pse mësuesi është njeriu model që ata duan? Nxënësit shkruajnë në fletore titullin “Vrarja e ndërgjegjes”, secili nxënës jep mendimin e tij, mësuesi/ja shkruan në tabelë alternativat që jepen dhe arrijnë në një përfundim. Secili nxënës jep mendimin e tij. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin dhe të shikojnë kuptimin e titullit nëse është i njëjtë me kuptimin që i kanë dhënë ato. Nxënësit diskutojnë dhe bisedojnë mbi situatën në oborrin e shkollës dhe bisedojnë mbi marrëdhëniet që krijohen në shkollë midis nxënësve dhe mësuesve apo dhe midis tyre.

Hapi II: Mësuesi/ja i fton nxënësit të lexojnë fragmentin dhe për çdo pjesë hap pas hapi duhet të flasin mbi përmbajtjen dhe personazhet. Në fund të tregimit, mësuesi/ja shkruan disa pyetje në tabelë rreth të cilave nxënësit diskutojnë.

- Titulli i tregimit, emri i autorit, subjekti, tema, ideja, personazhet.

Hapi III: Nxënësit rikthehen në tekst për: ndarjen e tregimit në pjesë dhe vendosjen e titullit për çdo pjesë (Titujt na sjellin situata që ndodhin në ngjarje). Përcaktohet kuptimi i titullit. Nxënësit sjellin shembuj nga jeta e përditshme dhe diskutojnë mbi shembuj, duke shprehur dhe qëndrimin e tyre.

Gjejnë fjalët kyç të ngjarjes dhe të situatave që rrëfohen dhe i analizojnë ato.

Hapi IV: Ushtrim. Nxënësit ndahen në tre grupe. Secili prej tyre do të gjejë fjalët kyç me të cilat përshkruhet:

Grupi I – Vrarja e ndërgjegjes (ne mund të ndodhemi në situata të tilla).

Grupi II – Rrëfimi i mësimi (rrëfimi i zhvillimit të orës së mësimi).

Grupi III - Situata në oborr (dialogu i zhvilluar midis nxënësit dhe drejtorit).

Hapi V: Ushtrim. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të realizojnë përshkrimin e dy personazheve.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Shkruani në fletore një shkrim me temë: “Më ka vrarë dhe mua njëherë ndërgjegjja”.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Vrarja e ndërgjegjjes Azis Nesin Ora e dytë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Lexon për të kuptuar përmbajtjen e tekstit për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të shtruara rreth tij.</p> <p>Përshkruan ndjenjat që lindin kur lexon tekstin.</p> <p>Përcakton kohën dhe vendin ku zhvillohet ngjarja.</p> <p>Gjen detajet në tekst me anë të të cilave përshkruhen personazhet.</p> <p>Shpjegon shprehjet e dhëna dhe i vendos ato në kontekstin e fragmentit.</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>ndërgjegjja, marrëdhënie, përmbajtje, shoqëri, varësi.</p>	
Burimet: teksti "Gjuhë shqipe 7", fletore, materiale nga interneti.		Lidhja me fushat kurikulare:	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bisedë; Diskutim; Punë e drejtuar.</p>			

Organizimi i orës së mësim

Hapi I. Kjo orë fillon me diskutimin e detyrave të shtëpisë. Klasa është e ndarë në tre grupe, ku secili grup ka zgjedhur nga një përfaqësues për të lexuar detyrën e realizuar. Në fund të leximeve diskutohet mbi punët e prezantuara.

Hapi II: Nxënësit punojnë me tekstin duke gjetur figurat letrare, si: epiteti, krahasimi, metafora. Për secilën figurë letrare, nxënësit flasin edhe mbi funksionin stilistikor, forcën emocionale dhe shprehëse që merr fjala me përdorimin e tyre.

Hapi III: Mësuesi/ja diskuton me nxënësit mbi gjuhën e përdorur në fragment. Situatat e komunikimit dhe mënyra e realizimit të tyre. Llojet e fjalive të përdorura. Nxënësit ilustrjnë me shembuj nga teksti dhe diskutojnë rreth tyre.

Hapi IV. Mësuesi/ja vlerëson nxënësit që përshkruajnë ndodhinë, nxënësit që janë aktiv gjatë orës, ata që shprehen bukur mbi temën që trajtuan.

Inkurajon edhe nxënësit që përpiqen për të qenë pjesëmarrës në mësim dhe bën vlerësimin e orës së mësim.

Vlerësimi: për pergjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Të respektojmë njëri-tjetrin në shkollë		Situata e të nxënit: Të flasim mbi temën	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lexon tekste të ndryshme që flasin mbi temën. - Kupton rregullat që ekzistojnë në miqësinë dhe shoqërinë e vërtetë. - Flet mbi shoqërinë mbi marrëdhëniet e respektit të ndërsjelltë. - Tregon rastet nga jeta personale duke shprehur qëndrimin e tyre. - Krahason situatat që tregojnë këto marrëdhënie. 			<p>Fjalët kyç: respekt, marrëdhënie, shoqëri vlerësim.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor “Gjuha shqipe 7”, informacione mbi “Kodin e sjelljes në shoqëri”, videoprojektor, CD.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Empatia (karrigia e nxehtë); Bisedë; Intervista.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimimit</p> <p>Punë parapërgatitore: Mësuesi/ja përzgjedh grupe nxënësish dhe i vendos të luajnë role të ndryshme, si: prindër, mësues, drejtor, psikolog etj. Këto role i luajnë vetë nxënësit në pamundësi për të patur në këtë orë mësimi prindërit, gjyshëri, mësuesit etj.</p> <p>Hapi I. Mësuesi/ja, fillimisht, rregullon mjedisin fizik të klasës për të realizuar një komunikim më të mirë midis nxënësve me njëri-tjetrin dhe me ata që do të luajnë rolin e prindërit apo të mësuesit, të cilët do të sjellin përvojat e tyre ,por dhe do të jenë pjesë e situatave të kryera në klasë. Mjedis</p>			

fizik i klasës mund të rregullohet sipas modeleve që mësuesi/ja i shikon të përshtatshme.

Hapi II. Në këtë moment do të diskutohet mbi marrëdhëniet në shoqëri. Mësuesi/ja e zhvillon bisedën drejt përfshirjes së pjesëmarrësve në temën që trajtohet. E vendos temën e marrëdhënies në shoqëri në aspektin krahasues se çfarë ndodh në jetën e përditshme. Marrëdhënia shok-shoqe në realitetin e përditshëm. Nxënësit ftohen të flasin rreth situatave reale që janë gjendur vetë dhe i tregojnë duke shprehur qëndrimin e tyre.

Në pjesën e dytë të diskutimit, mësuesi/ja i orienton që të diskutojnë mbi marrëdhëniet mësues-nxënës. Nxënësit flasin mbi përvojën e tyre të përditshme. Pjesë e bisedës bëhet edhe mësuesi/ja.

Edhe të ftuarit, në këtë rast prindërit, flasin nga përvoja e tyre. Mësuesi/ja krijon një ambient të përshtatshëm që nxënësit të shprehen lirisht. Në këtë moment, një nxënës vendoset në qendër të klasës dhe nxënësit e tjerë ulen rreth tij. Ata i drejtojnë pyetje mbi temën që diskutohet në orën e mësimit.

Hapi III. Së fundi, tregohet mesazhi i rëndësishëm. Disa nxënës lexojnë njëri pas tjetrit këshillat për një marrëdhënie me respekt të ndërsjelltë.

Mësuesi/ja i shkruan në tabelë këshillat. Një nga nxënësit interviston disa prindër, mësues dhe nxënës duke i pyetur nëse i zbatojnë këto këshilla në marrëdhënie me të tjerët.

Mësuesi/ja bën shkurtimisht përmbledhjen e mësimit. Falënderon të ftuarit, përgëzon nxënësit për aktivizimin në zhvillimin e orës dhe bën vlerësimin e orës së mësimit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Përshkruani një situatë marrëdhënieje midis shokësh/shoqesh, se sa e rëndësishme është shoqëria midis tyre.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkolla ime		Situata e të nxënit: Shkruaj me fantazi	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Liston karakteristikat për shkollën që pëlqen më shumë. - Gjen fjalët kyçe që përdoren për përshkrimin e shkollës. - Diskuton rreth shkrimeve të dy bashkëmoshatarëve me temë: “Shkolla ime”. - Bashkëpunon në grup për përgatitjen e një posteri se si e imagjinon shkollën e tij. - Vlerëson punimet e shokëve dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin. 			<p>Fjalët kyçe:</p> <p>imagjinatë, krijimtari, ide, mendim, figura letrare, botë emocionale.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor “Gjuha Shqipe 7”, tabakë me ngjyra, fletë formati, shkumësa me ngjyra, postera, fotografi.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bisedë; Punë në grup; Shkrim i lirë; Turi i galerisë.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimimit</p> <p>Punë parapërgatitore</p> <p>Nxënësit, të ndarë në dy grupe, duhet të hulumtojnë e të sjellin informacione, fakte, foto, pamje filmike, ku tregohen shkolla bashkëkohore nga vende të ndryshme në Europë, por edhe pamje nga shkollat tradicionale.</p> <p>Grupi i parë, sjell imazhin e shkollës tradicionale.</p>			

Grupi i dytë, sjell foto, imazhin e shkollave bashkëkohore.

Duke parë këto imazhe, secili grup diskuton rreth tyre.

Hapi I: Nga materialet e lexuara në internet, nxënësit përshkruajnë shkollën e tyre. Të shkruash me imagjinatë, do të thotë të kesh shpirt të hapur, imazh, mendim të pavarur autonom, trup mendor të lirë. Diskutohen mbi tekstet e lexuara dhe komentohet mbi dëshirat se si e duam shkollën.

Hapi II: Nxënësit do të punojnë në dy grupe, duke shfrytëzuar pamjet e shfaqura në videoprojektor, fotot dhe materialet e sjella.

Nxënësit bisedojnë mbi imagjinatën dhe fantazinë e tyre rreth shkollës që duan të kenë.

Grupi i parë – Përgatit posterin e shkollës imagjinare.

Grupi i dytë – Përgatit posterin e shkollës reale.

Para se nxënësit të fillojnë nga puna, udhëzohen që të: ndajnë detyrat midis tyre; gjejnë mirëkuptim për atë që do të bëjnë; sistemojnë e përzgjedhin informacionet që do të shfrytëzojnë për posterin; zgjedhin nxënësin që do të prezantojë punën e grupit.

Mësuesi/ja kontrollon punën që bëjnë nxënësit, duke i ndihmuar ata për ta realizuar sa më mirë. Nxënësve u kërkohet që stendat të përgatiten në mënyrë estetike, sepse do të vlerësohen edhe në këtë drejtim. Pas përfundimit, posterat ngjiten në tabelë.

Në fund, grupet përzgjedhin nxënësin që do të prezantojë punën e grupit. Ai diskuton dhe formulon saktë mesazhin e posterit të grupit dhe të idesë që përcjell ky poster.

Hapi III: Nxënësit e secilit grup hartojnë një fjalor me fjalët kyç që do të përdorin në përshkrimin e shkollës. Mësuesi/ja shkruan në tabelë në krah të secili poster fjalët dhe nxënësit diskutojnë mbi idenë që kanë për shkollën.

Hapi IV: Nxënësit shikojnë fotot, imazhet dhe përshkruajnë duke i ndarë në disa plane.

Përshkrimi nis nga plani më i largët dhe për çdo plan nxënësit shkruajnë fjali. Më pas, me fjalitë ndërtojnë një tekst. Teksti ka një strukturë: hyrje - zhvillim - mbyllje.

Nxënësit i lexojnë përshkrimet mbi shkollën e tyre.

Hapi V: Mësuesi/ja falënderon nxënësit për: punën e tyre hulumtuese; bashkëpunimin në grup; shkrimet me ndjenjë.

Mësuesi/ja bën vlerësimin e orës së mësimi.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Pëshkruani shkollën tuaj.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Autobiografia (ora e parë)		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja prezanton disa shkrime të shkurtra autobiografike.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ punon në mënyrë të pavarur; ❖ respekton gjuhën shqipe duke shmangur fjalët e huaja gjatë të shkruarit; ❖ respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; ❖ vlerëson punët e të tjerëve; ❖ bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim. 		<p>Fjalë kyç:</p> <p>shkrim për jetën tënde, fakte, përjetime, ngjarje, kronologji.</p>	
<p>Burimet: teksti mësimor, shkrime të shkurtra autobiografike</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Histori</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lexim në heshtje; Diskutim.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja prezanton 3-4 shkrime të shkurtra autobiografike dhe kërkon nga nxënësit që diskutojnë rreth karakteristikave të tyre.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leximi i informacionit se ç'është autobiografia. - Leximi në heshtje i autobiografisë së Anton Pashkut. 			

- Diskutim rreth pyetjeve.
- Analizimi i fakteve, kujtimeve, përjetimeve.
- Krahasimi i autobiografisë së Anton Pashkut me ato të sjella nga mësuesi/ja.

Reflektim mbi rezultatet e arritura

Nisur nga autobiografia e Anton Pashkut, plotësoni tabelën me detaje nga teksti.Fakte	Përjetime	Kujtime
---	-----------	---------

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës:


Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: dallojnë formën dhe gjuhën e përshtatshmen në një shkrim autobiografik; dallojnë faktet nga përjetimet; analizojnë ngjarjet dhe njerëzit që ndikuan në jetë, karrierë etj.; shpjegojnë mënyrën e renditjes së ngjarjeve në këto shkrime.

Detyrë shtëpie: Sillni një shkrim autobiografik.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Autobiografia (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Nxënësi/ja prezanton shkrimin autobiografik.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ punon në mënyrë të pavarur; ❖ respekton gjuhën shqipe duke shmangur fjalët e huaja gjatë të shkruarit; ❖ respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; ❖ vlerëson punët e të tjerëve; ❖ bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim. 			<p>Fjalë e shprehje kyç: shkrim për jetën tënde, fakte, përjetime, ngjarje.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, shkrime të shkurtra autobiografike</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare: Histori</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Bisedë; Karrigia e nxehtë.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Nxënësi/ja prezanton shkrimin autobiografik dhe analizon karakteristikat e tij.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <p>Mësuesi/ja u thotë nxënësve që prezantojnë punët që kanë bërë dhe u drejton disa pyetje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë lloj shkrimi është biografia? - Kujt i kushtohet shkrimi biografik që ke sjellë? 			



- Si janë renditur ngjarjet?
- Cilat janë fakte, kujtime e përjetime?
- Kush ka ndikuar në shkollimin, kulturën, profesionin etj., të tij/saj?

Reflektim mbi rezultatet e arritura

Krahasoni shkrimin biografik me autobiografik duke nxjerrë të përbashkëtat e të veçantat e tyre:

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: dallojnë formën dhe gjuhën e përshtatshmen në një shkrim autobiografik; dallojnë faktet nga përjetimet; shpjegojnë mënyrën e renditjes së ngjarjeve në këto shkrime; gjejnë të përbashkëtat dhe të veçantat mes biografisë dhe autobiografisë.

Detyrë shtëpie: Sillni të dhëna autobiografike, si: fotografi, kujtime, fletë ditari etj.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë autobiografi		Situata e të nxënit: Punë e pavarur	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ punon në mënyrë të pavarur; ❖ respekton gjuhën shqipe duke shmangur fjalët e huaja gjatë të shkruarit; ❖ respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; ❖ vlerëson punët e të tjerëve; ❖ bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim. 			<p>Fjalë kyç:</p> <p>jetëshkrim, familje, shkollim, rend kronologjik, ngjarje, fakte, përjetime.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, të dhëna, fotografi, fletë ditari, kujtime etj.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Edukim figurativ, TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e pavarur; Diskutim; Vetëvlerërim.</p>			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Rikujtojmë njohuritë

Përmendni disa karakteristika të shkrimit autobiografik.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që t'u përgjigjen pyetjeve:

- Cilat janë karakteristikat gjuhësore?
- Si renditen veprimet në këto shkrime?
- A sillen fakte në këto shkrime, apo vetëm përjetime e kujtime?

Veprimet në situatë:

- Diskutim rreth pyetjeve të mësipërme.
- Diskutim rreth rregullave që duhet të kemi parasysh kur shkruhet një shkrim autobiografik.
- Punë e pavarur: përgatitja e shkrimit biografik për personin që ka sjellë materiale.
- Leximi i disa punimeve.
- Diskutimi rreth këtyre punimeve.
- Vlerësimi për punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i orës:**Vlerësimi i situatës**

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: dallojnë formën dhe gjuhën e përshtatshme në një shkrim autobiografik; sjellin kujtime, fakte e përjetime personale interesante; diskutojnë dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Përdorimi i pikës, i presjes dhe i pikëçuditëses në llojet e ndryshme të fjalive		Situata e të nxëniet: Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimin 1 me shenjat e pikësimit që mungojnë	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyç Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ol style="list-style-type: none"> dallon rastet ku nuk janë përdorur shenjat e duhura të pikësimit; vendos shenjat e pikësimit aty ku mungojnë; përdor saktë shenjat e pikësimit në gjuhën e shkruar. 			Fjalët kyç: pikë, presje, pikëçuditëse.
Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"			Lidhje me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Rishikim në dyshe; Di-Dua të di-Mësova më shumë; Diskutim, Punë e pavarur.			

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimin 1 me shenjat e pikësimit që mungojnë.

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në dërrasë.

Nxënësit plotësojnë në dyshe ushtrimin 1 me shenjat e pikësimit që mungojnë.

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë me tabelën Di-Dua të di-Mësova më shumë.

Fillimisht u kërkon të kujtojnë njohuritë mbi pikën, presjen dhe pikëçuditësen: çfarë shënojnë, ku vendosen, në ç'lloj fjalish përdoren.

Këto nxënësit i plotësojnë në fletore dhe mësuesi/ja i plotëson në tabelë.

Nxënësit drejtojnë pyetje për informacione që mendojnë se mund t'i marrin në mësim.

Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin dhe plotësojnë pjesen Mësova më shumë, tek tabela.

- Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive të reja dhe paqartësitë.

Veprimtari praktike:

Në dyshe, nxënësit punojnë ushtrimet 2-4 sipas kërkesave.

Në përfundim, ushtrimet diskutohen me të gjithë klasën. Mësuesi/ja është i vëmendshëm që të aktivizojë sa më shumë nxënës.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; njohin përdorimet e pikës, presjes dhe pikëçuditëses; vendosin këto shenja pikësimit aty ku mungojnë; përdorin saktë shenjat e pikësimit në gjuhën e shkruar.

Detyrë shtëpie: Ndërtoni një dialog ku të përdorni pikën, presjen, pikëçuditësen.

Shënim:Në mënyrë të ngjashme mund të zhvillohen dhe temat e tjera të drejtshkrimit.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “ Shtegtimet e Çajld e Haroldit ” Xh. Bajroni (ora e parë)		Situata e të nxënit: Prezantimi i disa fotografive të Bajronit me veshje shqiptare dhe diskutimi rreth tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje. Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: ❖ liston cilësitë e shqiptarëve që vlerëson Bajroni; ❖ tregon me fjalët e tij gjendjen shpirtërore të poetit kur largohet nga atdheu; ❖ përkufizon mesazhin që përcjellin vargjet; ❖ analizon figurat letrare të përdorura nga poeti; ❖ interpreton duke respektuar shenjat e pikësimit vargjet që poeti ua kushton shqiptarëve.			Fjalët kyç: atdhe, vatër, lamtumirë, bijtë e shqipes, trima, miq, besnik, mikpritës.
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, vepra “Çajld Haroldi”, Xhorxh Bajron			Lidhja me fushat kurikulare: Histori, Gjeografi
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Kllaster; Lexim i poezisë; Diskutim; Shkrim i lirë.			
Përshkrimi kontekstual i situatës Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme Mësuesi/ja prezanton fotografitë e Bajronit dhe shtron pyetjet: - A keni dëgjuar për poetin anglez, miku i shqiptarëve, Bajronin? - Çfarë dini për jetën e tij? - Po për miqësinë e tij me Ali Pashë Tepelenën?			

- A ju bën përshtypje fakti që poeti ka veshur kostume karakteristike të zonës së Jugut? Jepni mendimin tuaj.

Nxënësit me ndihmën e mësuesit/es plotësojnë kllasterin për Bajronin:

Ndërtimi i njohurive të reja

Parashikim me terma paraprakë:

Mësuesi/ja shkruan fjalët kyç në tabelë dhe u kërkon nxënësve që të bëjnë një përshkrim me këto fjalë.

Lexohen 3-4 punime nga nxënësit.

Veprimet në situatë:

- Leximi i përshkrimit të realizuar me fjalët kyç.
- Prezantimi i fragmentit të poemës.
- Diskutim rreth pyetjes: A përcillte përshkrimi juaj të njëjtën ide si ajo e poetit?
- Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e Bajronit nga mësuesi/ja.
- Interpretimi i vargjeve të poemës në fragment.
- Punimi i rubrikës “Zbëthejmë tekstin”.

Reflektim mbi rezultatet e arritura

Mësuesi/ja ndan klasën në dy grupe dhe kërkon nga nxënësit:

- Grupi i parë – përshkruani me 4-5 fjali gjendjen emocionale të poetit kur largohet nga atdheu.
- Grupi i dytë – përshkruani me 4-5 fjali cilësitë e shqiptarëve që Bajroni vlerëson.

Lexohen 2-3 punime dhe diskutohet rreth tyre.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: përshkruajnë gjendjen emocionale të poetit në çastet e largimit nga atdheu; identifikojnë dhe analizojnë cilësitë dhe vlerat e shqiptarëve që poeti përcjell në poemë; shprehin idetë dhe mendimet e tyre gjatë analizës së poezisë dhe interpretojnë bukur vargjet.

Detyrë shtëpie: Sillni në klasë të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e poetit.

Mësoni përmendsh vargjet nga “O Shqipëri ku lindi Iskanderi....” deri në fund.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: "Shtegtimet e Çajd Haroldit" Xh. Bajron (ora e dytë)		Situata e të nxënit: punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ liston cilësitë e shqiptarëve që vlerëson Bajroni; ❖ tregon me fjalët e tij gjendjen shpirtërore të poetit kur largohet nga atdheu; ❖ përkufizon mesazhin që përcjellin vargjet; ❖ analizon figurat letrare të përdorura nga poeti; ❖ interpreton duke respektuar shenjat e pikësimit vargjet që poeti ua kushton shqiptarëve. 			<p>Fjalët kyç: figura letrare, interpretim.</p>
<p>Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7", të dhëna mbi jetën dhe krijimtarinë e Bajronit</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare: Histori</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Shkrim i lirë.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme Diskutim rreth figurës së Xhorxh Bajronit si poet romantik.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja</p>			

Veprimet në situatë:

- Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e Bajronit.

- Interpretimi i poezisë nga disa nxënës.

- Punimi i rubrikës “Gjuha dhe stili”.

1. Çifti antonimik:

miq – armiq

2. Vargu ku duket toni lutës:

Shqipëri, lejomë të kthej sytë e mi, mbi ty, o nënë e rreptë, burrash të ashpër!

3. Figurat letrare:

O lamtumirë atdheu im - apostrof

gjëmon stuhia me tërbim – metaforë

pas diellit që flakëron - metaforë

si atij që perëndon – krahasim

im qen leh te porta – inversion

O Shqipëri ku lindi Iskanderi – apostrof

dërmoi përherë armiqtë – metaforë

me kordhën e tij kreshnike – epitet metaforik

Mbi ty , o nënë e rreptë _____ burrash të ashpër! – epitete

e zbeta hënë ndrin nëpër lugina – inversion

e zbeta hënë - epitet metaforik

hënë ndrin nëpër lugina - metaforë

Armiku ua pa kurrizin ndonjëherë? – pyetje retorike

Kush e duron si ata mundimin e luftës? - pyetje retorike

Si trima sulen ku t’i kërkojë i pari i tyre – krahasim i zgjatur (similitudë)

4. Fjalët kyç për të dhënë gjendjen në shtëpinë e Bajronit:

Vatër

zjarr

avlli

im qen

Reflektim mbi rezultatet e arritura

- Bëni një përshkrim të shkurtër ku të tregoni cilësitë e shqiptarëve që vlerëson Bajroni në poemë.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë cilësitë e shqiptarëve; shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë shkrimit; përdorin figurat letrare të mësuara; nxënësit analizojnë elementet e metrikës në poezi.

Detyrë shtëpie: Gjeni një krijim tjetër në vargje ose prozë, ku vlerësohen cilësitë e shqiptarëve.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Biografia (ora e parë)		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja prezanton disa shkrime të shkurtra biografike.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ punon në mënyrë të pavarur; ❖ respekton gjuhën shqipe duke shmangur fjalët e huaja gjatë të shkruarit; ❖ respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; ❖ vlerëson punët e të tjerëve; ❖ bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>jetëshkrim, fakte, përjetime ngjarje, biograf.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, shkrime të shkurtra biografike</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Histori</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lexim në heshtje; Diskutim.</p>			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja prezanton 3-4 shkrime të shkurtra biografike dhe kërkon nga nxënësit që diskutojnë rreth karakteristikave të tyre.

Veprimet në situatë:

- Leximi i informacionit se ç'është biografia.
- Leximi në heshtje i biografisë së Bajronit.
- Diskutim rreth pyetjeve.
- Analizimi i fakteve, kujtimeve, përjetimeve.
- Krahasimi i biografisë së Bajronit me ato të sjella nga mësues/ja.

Reflektim mbi rezultatet e arritura

Nisur nga biografia e Bajronit, plotësoni tabelën me detaje nga teksti.

Fakte	Përjetime	Kujtime

Vlerësimi i orës:**Vlerësimi i situatës**


Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: dallojnë formën dhe gjuhën e përshtatshmen në një shkrim biografik; dallojnë faktet nga përjetimet; analizojnë ngjarjet dhe njerëzit që ndikuan në edukimin dhe formimin e Bajronit; shpjegojnë mënyrën e renditjes së ngjarjeve në këto shkrime.

Detyrë shtëpie: Sillni një shkrim biografik.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Biografia (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Nxënësi/ja prezanton shkrimin biografik.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ punon në mënyrë të pavarur; ❖ respekton gjuhën shqipe duke shmangur fjalët e huaja gjatë të shkruarit; ❖ respekton rregullat drejtshkimore gjatë të shkruarit; ❖ vlerëson punët e të tjerëve; ❖ bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim. 			<p>Fjalët kyç: jetëshkrim, fakte, përjetime, ngjarje, biograf.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, shkrime të shkurtra biografike</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare: Histori</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lexim në heshtje; Diskutim.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Nxënësi/ja prezanton shkrimin biografik dhe analizon karakteristikat e tij .</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <p>Mësuesi/ja u thotë nxënësve që prezantojnë punët që kanë sjellë dhe u drejton</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë lloj shkrimi është biografia? - Kujt i kushtohet shkrimi biografik që ke sjellë? 			



- Si janë renditur ngjarjet?
- Cilat janë fakte, kujtime e përjetime?
- Kush e ka shkruar këtë shkrim ose vepër?

Reflektim mbi rezultatet e arritura

Krahasoni biografinë e Bajronit me shkrimin biografik që keni sjellë, duke nxjerrë të përbashkëtat e të veçantat e tyre:

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: dallojnë formën dhe gjuhën e përshtatshmen në një shkrim biografik; dallojnë faktet nga përjetimet; shpjegojnë mënyrën e renditjes së ngjarjeve në këto shkrime; gjejnë të përbashkëtat dhe të veçantat në biografinë e Bajronit me biografinë e personit që kanë zgjedhur.

Detyrë shtëpie: Sillni të dhëna biografike për një aktor, sportist, artist ose të afërmin tuaj.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë biografi		Situata e të nxënit: Punë e pavarur	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ punon në mënyrë të pavarur; ❖ respekton gjuhën shqipe duke shmangur fjalët e huaja gjatë të shkruarit; ❖ respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; ❖ vlerëson punët e të tjerëve; ❖ bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim. 			<p>Fjalët kyç: rend kronologjik.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, të dhëna për biografinë e personit (aktor, sportist, shkrimtar etj.)</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare: Edukim figurativ, TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e pavarur; Diskutim.</p>			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Rikujtojmë njohuritë

Përmendni disa karakteristika të shkrimit biografik.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që t'u përgjigjen pyetjeve:

- Cilat janë karakteristikat gjuhësore?
- Si renditen veprimet në këto shkrime?
- A sillen fakte në këto shkrime, apo vetëm përjetime e kujtime?
- Kush i shkruan biografitë?

Veprimet në situatë:

- Diskutim rreth pyetjeve të mësipërme.
- Diskutim rreth rregullave që duhet të kemi parasysh kur shkruhet një shkrim biografik.
- Punë e pavarur: përgatitja e shkrimit biografik për personin që ka sjellë materiale.
- Leximi i disa punimeve.
- Diskutim rreth këtyre punimeve.
- Vlerësimi për punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i orës:**Vlerësimi i situatës**

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të dallojnë formën dhe gjuhën e përshtatshmen në një shkrim biografik; diskutojnë dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Karnavalet e Korçës (ora e parë)		Situata e të nxënit: Shfaqet në projektor një sekuencë nga komedia për gati 10', me qëllim që nxënësit të jenë më të qartë për të analizuar personazhet, skenën, kostumet etj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.			
Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.			
Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç:	
❖ portretizon personazhet kryesorë;		komedi, akte, skena, dialog, monolog.	
❖ diskuton rreth festimit të karnavaleve;			
❖ zëvendëson fjalët dialektore me fjalët gjegjëse në gjuhën standarde shqipe.			
Burimet: teksti mësimor, projektor, CD		Lidhja me fushat kurikulare:	
		Edukim figurativ, Teatër, Edukim muzikor, TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lojë në role; Diskutim; Kllaster.			


Përshkrimi kontekstual i situatës

Shfaqet në projektor një sekuencë nga komedia për gati 10', me qëllim që nxënësit të jenë më të qartë për të analizuar personazhet, skenën, kostumet etj. Në fund të prezantimit, me ndihmën e mësuesit/es, ata tregojnë se çfarë u bëri përshtypje më shumë në këtë komedi. **Veprimet në situatë:**

Leximi i pjesës në role

Mësuesi/ja cakton nxënësit që do të interpretojnë fragmentin në tekst.

- Prezantimi i pjesës dhe diskutimi rreth saj.
- Përcaktimi i temës, ngjarjeve, personazheve, elementeve të skenës, kostumografisë.
- Bashkëbisedim rreth mënyrës së interpretimit të aktorëve dhe nxënësve.
- Identifikimi i elementeve të tekstit dramatik.
- Vlerësimi i punës së nxënësve për njëri-tjetrin.
- Nxënësit ndahen në grupe dhe secili plotëson elementet e kllasterit.



Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të portretizuar personazhe, përcaktojnë elementet e tekstit dramatik; shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë leximit në role.

Detyrë shtëpie: Punoni për të interpretuar me ndjenjë rolin e caktuar nga mësuesi/ja.

Sillni materiale me të dhëna për jetën dhe veprën e Spiro Çomorës.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Karnavalet e Korçës (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Lojë në role	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ diskuton rreth karakteristikave të gjuhës së personazheve; ❖ interpreton me emocion rolin e caktuar nga mësuesi/ja. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>interpretim, personazhe, maska, skenë.</p>	
<p>Burimet: teksti mësimor</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Edukim figurativ, Teatër, Edukim muzikor</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lojë në role; Punë në grupe; Bashkëbisedim.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Nxënësit lexojnë materialet me të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e autorit, grupi i skenografisë përgatit skenën, kurse grupet e aktorëve bëhen gati për të interpretuar pjesën.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i materialeve të detyrës dhe diskutimi i tyre. - Përgatitja e skenës. - Interpretimi i pjesës dramatike. - Bashkëbisedim rreth mënyrës së interpretimit të nxënësve. - Vlerësimi i punës së nxënësve për njëri-tjetrin. - Punimi i rubrikës “Gjuha dhe stili”. 			

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të portretizuar personazhe, përcaktojnë elementet e tekstit dramatik; shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë leximit në role.

Detyrë shtëpie: Punoni për të interpretuar me ndjenjë rolin e caktuar nga mësuesi/ja.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____


Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Artikuj gazete dhe reviste		Situata e të nxënit: Punë me grupe	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Liston karakteristikat e tekstit të artikujve. - Dallon temat e trajtuara në artikuj. - Tregon mbi mënyrën e ndërtimit të artikullit. - Shpjegon qëllimin e një artikulli. - Analizon gjuhën dhe strukturën e një artikulli. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>artikull, strukturë, përmbajtje, tematika, gjuha, tituj, nëntituj, mbitituj.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuha Shqipe 7”, gazeta të ndryshme, tabela, shkumësa, revista, artikuj me tematika të ndryshme, lapsa me ngjyra.</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bisedë; Hulimtim i përbashkët; Diagrami i Venit.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I: Mësuesi/ja i njeh nxënësit me artikujt e gazetave dhe të revistave. Tregon strukturë e tyre, përmbajtjen, qëllimin e një artikulli. Shpjegon rregullat e të shkruarit të një artikulli.

Hapi II: Mësuesi/ja i njeh nxënësit me mënyrën se si do të punohet për të shkruar një artikull gazete dhe reviste. Klasa ndahet në dy grupe. Grupi i parë punon me artikullin e gazetës dhe grupi i dytë me artikullin e revistës.

Hapi III: Udhëzohen nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur. Pas mbarimit të artikullit, nxënësit diskutojnë për mënyrën e ndërtimit, mbi strukturën dhe përmbajtjen. Flasin mbi gjuhën e artikullit të gazetës dhe revistës, mbi rolin që luan titulli, fotografia etj. Nxënësit, duke bashkëpunuar në dyshe për artikullin, hartojnë pyetje rreth elementeve të mësipërm. Njëri nxënës i dyshes ia drejton pyetjet një dysheje të zgjedhur prej tyre. Nëse përgjigjja nuk është e saktë apo e plotë, dyshja që bën pyetjen e saktëson atë. Pas diskutimeve, mësuesi/ja u thotë nxënësve të krahasojnë të dy artikujt, duke plotësuar Diagramin e Venit.



Hapi IV: Mësuesi/ja i fton nxënësit të lexojnë artikujt e gazetave në tekst. Punohen ushtrimet që kërkojnë analizën në tekst. Si janë organizuar informacionet në tekst. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi V: Nxënësit punojnë ushtrimet mbi artikullin e revistës. Vizatojnë në fletore skemën e komunikimit dhe e plotësojnë atë me tekstet. Elementet e skemës së komunikimit janë: dhënësi, kodi, kanali, refernti, mesazhi, marrësi.

Ushtrimi mbi “Teknologjinë” duhet të ripunohet nga ana drejtshkrimore. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të rikujtojnë rregullat drejtshkrimore dhe t’i zbatojnë në ripunimin e tekstit. Diskutojnë së bashku mbi rregullat drejtshkrimore. Mësuesi/ja i shkruan në tabelë fjalët që duhet të punojnë që janë me gabime drejtshkrimore dhe argumenton se si duhet të shkruhen saktë ato. Në fund të orës, mësuesi/ja bën vlerësimin e punës në grup, në çifte dhe punën në mënyrë individuale.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punë e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Shkruani një artikull për gazetën e shkollës me titull: “Shkolla jonë, qendër komunitare”.

Planifikimi ditor (ditar)



Diktim

(Në këtë diktim testohen njohuritë për përdorimin e shenjave të pikësimit në ligjeratën e drejtë dhe në dialog.)

Isha ngarkuar nga shokët që, natë për natë, të vizitoja të gjitha qelitë dhe të shikoja gjendjen e shokëve të izoluar. Kuptohet, këtë e bëja kur ishin ata gardianë me të cilët kishim krijuar lidhje.

Kur arrita në birucën nr. 8, më prisnin dy shokë shqiptarë dhe një sloven.

- Në rregull, - u thashë. - Të gjitha ushqimet u dorëzuan.

Në oborrin e burgut u dëgjuan të qarat e një fëmije. Për herë të parë, pas shtatëmbëdhjetë muajsh në burg, dëgjova të qante një fëmijë në oborrin e burgut. Kërkonte nënën. Një grua i përgjigjej: "Fli, se nëna do të vijë! Fli, se nëna ka shkuar te babi. Fli, se nëna dhe babi do vijnë në agim me diellin dhe hënën. Me hënën dhe diellin në dorë për ty, Martinko. Po dielli dhe hëna janë shumë larg... shumë larg..."

Sloveni e dëgjonte dhe na e përkthente. Gruaja vazhdonte derisa fëmija pushoi së qari.

- Sa janë, Islam? - pyeti gardianin një shok.

- Në oborr janë treqind veta. I sollën nga Cetina. Shumica janë plaka. Ka pak vajza. Pak gra dhe disa fëmijë, - u përgjigj Islami.

Marrë nga "Nata e Ustikës"

Petro Marko

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Emisioni informativ		Situata e të nxënit: Të dëgjojmë me vëmendje	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon përmbajtjen e lajmit; - shpjegon fjalët e panjohura; - plotëson me përgjigje pyetjet; - analizon strukturën e lajmit. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>emision, komunikim, lajm, problematikë, informacion.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletore, lajmet, videoprojektor, CD me informacione</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë; Dëgjim në heshtje; Diskutim.</p>			

Organizimi i orës së mësim

Hapi I: Dëgjohet një emision informativ-lajme dhe nxënësit bisedojnë rreth efektit që shkakton lajmi tek dëgjuesi. Përshkruan ndjesitë dhe përcakton temën e lajmit. Mësuesi/ja u drejton këto pyetje nxënësve:

Çfarë problemi trajton lajmi?

Sa informacion morët pas dëgjimit të emisionit?

Mësuesi/ja tregon interes për të dëgjuar përgjigjet e nxënësve, por pa u zgjatur shumë në kohë.

Hapi II: Mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjet:

- vendi ku ndodhën ngjarjet;
- koha kur ka ndodhur ngjarja;
- protagonistët;
- qëllimi i lajmit.

Për të patur një informacion më të plotë, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të dëgjojnë përsëri lajmin.

Hapi III: Udhëzohen nxënësit të plotësojnë skemën e komunikimit me elementet përbërës. Çdo element ilustron me informacionin e dëgjuar nga lajmet.

Elementet e komunikimit janë: dërguesi – kodi – referenti – mesazhi – kanali - marrësi.

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të ndërtojnë një fjalor me fjalë nga fusha të caktuara të nxjerra nga dëgjimi i lajmeve. Diskutohen në klasë. Në këtë moment nxënësit përdorin Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe.

Hapi IV: Për rreth 15 min, nxënësit plotësojnë tabelën e pyetjeve: “Kush?”, “Kur?”, “Ku?”, “Pse?”, “Si?” me të dhënat e marra nga dëgjimi i lajmeve.

Gjatë përgjigjeve të nxënësve, mësuesi/ja përpiket të përfshijë sa më shumë nxënës. Motivohen nxënësit që bashkëpunojnë dhe të jenë aktiv në çdo etapë të zhvillimit të mësim.

Hapi V: Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të analizojnë tekstin nga ana gjuhësore. Mënyra e ndërtimit të paragrafëve, llojet e fjalive të përdorura, koha dhe mënyra e foljeve. Të gjitha këto pyetje ilustron me tekstin e lajmit.

Në fund të orës, mësuesi/ja bën vlerësimin e nxënësve.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Plaku dhe deti Ernest Heminguej		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Ora e parë			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Lexon tregimin dhe përcakton temën që trajtohet.</p> <p>Kupton përmbajtjen e tregimit nëpërmjet vënies së vetes në rolin e një personazhi të tregimit.</p> <p>Përcakton elementet e komunikimit dhe sidomos të monologut e dialogut në tregim.</p> <p>Analizon situatat në tregim dhe mban qëndrim mbi personazhet dhe veprimet e tyre.</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>peshkaqen, det, fitore, luftë për ekzistencë, krenari.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, tabakë të bardhë, informacionet e hulumtuara nga nxënësit, fletore, harta e Shqipërisë, CD, Filmi “Plaku dhe deti”.</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Lexim në heshtje; Punë e pavarur; Karrigia e nxehtë.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>Hapi I. Mësimi fillon duke i njohur nxënësit me titullin dhe autorin e tregimit. Pasi njihen me përmbajtjen e tregimit, duke mos e zbuluar fundin e saj, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë tregimin në heshtje e me kujdes për t’u njohur me personazhet: plakun Santiago, peshkatarët, djalin Manolo dhe zhvillimin e ngjarjes deri në fund të tregimit.</p> <p>Hapi II. Në përfundim të leximit, mësuesi/ja sqaron mënyrën e zhvillimit të mëtejshëm të veprimtarisë mësimore. Caktohet një nxënës (edhe në mënyrë</p>			

vullnetare), që të luajë rolin e personazhit të peshkatarit dhe të djalit Manolo. Këta dy nxënës duhet të kuptojnë karakteret e personazheve që do të luajnë. Për këtë i referohen tregimit dhe filmit. Vihet një karrige para klasës (karrigia e nxehtë) në të cilën ulet nxënësi që do të jetë në rolin e peshkatarit dhe thotë: “Unë jam Santiago, çfarë doni të dini prej meje?”

Nxënësit e tjerë duhet të bëjnë pyetje për: qëllimin, shtysat, ndjenjat, shqetësimin, guximin, krenarinë, luftën me peshkaqenet, detin, misterin e tij, fitoren apo disfatën e tij në det etj. P.sh., pyetjet mund të jenë të tilla:

Ku zhvillohet ngjarja? Ku jeton Santiago?

Kush është Santiago?

Cila është lidhja e Santiagos me detin?

Çdo të thotë të jesh peshkatar?

Jeni ndjerë krenar apo i humbur në lidhje me detin?

Sigurisht që nxënësi që është në rolin e Santiagos duhet të ketë lexuar me vëmendje tregimin disa herë që mund t’u përgjigjet pyetjeve. Këtë fakt mësuesi/ja e thekson që në fillim të leximit të tregimit. Zhvillohet një diskutim rreth tekstit. Mësuesi/ja i orienton dhe plotësojnë informacionet mbi fragmentin për pyetjet që i drejtohen Santiagos (nxënësit).

Hapi III: Mësuesi/ja shkruan në tabelë elementet e skemë së komunikimit dhe fton nxënësit të plotësojnë këto elemente duke i ilustruar me fragmentin.

Elementet e skemës së komunikimit janë: dhënësi – kanali – referenti – kodi – mesazhi - marrësi.

Diskutohet rreth plotësimin të skemës së komunikimit.

Hapi IV: Nxënësit diskutojnë rreth personazheve të Santiagos dhe Manolos. Japin mendime mbi ngjarjen dhe situatat që kalon peshkatarin Santiago, mbi humbjet dhe fitoret e tij.

Hapi V: Në përfundim, mësuesi/ja vlerëson nxënësin që është në rolin e Santiagos për përgjigjet që jep, si dhe nxënësit e tjerë për mënyrën e ndërtimit të pyetjeve në dobi të zbërthimit të përmbajtjes së tregimit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie: Përshkruani personazhin e Santiagos duke u përqendruar në detajet e tekstit.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Plaku dhe deti Ernest Heminguej Ora e dytë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ilustron me fragmente nga teksti gjendjen emocionale të Santiagos. - Shpjegon kuptimin e fjalëve kyc dhe i grupon ato sipas klasave të fjalëve. - Shpreh me një gjuhë të saktë dhe të pranueshme ato çfarë ndjen pasi ka dëgjuar brengën e Santiagos. - Interpreton dialogun e Santiagos me Manolon. - Analizon monologun e Santiagos në aspektin e ndërtimit letrar dhe gjuhësor. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>peshkaqen det fitore lufte per ekzistencë krenari zhgënjim gjëndje emocionale</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, tabakë të bardhë, informacionet e hulumtuara nga nxënësit, fletore, lapsa me ngjyra, shkumësa me ngjyra, harta e Shqipërisë, CD, film, fotografi.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bisedë; Ditari dypjesësh; Lojë me role; Punë me grupe.</p>			

Organizimi i orës së mësim

Hapi I: Mësimi nis me pyetjet rreth detyrës së shtëpisë dhe diskutimit të saj.

Ushtrim. Nxënësit lexojnë dhe flasin mbi personazhin e Santiagos. Mënyrën e përjetimit të tij në mes të detit. Ardhjen e tij me varkën në bregun e detit, dhimbjen që ndjen ai. Mësuesi/ja i fton nxënësit të flasin se përse Santiago është i brengosur. Mendimet i ilustron nga fragmenti.

Hapi II : *Ushtrim.* Nxënësit e lexojnë disa minuta pjesën e dialogut midis Santiagos e Manolos. Djaloshi Manolo është përshkruar me ngrohtësi. Cilat tipare të karakterit zbulohen tek ai? Si e shpreh dashurinë, respektin dhe kujdesin për Santiagon?

Ushtrim. Zhvillohet në formën e bisedës. Nxënësit tregojnë raste kur u ka ndodhur të jenë të brengosur, kur kanë folur me dikë dhe shqetësimi i tyre, a janë ndierë më të lehtësuar. Pas kësaj mësuesi/ja u kërkon nxënësve të gjejnë në tekst fragmentin kur Santiago flet me Manolon. Nxënësit lexojnë dhe komentojnë. Mund të përdoret ditari dypjesësh.

Pasi nxënësit plotësojnë tabelën në mënyrë individuale, diskutohen bashkërisht përgjigjet me të gjithë klasën.

Hapi III: Mësuesi/ja fton nxënësit të punojnë me ushtrimet e rubrikës: “Gjuha dhe Stili”.

Klasa ndahet në grupe. Secili grup punon pyetjet e mëposhtme:

Grupi i parë : Dalloni në tekst figurat letrare, epitetin, kphasimin dhe realizoni zbërthimin e funksionit stilistik të tyre.

Grupi i dytë: Dalloni detajet e përshkrimit të gjendjes emocionale të Santiagos dhe të situatës në të cilën ndodhet ai .

Grupi i tretë: Dalloni fjalë kyç të dialogut midis Santiagos dhe djalit Manolo. Grupojini ato sipas klasave të fjalëve.

Hapi IV: Mësuesi/ja kërkon që një nxënës vullnetar të realizojë monologun e Santiagos.

Në fund të orës, mësuesi/ja bën vlerësimin e nxënësve aktiv gjatë orës së mësim.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Kryefjala dhe mënyrat e shprehjes		Situata e të nxënimit: Nxënësit lexojnë fjalitë në tekst dhe nënvizojnë kryefjalët (Metoda: të nxënimit me këmbime).	
<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve), duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon kryefjalën; - përcakton në fjali kryefjalën e shprehur me emër, përemër dhe grup emëror; - formon fjali me kryefjalë të shprehur në mënyra të ndryshme. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>kryefjalë, gjymtyrë kryesore, grup emëror, përcaktor.</p>

Burimet: teksti "Gjuha shqipe7"	Lidhja me fushat kurikulare: TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënimit me këmbime; Shpjegim i kombinuar me diskutim, Praktikë e pavarur (punë në dyshe).	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Nxënësit lexojnë fjalitë në tekst dhe nënvizojnë kryefjalët (Metoda: të nxënimit me këmbime)</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në dyshe, nxënësit lexojnë fjalitë në fillim të mësimit dhe nënvizojnë kryefjalët. Për secilin rast gjejnë se me se është shprehur dhe pyetja me të cilën gjendet. - Një nxënës lexon me zë rubrikën Mbani mend. Nxënësit nënvizojnë në libër me se shprehet kryefjala. - Mësuesi/ja shkruan në dërrasë skemat: <p>Kryefjalë e shprehur me GE</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Përemër (dëftor, pronor pyetës, i pacaktuar) + Emër në trajtën e pashquar b. Emër + Emër c. Emër + Mbiemër d. Numëror + Emër <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit ndërtojnë shembuj për secilin rast sipas skemave. <p>Veprimtari praktike:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 1. Dallojnë kryefjalën dhe thonë me se është shprehur. - Punohen ushtrimet dy dhe tre në fletore të klasës. Zgjerojnë kryefjalën me përcaktorë. Ndërtojnë fjali me GE të dhëna. - Mësuesi/ja diskuton zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit. 	
<p>Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.</p> <p>Vlerësimi i situatës:</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë kryefjalën, përcaktojnë me se është shprehur, përdorin saktë kryefjalën në gjuhën e folur dhe të shkruar.</p> <p>Detyrë shtëpie:</p>	

Ushtrimi 4, sipas kërkesës. Prezantim në <i>Power Point</i> i njohurive për kryefjalën.			
Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa:VII
Tema mësimore: Shkruajmë një rregullore (Ora e parë)		Situata e të nxënit: Punë në grupe	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje. Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Listojnë karakteristikat e rregulloreve. - Përdor një gjuhë teknike dhe leksike të përshtatshme për rregulloren. - Shkruan një rregullore duke u mbështetur në rregulla. - Vlerësojnë punimet e njëri-tjetrit.		Fjalët kyçe: rregullore, strukturë, përmbajtje, rregulla.	
Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, tabak, ngjitëse, rregullore institucionesh - modele, materiale nga interneti, CD, fletore, shkumësa, tabelë.		Lidhja me fushat kurikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në grup; Diskutim; Punë individuale; Turi i galerisë.			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I: Do të jetë faza përgatitore për t'i ndihmuar nxënësit të njohin rregulloren. Të njohin strukturën, përmbajtjen dhe rregullat e ndërtimit të tekstit të rregullores.

Hapi II: Do të jetë punë e pavarur, ku nxënësit do të zgjedhin një institucion dhe do të shkruajnë rregulloren përkatëse. Këtë rregullore do ta shkruajnë në fletore. Le t'i shohim më konkretisht në mënyrën e realizimit të secilës fazë.

Hapi III: Nxënësit punojnë në mënyrë individuale duke u njohur me strukturën dhe përmbajtjen e rregullores. Në videoprojektor, mësuesi/ja shfaq një rregullore. Rregullorja ka këto elemente:

-Sjellje të përgjithshme.

-Sjellje të detyruara.

-Sjellje të ndaluara.

Hapi IV: Ndahet klasa në tre grupe. Secilit grupi i jepet një nga elementet e rregullores. Për këtë, nxënësit diskutojnë e më pas shkruajnë në tabak të bardhë me bojëra uji. Përfaqësuesi i secilit grup afishon në tabelë punën e bërë dhe ua prezanton atë grupeve të tjera.

Hapi V: Nxënësit siç janë të ndarë në grupe bashkojnë elementet e rregullores dhe realizojnë rregulloren e plotë për institucionin. Në përfundim të detyrës organizohet Turi i galerisë. Punimet e tyre nxënësit i afishojnë në muret e klasës. Secili nxënës mund të lëvizë nëpër klasë dhe të lexojë rregullore të ndryshme. Mësuesi/ja bën vlerësimin e punës në grup dhe të prezantimit të rregullores.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Hartoni një rregullore për klasën tuaj. Respektoni strukturën e saj.

Planifikimi ditor (ditar)

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë rregullore Tekst joletrar (Ora e dytë)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Liston karakteristikat e tekstit të rregullores. - Përcakton tiparet e strukturës dhe të organizimit të rregullores. - Zbërthen elementet e komunikimit të tekstit të rregullores. - Shkruan rregulloren dhe zbaton elementet përbërës të saj. - Analizon në formë dhe përmbajtje rregulloren. 			<p>Fjalët kyçe:</p> <p>rregullore, strukturë, përmbajtje, skemë, komunikim, sjellje të përgjithshme, sjellje të detyruara, sjellje të ndaluara.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, materiale nga interneti, rregullore institucionesh të ndryshme.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <p>Punë e pavarur; Lexim në heshtje; Punë në çift.</p>			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: Mësimi fillon me njohuri mbi rregulloren. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të përqendrohen te këndi i klasës. Nxënësit lexojnë në heshtje rregulloren e klasës. Në mënyrë të pavarur, secili nxënës dallon sjellje të përgjithshme, sjellje të detyruara dhe sjellje të ndaluara. Mësuesi/ja shënon në tabelë veprimet për secilin rast, i komenton ato duke i ilustruar me shembuj. Edhe nxënësit janë pjesëmarrës në diskutime, duke treguar shembuj nga situata të përditshme.

Hapi II: Mësuesi/ja fton nxënësit të punojnë në çift. Nxënësit diskutojnë me shokun ose shoqen për të krijuar një mendin të përbashkët mbi strukturën e një rregulloreje, se si mund ta formulojnë një rregullore.

Hapi III: Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të jenë të vëmendshëm në dëgjimin e një rregulloreje të hartuar nga vetë ata. Mësimi vazhdon me bllok pyetjesh rreth rregullave që mësuesi/ja u drejton nxënësve:

- Çfarë është një rregullore?
- Si strukturohet ajo?
- Cilët janë elementet përbërës të rregullores?
- Cila është përmbajtja e një rregulloreje?
- Përse përdoret një rregullore?

Mësuesi/ja dëgjon më vëmendje diskutimet që zhvillohen për 10 minuta. Mësuesi/ja përpiqet të përfshijë sa më shumë nxënës në dhënien e përgjigjeve.

Vlerëson orën e mësimit, motivon aktivizimin e nxënësit në çdo situatë.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Lundroni në internet për të dhëna dhe hartoni një rregullore institucioni për të cilin ju do të donit ta drejtoni atë në të ardhmen.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Kallëzuesi foljor. Mënyrat e shprehjes		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja prezanton në PowerPoint ose në tabakë të bardhë dy tabela që përmbledhin konceptet kryesore të kryefjalës dhe kallëzuesit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
Nxënësi/ja:			
1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi;			
2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim.			
3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;			
4. shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë;			
5. përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç:	
Nxënësi/ja:		kallëzues foljor, gjymtyrë kryesore.	
- dallon kallëzuesin në fjali;			
- përcakton me se është shprehur ai;			
- formon fjali me kallëzues të ndryshëm foljorë.			
Burimet: Teksti “Gjuha shqipe7”		Lidhja me fushat kurikulare: TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Prezantim në PowerPoint; Tabela e koncepteve; Praktikë e pavarur; Të nxënit me këmbime.			

Përshkrimi kontekstual i situatës**Veprimet në situatë:**

- Mësuesi/ja prezanton në PowerPoint ose në tabakë të bardhë dy tabela që përmbledhin konceptet kryesore të kryefjalës dhe kallëzuesit:

a.

Kryefjala	Me se shprehet	Pyetja	Vendi në fjali
Gjithë natyra	GE	Cila?	në fillim të fjalisë
-			

b.

Kallëzuesi	Lloji	Pyetja	Nga se ndërtohet?
buzëqeshte	foljor	Ç'bënte ajo?	folje, mënyra dëftore, koha e pakryer, veta e tretë njëjës.

- Nxënësit dallojnë në tekstin e dhënë kryefjalët dhe plotësojnë tabelën e koncepteve.

- Nxënësit thonë ç'funktion kryejnë fjalët me shkronja të zeza dhe i vendosin ato te tabela e koncepteve për kallëzuesit.

- Një nxënës lexon me zë llojet e kallëzuesve që jepen në libër, ndërkohë nxënësit nënvizojnë në libër konceptet kryesore.

- Mësuesi/ja u kërkon dy-tre nxënësve të flasin për mënyrat e të shprehurit të kallëzuesit foljor, si dhe të plotësojnë me shembuj të tjerë të krijuar nga ata vetë.

Veprimtari praktike:

a. Ushtrimi 1 punohet me gojë, ku nxënësit gjejnë kallëzuesin në çdo fjali dhe plotësojnë tabelën për kallëzuesin.

b. Ushtrimi 2 punohet në fletore. Një nxënës e punon në dërrasë. Në fund shpjegohet lloji i kallëzuesit foljor.

c. Nxënësit formojnë fjali me kallëzues foljorë të shprehur me forma të ndryshme.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.**Vlerësimi i situatës**

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, dallojnë kallëzuesin në fjali; përcaktojnë me se është shprehur; përdorin saktë kallëzuesin në gjuhën e folur dhe të shprehur.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 4, sipas kërkesës.

Prezantim në PowerPoint i njohurive për kallëzuesin foljor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Kallëzuesi emëror, mënyrat e shprehjes		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja përgatit fisha me fjali ku janë përdorur kallëzues emërorë me pjesën emërore të shprehur me mbiemër, emër, grup emëror, përemër, numëror.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë; përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon kallëzuesin emëror në fjali; - përcakton me se është shprehur ai; - formon fjali me kallëzues emëror. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>kallëzuesit emërorë, folja këpujë jam, gjymtyrë emërore.</p>	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe7”		Lidhja me fushat kurikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Rishikimi në dyshe; Të nxënit me këmbime; Shpjegim; Praktikë e pavarur.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja përgatit fisha me fjali ku janë përdorur kallëzues emërorë me pjesën emërore të shprehur me mbiemër, emër, grup emëror, përemër, numëror.

Veprimet në situatë:

- Nxënësit lexojnë në dyshe fjalitë në fisha, nënvizojnë dhe përcaktojnë me se shprehet gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror.

- Mësuesi/ja shkruan në dërrasë skemat:

Kallëzuesi emëror përbëhet nga:

Folja **jam** (përdoret në të gjitha mënyrat, kohët, vetat, numrat) +

a. mbiemër i nyjshëm/i panyjshëm,

b. emër,

c. grup emëror,

d. përemër,

e. numëror.

- Nxënësit identifikojnë në tekst si janë ndërtuar kallëzuesit emërorë duke u mbështetur në skemat e dhëna.

- Mësuesi/ja shpjegon rastet kur folja **jam** është folje me kuptim të plotë (zëvendësohet me foljet ndodhem, gjendem); kur përdoret si folje ndihmëse në kohët e përbëra dhe kur përdoret si këpujë. Në të dyja rastet e para është kallëzues foljor ose pjesë e kallëzuesit foljor.

Veprimtari praktike:

- Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 1 dhe 2 në tekst. Dallojnë kallëzuesit emërorë dhe thonë me se janë shprehur.

- Në ushtrimin 3, nxënësit dallojnë kur folja **jam** është këpujë dhe kur është kallëzues foljor. Dy nxënës e punojnë ushtrimin në dërrasë.

- Mësuesi/ja diskuton për zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të :zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë kallëzuesin emëror në fjali; përcaktojnë me se është shprehur; përdorin saktë kallëzuesin emëror në gjuhën e folur dhe të shprehur.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4, sipas kërkesës.

Prezantim në Power Point i njohurive për kallëzuesin emëror.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____


Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “Hymni i flamurit”, F. Noli (ora e parë)		Situata e të nxënit: Prezantim i një fotografie që tregon ngritjen e flamurit nga Ismail Qemali.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ përkufizon mesazhin që përcjell Noli në këtë poezi; ❖ identifikon simbolet e një kombi; ❖ përcakton llojin e poezisë sipas tematikës; ❖ gjen figurën e aliteracionit në poezi; ❖ interpreton me ndjenjë vargjet. 			<p>Fjalët kyç: fushëkuq, vatër, nënë, babë, diell, rrëzove, u ngrite, vrapove.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, fotografi e momentit të ngritjes së flamurit në 1912-ën, krijime të ndryshme të Nolit.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare: Histori, Edukim figurativ, Edukim muzikor</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë; Kllaster; Leximi i poezisë; Diskutim; Shkrim i lirë.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Pasi prezantohet fotografia që tregon momentin e ngritjes së flamurit në 28.11.1912, mësuesi/ja shtron disa pyetje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë ju kujton kjo pamje? 			

- Tregoni disa momente kyç në historinë e popullit tonë.
- Cilët shkrimtarë që kanë shkruar poezi për flamurin njihni ju?
- Ç'është himni?

Këngë solemne që i kushtohet atdheut dhe mbahet simbol i njësisë së kombit e të shtetit; këngë që një grup shoqëror e ka si simbolin e vet.

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme

Nxënësit me ndihmën e mësuesit/es plotësojnë kllasterin për veçoritë e tekstit poetik:



Ndërtimi i njohurive të reja

Parashikim me terma paraprakë:

Mësuesi/ja shkruan fjalët kyç në tabelë dhe u kërkon nxënësve që të bëjnë një përshkrim me këto fjalë.

Lexohen 3-4 punime nga nxënësit.

Veprimet në situatë:

- Lexim i përshkrimit të realizuar me fjalët kyç.
- Prezantimi i poezisë.
- Diskutim rreth pyetjes: A përcillte përshkrimi juaj të njëjtën ide si ajo e poetit?
- Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e F. Nolit nga mësuesi/ja.
- Interpretimi i vargjeve të poemës në fragment.
- Punimi i fjalorit.
- Shpjegimi i figurës letrare të aliteracionit.
- Punimi i rubrikës “Zbëthejmë tekstin”.

Reflektim mbi rezultatet e arritura**Minitest**

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të nxjerrin mesazhin e poezisë.

Vlerësimi i orës:**Vlerësimi i situatës**

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: formulojnë mesazhin e poezisë; identifikojnë dhe analizojnë figurat dhe ngjarjet historike që poeti përmend në poezi; shprehin idetë dhe mendimet e tyre gjatë analizës së poezisë dhe interpretojnë bukur vargjet.

Detyrë shtëpie: Sillni në klasë të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e poetit.

Mësoni përmendsh poezinë.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “Hymni i flamurit” F. S. Noli (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ përcakton llojin e poezisë sipas tematikës; ❖ gjen figurën e aliteracionit në poezi; ❖ shpjegon elementet e metrikës; ❖ interpreton me ndjenjë vargjet. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>analizë metrike, aliteracion, figura letrare, interpretim.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, të dhëna mbi jetën dhe krijimtarinë e F. Nolit</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Histori</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Interpretim; Shkrim i lirë.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme</p> <p>Diskutim rreth figurës së Fan Nolit si: poet, dramaturg, përkthyes, politikan, prift.</p> <p>Formulimi i mesazhit.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <p>- Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e Nolit.</p>			

- Interpretimi i poezisë nga disa nxënës.

- Punimi i rubrikës “Gjuha dhe stili”.

1. Mesazhi që përcjellin vargjet:

Përpjekjet e shqiptarëve për liri kanë qenë pa fund në shekuj, herë kemi humbur e herë kemi fituar, por kurrë nuk jemi mposhtur.

2. Sa vargëshe janë strofat dhe cila është rima e përdorur?

Strofa - 4-vargëshe.

Rima - AAAB (tri vargjet e para rimojnë me njëra-tjetrën).

3. Vargjet ku është përdorur aliteracioni:

Fortesë shkëmbi **tmerr tirani**

Dhe në **furtun' i funtmi** u shove,

Me zjarr e zi u ndeze u nxive.

4. Figurat letrare:

O Flamur gjak, o flamur shkabë - apostrof

O vënd e vatr' o nën' e babë - apostrof

Lagur me lot, djegur me flagë - metaforë

S'të trëmb Romani, as Venecjani/ As Sërb Dushani, as Turk Sulltani - enumeracion

Flamur bujar - epitet metaforik

Yll i pavdekur - epitet metaforik

Me zjarr e zi u ndeze u nxive - metaforë

Për botën ëndr' e qiell i ri - epitet

Reflektim mbi rezultatet e arritura Minitest

Ç'është figura letrare e aliteracionit?

Vlerësimi i orës:**Vlerësimi i situatës**

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë vlerat e simboleve kombëtare; shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë shkrimit; identifikojnë figurën letrare të aliteracionit; analizojnë elementet e metrikës në poezi.

Detyrë shtëpie: Gjeni një krijim tjetër në vargje ose prozë ku vlerësohen simbolet kombëtare.

Planifikimi ditor (ditar)



Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Kallëzuesi i përbërë, mënyrat e shprehjes		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja prezanton tabelën Di-Dua të di-Mësova më shumë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë; përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon kallëzuesin e përbërë në fjali në fjali; - përcakton me se është shprehur ai; - formon fjali me kallëzues të përbërë. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>kallëzues i përbërë, folje modale gjysmëndihmëse, folje gjysmëndihmëse</p>	
Burimet: teksti "Gjuha shqipe7"		Lidhja me fushat kurikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Di-Dua të di-Mësova; Shpjegim i kombinuar me diskutim; Të nxënit me këmbime (punë me grupe).			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja prezanton tabelën Di-Dua të di-Mësova më shumë.

Në dyshe, nxënësit plotësojnë pjesën Di dhe Dua të di.

Veprimet në situatë

- Nxënësit flasin rreth njohurive që kanë për kallëzuesit, llojet dhe si shprehen. Plotësojnë në fletoret e tyre kolonën Di. Mësuesi/ja plotëson në tabelë.
- Nxënësit drejtojnë pyetje rreth kallëzuesit të përbërë foljor. Pyetjet shkruhen në kolonën Dua të di. Mësuesi/ja plotëson në tabelë.
- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe të plotësojnë pjesën Mësova më shumë.
- Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive të reja duke u ndalur tek pjesët përbërëse të kallëzuesit foljor të përbërë, dhe rastet kur foljet mund të jenë me kuptim të plotë dhe si gjysmëndihmëse.

Veprimtari praktike:

Praktikë e drejtuar: mësuesi/ja punon me nxënësit ushtrimin 1. Dallohen kallëzuesit foljorë të përbërë dhe përcaktojnë mënyrën se si janë ndërtuar.

- Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 2. Dallojnë kallëzuesit e përbërë foljorë i nënvizojnë dhe thonë me se janë shprehur.
- Në grupe, punohen ushtrimet 3 dhe 4. Një grup punon ushtrimin 3 dhe përcakton kur foljet me të zeza janë përdorur me kuptim të plotë dhe si gjysmëndihmëse. Grupi tjetër ndërton fjali ku foljet e dhëna të përdoren me kuptim të plotë dhe si gjysmëndihmëse.
- Mësuesi/ja diskuton zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë kallëzuesin foljor të përbërë në fjali; përcaktojnë me se është shprehur; përdorin saktë kallëzuesin foljor të përbërë në gjuhën e folur dhe të shprehur.

Detyrë shtëpie

Ushtrimi 5, sipas kërkesës.

Prezantim në *Power Point* i njohurive për kryefjalën.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Dëgjimi i deklaratave		Situata e të nxënit: Të dëgjuarit me vëmendje	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcakton pas dëgjimit temën e deklaratave. - Klasifikon llojin e tekstit të deklaratave. - Zbërthen deklaratat nga ana e përmbajtjes. - Analizon strukturën dhe gjuhën e përdorur në deklarata. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>deklaratë, Pavarësi, shtet, delegatë, mëvetësi, autonomi.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor "Gjuha Shqipe 7", CD, fotografi, Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë, filmi "Nëntori i dytë".</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Analizë; Punë e pavarur; Diagrami i Venit.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Hapi I: Vendoset CD-ja për të dëgjuar deklaratat. Deklarata e Pavarësisë së Kosovës dhe Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë, të vitit 1912 (pjesë të shkëputura nga filmi "Nëntori i dytë"). Mësuesi/ja shkruan në tabelë këto pyetje:</p>			


- "Ku?", "Kur?", "Kush?", "Pse?", "Si?" - Pas dëgjimit të Deklaratës, nxënësit u japin përgjigje pyetjeve dhe i analizojnë ato duke u përqendruar në atë informacion që kanë marrë gjatë dëgjimit.

- U kërkohet nxënësve që të përgjigjen rreth pyetjeve që janë shkruar në tabelë. Nxënësit, përveçse ju përgjigjen pyetjeve, duhet të bëjnë komente dhe të mbajnë një qëndrim të caktuar.

Hapi II: Mësuesi/ja i fton nxënësit të punojnë me ushtrimet në tekstin mësimor. Secili nxënës përgjigjet për pyetjet rreth Deklaratave.

Hapi III: Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të dëgjojnë edhe njëherë deklaratat. I orienton ata të gjejnë cilat janë informacionet që përmbajnë deklaratat. Të flasin rreth rëndësisë së tyre.

Hapi IV: Mësuesi/ja ndërton në tabelë Diagramin e Venit



dhe i fton nxënësit që të gjejnë të veçantat dhe të përbashkëtat midis dy deklaratave kur një shtet është i pavarur. Nxënësit, duke u nisur nga dëgjimi i deklaratave, listojnë disa karakteristika të shtetit të pavarur. Dëgjohej me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Mësuesi/ja bën korrigjimet dhe plotësimet e nevojshme, kur e sheh të nevojshme. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të flasin rreth ndërtimit të tyre edhe nga ana gjuhësore.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësim i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Shkruani një deklaratë, respektoni strukturën e saj.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Fjalimi i Skënderbeut Marin Barleti		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Liston karakteristikat e tekstit tregimtar. - Parashikon zhvillimin e përmbajtjes të fjalimi i Skënderbeut. - Diskuton mbi marrdhëniet e udhëheqesit me popullin e tij. - Dallon figurat letrare (epitet, krahasim) dhe bën zbërthimin e tyre. - Analizon gjuhën e përdorur në fjalimin e Skënderbeut. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>fjalim, përmbajtje, patriot udhëheqje, lider, krenar.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor “Gjuha Shqipe 7”, fletore, CD, videoprojektor, filmi “Skënderbeu”.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Biseda; Parashikim; Lexim zinxhir; Rrjeti i diskutimit.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Hapi I: Mësimi nis me vendosjen e filmit të Skënderbeut. Nxënësit lihen për disa çaste të dëgjojnë fjalimin dhe më pas bashkëbisedojnë rreth çështjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tregojnë momentin historik në të cilin ndodhet populli shqiptar. E përshkruajnë këtë moment. Nxënësit flasin dhe tregojnë mbi të dhënat historike që kanë lexuar në periudhën e Skënderbeut. - Flasin mbi arsyet e rikthimit të Skënderbeut në Shqipëri. - Si reagojnë princërit kur Skënderbeu mbaron fjalën e tij? <p>Nxënësit nxiten të flasin lirisht përreth temës, por pa u zgjatur shumë në kohë. E gjithë veprimtaria të mos zgjasë më shumë se 10 minuta.</p>			

Hapi II: Shkruhet titulli i pjesës në tabelë. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të mendohen për 2-3 minuta rreth përmbajtjes së pjesës.

Dëgjohen mendimet e disa nxënësve që japin alternativat e tyre. Në ndihmë ju vjen puna parapërgatitore për këtë temë, duke marrë dhe lexuar materiale historike.

Hapi III: Hapet libri dhe bëhet leximi zinxhir i pjesës.

Pas leximit shpjegohen fjalët e panjohura të përdorura në këtë tregim. Mësuesi/ja i shkruan ato në tabelë dhe bën zbërthimin kuptimor të tyre.

Hapi IV: Diskutohet dhe punohet mbi ushtrimet që flasin mbi përmbajtjen e tekstit. Për të përcaktuar mjedisin ku zhvillohet ngjarja, mësuesi/ja u thotë nxënësve ta lexojnë në tekst. Nxënësit përqendrohen mbi informacionin që kanë mbi zhvillimin e ngjarjes historike dhe e shfrytëzojnë atë në kontekstin e fjalimit.

Ushtrim. Nxënësit listojnë karakteristikat e një udhëheqësi. P.sh: krenar, i guximshëm, orator etj.

Ushtrim. Nxënësit veçojnë momentin ku Skënderbeu u bën thirrje princave për të qenë te pathyeshëm përballë armikut. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të përqendrohen tek paragrafi: "Ngrihuni pra, o etër..." dhe të zërthejnë mesazhin që përcjellin fjalët e Skënderbeut.

Ushtrim. Pyetja se ku mbështetet më tepër fjalimi i Skënderbeut, në argumentet jetësore apo në emocionet e dëgjuesve, realizohet duke përdorur Rrjetin e Diskutimit. Nxënësit punojnë me tekstin për të ilustruar mendimet që japin gjatë diskutimit të pyetjeve.

Hapi V: Kalohet tek rubrika: Gjuha dhe stili.

Ushtrim. Gjatë fjalimit të Skënderbeut kemi përdorimin e përemrave vetorë: unë, ne, ju. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit t'i gjejnë në tekst dhe të shpjegojnë funksionin e përdorimit të tyre. Secili nga këta përemra ka një funksion të caktuar gjatë përdorimit të tyre.

Ushtrim. Nxënësit rikthehen në tekst dhe punojnë në çifte ose individualisht për të gjetur fjalët kyç dhe figurat letrare që pasqyrojnë imazhet që përcjell figura e Skënderbeut tek ata.

Ushtrim. Nxënësit punojnë me tekstin dhe nënvizojnë figurat letrare (pyetjet retorike), shpjegojnë dhe përdorimin e tyre në tabelë. Mësuesi/ja bën vlerësimin e orës së mësimin.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Shkruani një fjalim dhe zbatoni elementet e strukturës së tij.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Rregullat e debatit		Situata e të nxënit: Të flasim së bashku	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje. Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Liston rregullat që duhet të zbatohen në një debat. - Hulumton mbi problematikat e debateve. - Flet mbi rregullat që duhet të zbatohen në një debat. - Bashkëbisedon në situata të ndryshme. - Analizon rregullat e debatit në këndvështrim krahasues. 		Fjalët kyç: debat, rregulla, strukturë, përmbajtje, analizë.	
Burimet: teksti mësimor “Gjuha Shqipe 7”, emisione debati, rregullore, videoprojektor, CD.		Lidhja me fushat kurikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Hulumtim; Punë në grup; Bashkëbisedim.			

Organizimi i orës së mësimit

Punë parapërgatitore

Disa orë më parë nxënësit janë porositur të hulumtojnë për të grumbulluar debate me tema të ndryshme. Secili tregon dhe diskuton për debatet që ka hulumtuar. Nxënësit flasin mbi temat që trajtohen në debate, mbi mënyrën e rregullave të zhvillimit të debatit, mbi komunikimin e pjesëmarrësve.

Hapi I: Kjo temë mund të zhvillohet edhe në studiot televizive, ku nxënësit mund të jenë pjesëmarrës të një debati të organizuar nga ata vetë. Ata mund të përzgjedhin shokët/shgoqet që do të flasin në debat dhe pjesa tjetër do të jenë dëgjues. Ata përzgjedhin moderatorin dhe temën që do të trajtohet dhe vendosin bashkërisht disa rregulla që duhet t'i zbatojnë të dyja palët që marrin pjesë në debat.

Hapi II: Në pamundësi të realizimit të mësimit në një televizion apo në një studio televizive, ai zhvillohet në klasë. Nxënësit shfrytëzojnë ambientin e klasës për ta kthyer atë në një studio televizive. Mësuesi/ja së bashku me nxënësit përcakton temën e debatit. Çdo nxënës është njohur më parë me mënyrën se si zhvillohet një debat. Tema mund të përzgjidhet duke vendosur bashkërisht rreth saj.

Hapi III: Klasa ndahet në grupe dhe çdo përfaqësues i grupeve flet mbi rregullat e debatit, të cilat mësuesi/ja i shkruan në tabelë. Nxënësit zhvillojnë një debat duke u ndarë në pro dhe kundër temës së përcaktuar. Ata diskutojnë, por secili duhet të respektojë rregullat e debatit.

Hapi IV: Mësuesi/ja, në fund të orës, falënderon të ftuarit për informacionet që nxënësit morën mbi temën që u diskutua. Moderatorin, me ndihmën e mësuesit/es bën përmbledhjen e temës, konkluzionet mbi debatin e realizuar në klasë.

Mësuesi/ja bën vlerësimin e orës së mësimit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Kundrinori i drejtë e i zhdrejtë		Situata e të nxënit: Nxënësit plotësojnë në dyshe pemën e mendimit për kundrinorët, llojet, mënyra e shprehjes, pyetjet, pozicioni.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon kundrinorin e drejtë e të zhdrejtë në fjali; - përcakton me se është shprehur ai; - formon fjali duke përdorur kundrinorë të ndryshëm. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>plotës kryesor, kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë pa/me parafjalë.</p>	
<p>Burimet: teksti "Gjuha shqipe7"</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>TIK</p>	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pema e mendimit; Shpjegim i përparuar.

Përshkrimi kontekstual i situatës

Nxënësit plotësojnë në dyshe pemën e mendimit për kundrinorët, llojet, mënyra e shprehjes, pyetjet, pozicioni në fjali:

- Janë gjymtyrë plotësuese (të dyta).
- Plotësojnë foljen kallëzues.
- Janë dy llojesh: kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë me dhe pa parafjalë.
- Kundrinori i drejtë u përgjigjet pyetjeve: “Kë?”, “Cilin?”, “Cilën?”, “Cilët?”, “Cilat?”, “Çfarë?”.
- Shprehet me emër, përemër, grup emëror gjithmonë në rasën kallëzore.
- Shoqërohet ose jo me trajta të shkurtra.
- Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë u përgjigjet pyetjeve: “Kujt?”, “Cilit?”, “Cilës?”, “Cilëve?”, “Cilave?”.
- Shprehet me emër, grup emëror, përemër gjithmonë në rasën dhanore.
- Shoqërohet gjithmonë me trajtë të shkurtër.
- Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë u përgjigjet pyetjeve me përemra pyetës të shoqëruar me parafjalë.
- Shprehet me emër me parafjalë, grup emëror me parafjalë, përemër me parafjalë.

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në tabelë.
- U kërkon nxënësve të rikujtojnë njohuritë që kanë marrë për kundrinorët në klasat paraardhëse dhe të plotësojnë pemën e mendimit; një nxënës e plotëson pemën e mendimit në tabelë.
- Një nxënës/se lexon tekstin e dhënë në fillim të mësimit, mësuesi/ja përmbledh njohuritë e mësimit, duke përfshirë dhe nxënësit që japin shembuj për secilin rast.
- Më pas nxënësit së bashku me mësuesin/en punojnë ushtrimin 1. Nxënësit udhëzohen të nënvizojnë kundrinorët dhe të përcaktojnë llojin e tyre. Mësuesi/ja i pyet se me cilën pyetje i gjetën dhe me se shprehen.

Veprimtari praktike:

- Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimet 2–5, sipas kërkesave.

- Mësuesi/ja diskuton zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme; përcjellin informacionin; dallojnë kundrinorët dhe përcaktojnë llojet e tyre; përcaktojnë me se janë shprehur; përdorin saktë kundrinorët në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 6, sipas kërkesës.

Prezantim në PowerPoint i njohurive për kundrinorët.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për kundrinorët		Situata e të nxënimit: 2-3 nxënës lexojnë fjalitë e detyrës së shtëpisë.	
<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <p>1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi;</p> <p>2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar; rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim;</p> <p>3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon kundrinorin e drejtë e të zhdrejtë në fjali; - përcakton me se është shprehur ai; - formon fjali duke përdorur kundrinorë të ndryshëm. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>plotës kryesor, kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë pa/me parafjalë.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe7”</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Praktikë e drejtuar; Praktikë e pavarur (punë në dyshe); Tabela e koncepteve; Diskutim; Diagrami i Venit.</p>			

Përshkrimi kontekstual i situatës

2-3 nxënës lexojnë fjalitë e detyrës së shtëpisë, ku kanë përdorur emrat dhe grupet emërore të dhëna si kundrinorë të llojeve të ndryshme.

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në tabelë.

2-3 nxënës lexojnë fjalitë e detyrës së shtëpisë, ku kanë përdorur emrat dhe grupet emërore të dhëna si kundrinorë të llojeve të ndryshme. Ata përcaktojnë llojin e kundrinorit, pyetja dhe me se shprehet.

Veprimtari praktike:

- Nxënësit punojnë ushtrimin 1. Udhëzohen nxënësit të nënvizojnë kundrinorët dhe të përcaktojnë llojin e tyre. I pyet mësuesi/ja se me cilën pyetje i gjetën dhe me se shprehen.


- Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimet 2-9 sipas kërkesave.

- Ushtrimet 4, 5, 7 punohen në tabelën e koncepteve, pasi nxënësit i kanë nënvizuar kundrinorët në libër.

Kundrinori	Lloji	Pyetja	Me se shprehet
atdhenë	i drejtë	Cilin?	emër
nga tërë pronat	i zhdrejtë me parafjalë	Nga cilat?	grup emëror me parafjalë

- Mësuesi/ja diskuton zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit.

- Nëpërmjet Diagramit të Venit, nxënësit krahasojnë tre llojet e kundrinorëve.



Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë kundrinorët dhe përcaktojnë llojet e tyre; përcaktojnë me se janë shprehur; përdorin saktë kundrinorët në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyra shtëpie: ushtrimi 10, sipas kërkesës.

PROJEKT

Titulli: Shqipëria, destinacioni i vitit (Guida turistike)

Synimi: Nxënësit të njihen me historinë, gjeografinë dhe vlerat turistike të Shqipërisë duke shfrytëzuar informacione nga burime të ndryshme (teksti shkollor dhe interneti).

Qëllimi:

Nxënësit të hartojnë një guidë turistike, të punojnë një fletëpalosje dhe përgatisin një video të shkurtër me vende të ndryshme turistike (një album me foto nga vende turistike), ku të shpalosin njohuritë e tyre në letërsi, histori, gjeografi, kulturë, si dhe aftësitë e tyre krijuese dhe organizative.

Përfituesit: Nxënësit e klasave të 7-ta

Vendi i aplikimit: Shkolla “ _____ ”

Koha e përgatitjes: Tremujori dytë

Hapësira e aplikimit: 3 orë mësimore të shtrira në një javë

Kompetencat

Nxënësi/ja:

- dallon llojin e tekstit rrëfimtar joletrar te guida turistike;
- hulumton informacione në fusha të ndryshme;
- harton tekste të llojit rrëfimtar joletrar;
- prezanton punën para një auditori.

Përshkrimi i punës: Përgatitja e guidës turistike është një punë që do të bëhet në një javë, por që do të ballafaqohet në tri orë mësimore. Në këtë projekt, nxënësit do të ndërthurin hartimin e një teksti rrëfimtar (joletrar), shprehitë praktike me ato teorike në fushën e gjuhës, historisë, gjeografisë, artit. Ky projekt do t'i ndihmojë nxënësit të angazhohen të gjithë sipas mundësive dhe prirjeve për t'u koordinuar në një punë të përbashkët dhe efektive.

Teknikat mësimore: Hulumtimi, kërkimi në internet dhe literatura të tjera; Krijimi i pavarur; Redaktimi; Prezantimi i projektit.

Partnerët e projektit: Nxënësit, mësuesi/ja e lëndës, drejtorja e shkollës, bordi i prindërve.

Plani i veprimtarive:

Ora e parë

Tema: Prezantimi me projektin “Shqipëria, destinacioni i vitit” (guida turistike)

Qëllimi: Nxënësit të njihen me temën e projektit, objektivat dhe të ndajnë detyrat.

Kompetencat:

Nxënësi/ja:

- tregon ç’është guida turistike dhe fletëpalosja;
- shpjegon përmbajtjen e një guide turistike;
- bashkëpunon në grup;
- zbaton strategjitë e procesit të grumbullimit dhe të shkrimit të materialit.

Metodat: Stuhi mendimesh; Diskutim; Rrjeti i diskutimi.

Organizimi i klasës: Grupe pune prej 4–5 vetash

Mjetet: Dërrasa, shkurtesa, materiale, fotografi, informacione, guida, harta, CD.

Zhvillimi i mësimit:

- Njohja me projektin dhe me produktin e pritshëm. Mënyra e zhvillimit dhe e prezantimit.
- Bisedë e drejtuar mbi guidat turistike dhe fletëpalosjet.
- Ndarja e detyrave sipas grupeve të punës.
- Përpunimi paraprak i materialeve.
- Caktimi i detyrave për orën pasardhëse.

Ora e dytë

Tema: Përpunimi i materialeve

Kompetencat

Nxënësi/ja:

- punon në grup materialet e grumbulluara;
- seleksionon materialet;
- redakton materialet.

Teknikat: Diskutime; Mendo/puno në dyshe/trejtë të tjerëve.

Zhvillimi i orës së mësimit:

Hapi I

Nxënësit punojnë në hartimin e planfaqosjes para hedhjes dhe përpunimit në kompjuter.

Hapi II

Nxënësit grupohen nëpër banka sipas detyrave të caktuara më parë. Punohet në fletë formati A4. Nxënësit japin mendimet dhe në dërrasë hartohet një planfaqosje.

Hapi III

Jepen udhëzime dhe këshilla për fazën tjetër duke falënderuar nxënësit për punën e tyre.

Ora e tretë

Tema: Prezantimi i projektit “Shqipëria, destinacioni i vitit” (guida turistike)

Kompetenca

Nxënësi/ja:

- flet për turizmin si një ndër faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit;
- diskuton për rolin e Ministrisë së Turizmit, si dhe guidat turistike si pjesë e shpalosjes së vlerave të një vendi;
- prezanton punimin.

Teknikat: Bisedë e drejtuar; Prezantim; Turi i galerisë.

Zhvillimi i mësimi:

Hapi I

Diskutohet rreth temave:

- Shqipëria – pozita gjeografike, klima, resurset, turizmi.
- Ministria e Turizmit.
- Agjensitë turistike.
- Guida turistike: historiku, rëndësia.

Hapi III

Prezantimi i punimeve.

Afishimi për t’u vlerësuar nga të gjithë. Vlerësimi i nxënësve për punën.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Rrethatorët; rrethatori i vendit dhe i kohës		Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit dallojnë rrethatorët në tekstin e dhënë	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon rrethatorët e vendit dhe të kohës; - përcakton me se shprehen; - formon fjali duke përdorur rrethatorë të vendit dhe të kohës. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>plotës i foljes, rrethana e vendit, rrethana e kohës</p>	
Burimet: teksti "Gjuha shqipe7"		Lidhja me fushat kurikulare: TIK	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Rishikim në dyshe; Pema e mendimit; Shpjegim i përparuar; Praktikë e drejtuar; Punë e pavarur;			

Diagrami i Venit.

Përshkrimi kontekstual i situatës

Në dyshe, nxënësit dallojnë rrethanorët në tekstin e dhënë dhe përcaktojnë llojin e tyre (Mësuesi/ja e përgatit tekstin në PowerPoint, në pamundësi shkruhet në një tabak të bardhë, ose i kërkon një nxënësi ta shkruajë në dërrasë para se të fillojë mësimi.).

Ai kapërxeu gardhin, shkuli pishtarin dhe mbajti vesh për t'u orientuar. Ulërimat e lukunisë së ujqve i mbytën për një çast të lehurat e qenve. Po djaloshi e njohu zërin e Balos dhe u derdh pranë tij. Atë çast vetëtinë ca shkëndija dhe u dëgjuan të shtëna. Bishat u llahtarisën dhe ikën nga mundën.

Plaku dhe dy djemtë u munduan të shquanin në errësirë ato hije që vinin njëra pas tjetrës, por nuk i shquan dot.

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në tabelë.

- Në dyshe, nxënësit dallojnë rrethanorët në tekstin e dhënë dhe përcaktojnë llojin e tyre.

- U kërkon nxënësve të rikujtojnë njohuritë që kanë marrë për rrethanorët në klasat paraardhëse dhe të formulojnë pyetje rreth tyre.

- Ç'gjymtyrë janë rrethanorët?
- Sa llojesh janë rrethanorët?
- Me ç'pyetje gjenden ato në fjali?
- Me se shprehen rrethanorët?

- Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve, mësuesi/ja ndërhyr dhe plotëson përgjigjet e tyre aty ku e sheh të nevojshme.

- Një nxënës/se lexon tekstin e dhënë në fillim të mësimit, mësuesi/ja shpjegon çfarë tregojnë rrethanorët e vendit dhe të kohës dhe me se shprehen. Nxënësit ndërtojnë fjali për secilin rast.

Veprimtari praktike:

- Me nxënësit punon ushtrimin 1. Udhëzon nxënësit të nënvizojnë rrethanorët dhe të përcaktojnë llojin e tyre. I pyet se me cilën pyetje i gjetën dhe me se shprehen.

- Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 2-4 sipas kërkesave.

- Mësuesi/ja diskuton zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë rrethanorin e

vendit dhe të kohës dhe përcaktojnë llojet e tyre; përcaktojnë me se janë shprehur, përdorin saktë rrethorët në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyra dhe puna e pavarur:

Ushtrimi 5, sipas kërkesës.

Prezantim në një fletë formati A4 i njohurive për rrethorët e vendit dhe të kohës të përmbledhura në Diagramin e Venit.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë		Situata e të nxënit: Në dyshe nxënësit ndërtojnë fjali me fjalët dhe grupet e dhëna	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon rrethatorët e mënyrës dhe të sasisë; - përcakton me se shprehen; - formon fjali duke përdorur rrethatorë të mënyrës dhe të sasisë. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>plotës i foljes, rrethana e mënyrës, rrethana e sasisë, Si? Sa?</p>	
<p>Burimet: Teksti "Gjuha shqipe7"</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>TIK</p>	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë, Tabela e koncepteve, Praktikë e drejtuar, Punë e pavarur, Diagrami i Venit.

Përshkrimi kontekstual i situatës

Në dyshe, nxënësit ndërtojnë fjali me: me vrull, si shigjetë, më mirë, miqësisht, dukë mermëritur, pa u menduar, gjatë, dy orë, për javë të tëra, njëqind metra (këto fjalë mësuesi/ja i shkruan në dërrasë).

Lexohen fjalitë e krijuara nga disa nxënës dhe u kërkohet të përcaktojnë funksionin e fjalëve dhe grupeve të kjalëve, pyetja dhe me se shprehen.

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në tabelë.
- Në dyshe, nxënësit ndërtojnë fjali me: me vrull, si shigjetë, më mirë, miqësisht, dukë mermëritur, pa u menduar, gjatë, dy orë, për javë të tëra, njëqind metra.
- Lexohen fjalitë e krijuara nga disa nxënës dhe u kërkohet të përcaktojnë funksionin e fjalëve dhe grupeve të fjalëve, pyetja dhe me se shprehen.
- Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin dhe plotësojnë tabelën e koncepteve.

Rrethanori	Çfarë tregon	Me se shprehet	Pyetja
Rrethanori i mënyrës	Tregon mënyrën se si kryhet veprimi i shprehur nga folja.	Me grup emëror me parafjalë ose me pjesëzën si; me ndajfolje, me formë foljore të pashtjelluar përcjellore; me formë të pashtjelluar mohore. (Mësuesi/ja mund të japë dhe rrethanorin e shprehur me pjesë të nënrenditur)	Si?
Rrethanori i sasisë	Shpreh një sasi të përcaktuar në masë dhe në kohë.	Me ndajfolje; me një grup emëror të formuar nga emra që tregojnë masë, kohë etj.,	Sa?

	Varet jo vetëm nga gjymtyrë të shprehura me folje, por dhe nga gjymtyrë të shprehur me mbiemra.	si metër, letër, kg, orë, herë, lekë etj.		
--	---	---	--	--

Veprimtari praktike:

- Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 1-6 sipas kërkesave.
- Mësuesi/ja diskuton zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit.
- Në grupe nxënësit krahasojnë kundrinorët dhe rrethanorët. Shkruajnë të përbashkëtat dhe dallimet duke përdorur Diagramin e Venit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur; diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë rrethanorin e mënyrës dhe të sasisë dhe përcaktojnë llojet e tyre; përcaktojnë me se janë shprehur; përdorin saktë rrethanorët në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie

Ushtrimi 7, sipas kërkesës.

Prezantim në *Power Point* i njohurive për kundrinorët dhe rrethanorët. Në mungesë të kompjuterit nxënësit mund ta prezantojnë punën në një format A4.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa:VII
Tema mësimore: Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit		Situata e të nxënit: Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit për rrethanorët e shkakut dhe të qëllimit.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon rrethanorët e shkakut dhe të qëllimit; - përcakton me se shprehen; - formon fjali duke përdorur rrethanorë të shkakut dhe të qëllimit . 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>Plotës i foljes, rrethana e shkakut, rrethana e qëllimit, Pse? Për ç'shkak? Përse?</p>
<p>Burimet: teksti "Gjuha shqipe7"</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>TIK</p>

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: pema e mendimit; Rishikim në dyshe; Pema e mendimit; Shpjegim i përparuar, Praktikë e drejtuar; Punë e pavarur.

Përshkrimi kontekstual i situatës

Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit për rrethatorët e shkakut dhe të qëllimit.

Në dyshe, dallojnë rrethatorët e shkakut dhe të qëllimit në tekstin e dhënë dhe thonë me se është shprehur.

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në tabelë.
- Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit për rrethatorët e shkakut dhe të qëllimit.
- Në dyshe dallojnë rrethatorët e shkakut dhe të qëllimit në tekstin e dhënë dhe thonë me se është shprehur.
- Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin dhe plotësojnë Diagramin e Venit.



Mësuesi/ja e plotëson Diagramin e Venit në tabelë.

Veprimtari praktike:

- Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 1-6 sipas kërkesave.
- Mësuesi/ja diskuton zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë rrethatorin e

shkakut dhe të qëllimit dhe përcaktojnë llojet e tyre; përcaktojnë me se janë shprehur: përdorin saktë rrethorët në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie

Ushtrimi 3, sipas kërkesës.

Prezantim në *Power Point* i njohurive për rrethorët e shkakut dhe të qëllimit.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Tregtar Flamujsh Ernest Koliqi Ora e parë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Lexon dhe ritregon përmbajtjen e tregimit.</p> <p>Dallon kuptimin e parë e të figurshëm të fjalëve.</p> <p>Shpjegon karakterin e secilit personazh.</p> <p>Gjen në tregim fjalët kyç dhe i grupon ato sipas klasave të fjalëve.</p> <p>Nënvizon në fragment figurat letrare dhe zbërthen kuptimin e tyre.</p> <p>Zbërthen kuptimin e fjalëve në dialekt dhe i kthen ato në standardin e gjuhës shqipe.</p> <p>Analizon titullin në këndvështrimin ideor të përmbajtjes së tregimit.</p>			<p>Fjalët kyç:</p> <p>patriotizëm, flamuj, pseudopatriot, atdhe, tregtar, poet, dashuri.</p>
Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletore pune, “Novelat” – Ernest Koliqi			Lidhja me fushat kurikulare:
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Lexim dhe pyetje; Diskutim; Rrjeti semantik; Krahasimi; Punë në çift.</p>			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Mësuesi/ja shkruan në tabelë skemën e mëposhtme, për të sistemuar njohuritë e marra nga informacionet në internet mbi autorin Ernest Koliqi.

Nxënësit janë orientuar një orë më parë nga mësuesi/ja për të marrë informacione mbi autorin, jetën dhe krijimtarinë e tij.

Titulli i tregimit: Tregtar flamujsh

Autori: Ernest Koliqi

Jeta: lindi më 20 maj 1903

Vendlindja: Shkodër

Vdiq: 15 janar 1975

Hapi II. Lexohet teksti nga mësuesi/ja dhe shpjegohen fjalët në trajtën dialektore, duke i kthyer ato në standardin e gjuhës shqipe. I analizon fjalët në aspektin fonetik dhe leksikor, i kthen ato në standartin e gjuhës shqipe.

Hapi III. Për pyetjet mbi përmbajtjen, nxënësit punojnë në çift. Secili çift lexon paragrafe të tekstit.

Nxënësi i parë e lexon paragrafin me zë, ndërsa nxënësi i dytë bën pyetje rreth tij. *Sugjerim:* Orientohen nxënësit rreth çështjeve për të cilat do të pyesin: - tema që trajtohet: marrëdhënia midis poetit dhe tregtarit; krenaria kombëtare, parashikim se çfarë do të ndodhë në vazhdim (vlerësohet vëmendja gjatë leximit nga mësuesi/ja. Nxënësi i dytë përgjigjet. Të dy nxënësit duhet të përpiqen që, për çdo pyetje të japin përgjigjen më të përshtatshme. Bashkërisht të formulojnë për çdo paragraf idenë që përcjell autori. Kështu veprohet për çdo paragraf deri në fund të tregimit. Bëhet vlerësimi i orës së mësimit. Mësuesi/ja përgëzon nxënësit që ishin aktivë gjatë orës së mësimit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3 ora e dytë e mësimit	Klasa: VII
Tema mësimore: Tregtar Flamujsh Ernest Koliqi Ora e dytë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Lexon dhe ritregon përmbajtjen e tregimit.</p> <p>Dallon kuptimin e parë e të figurshëm të vargjeve të veçuara.</p> <p>Shpjegon karakterin e secilit personazh.</p> <p>Gjen në tregim fjalët kyç dhe i grupon ato sipas klasave të fjalëve.</p> <p>Nënvizon në fragment figurat letrare dhe zbërthen kuptimin e tyre.</p> <p>Zbërthen kuptimin e fjalëve në dialekt dhe i kthen ato në standardin e gjuhës shqipe.</p> <p>Analizon titullin në këndvështrimin ideor të përmbajtjes së tregimit.</p>			<p>Fjalët kyç:</p> <p>patriotizëm,</p> <p>flamuj,</p> <p>pseudopatriot,</p> <p>atdhe,</p> <p>tregtar,</p> <p>poet,</p> <p>dashuri.</p>
Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletore pune, “Novelat” – Ernest Koliqi			Lidhja me fushat kurikulare:
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Lexim dhe pyetje; Diskutim; Rrjeti semantik; Krahasimi; Punë në çift.</p>			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Diskutohet rreth tyre dhe secili nxënës argumenton qëndrimin e tij. Mësuesi/ja i fton nxënësit të punojnë ushtrimet që flasin për interpretimin e tekstit.

Ushtrim. Ç'përfaqësojnë në vetvete Gaspër Tragaçi dhe Hilush Vilza nga natyra, profesioni dhe botëkuptimi i tyre dhe të mbajnë qëndrim për secilin personazh.

Si e gjykojnë njëri-tjetrin ata. Mësuesi/ja i fton nxënësit të analizojnë secilin personazh.

Hapi II. Kalohet në rubrikën mbi “gjuhën dhe stilin”.

Ushtrim. Nxënësit punojnë në tekst dhe nënvizojnë fjalitë që nxjerrin në pah qëndrimin e dy personazheve në lidhje me temën e Atdheut. Analizojnë dhe komentojnë qëndrimet e personazheve . Shprehin qëndrimin e tyre duke e argumentuar atë.

Ushtrim. Për të punuar mbi dialogun midis dy personazheve përdoret metoda e Rrjetit semantik. Dialogu shikohet në këndvështrim krahasues. Vihen në pah karakteristikat e dialogut.

Ushtrim.

Mësuesi/ja i fton nxënësit të japin mendimet e tyre, duke argumentuar pozicionimin që ata kanë në çdo rast.

Hapi III. *Ushtrim.* Nxënësit punojnë në çift për gjuhën dialektore të përdorur në tekst.

Lexohen fjalët e përdorur në gjuhën dialektore dhe një nxënës i shkruan ato në tabelë duke i listuar njëra pas tjetrës. Nxënësi tjetër i kthen fjalët në standardin e gjuhës shqipe.

Në fund të orës, mësuesi/ja bën vlerësimin motivues për nxënësit, duke parë pjesëmarrjen e tyre, ndihmesën e secilit në çdo përgjigje të pyetjeve.

Hapi IV. Ushtrim. Nxënësit dallojnë në tekst figurat letrare, pëcaktojnë llojet e figurave dhe bëjnë zërbërthimin e funksionit të tyre.

Hapi V. Nxënësit orientohen për të gjetur në tekst detajet dhe fjalë kyç të përdorura në portretizimin e personazheve, në përshkrimin e situatave dhe në gjuhën e përdorur në dialogje. Pas përcaktimit të tyre nxënësit bëjnë grupimin në klasa të fjalëve.

Në fund të orës, mësuesi/ja bën vlerësimin motivues për nxënësit duke parë pjesëmarrjen e tyre, ndihmesën e secilit në çdo përgjigje të pyetjeve.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____


Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime për rretahnorët		Situata e të nxënit: Në grupe, nxënësit ndërtojnë pyetje për rrethanorët, si dhe shembul me rrethanorë të ndryshëm të cilat ua drejtojnë njëri-tjetrit (konkurs)	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon rrethanorët dhe përcaktojnë llojin; - shpjegojnë me se shprehen; - formon fjali duke përdorur rrethanorë të llojeve të ndryshme. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>Plotës i foljes, rrethana e kryerjes së veprimit, shprehet.</p>	

Burimet: Teksti "Gjuha shqipe7"	Lidhja me fushat kurikulare: TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Konkurs (punë në grup), Praktikë e drejtuar; Punë e pavarur (punë në dyshe).	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës Në grupe, nxënësit ndërtojnë pyetje për rrethanorët, si dhe shembull me rrethanorë të ndryshëm, të cilat ua drejtojnë njëri-tjetrit (konkurs)</p> <p>Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në tabelë. - Në grupe, nxënësit ndërtojnë pyetje për rrethanorët, si dhe shembull me rrethanorë të ndryshëm, të cilat ua drejtojnë njëri-tjetrit (konkurs). - Në përfundim të konkursit, mësuesi/ja përgëzon nxënësit për shkallën e përvetësimit të njohurive për rrethanorët, si dhe bën saktësime për raste ku mund të jetë gabuar. <p>Veprimtari praktike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja punon me nxënësit ushtrimin 1. U kërkon nxënësve të nënvizojnë rrethanorët, të përcaktojnë llojin, me se shprehen dhe cilën gjymtyrë plotësojnë. - Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 2-7 sipas kërkesave. - Në përfundim, të mësuesi/ja diskuton zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit. Mësuesi/ja kujdeset që të aktivizojë sa më shumë nxënës si dhe kërkon që ata të flasin me fjali të plota dhe të përdorin terminologjinë e duhur. 	
<p>Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.</p> <p>Vlerësimi i situatës Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë rrethanorët dhe përcaktojnë llojet e tyre; përcaktojnë me se janë shprehur; përdorin saktë rrethanorët në gjuhën e folur dhe të shkruar.</p> <p>Detyrë shtëpie: Ushtrimi 8, sipas kërkesës.</p>	

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “Fermer i ndershëm ish im atë” Robert Bërns (ora e parë)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje. Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> ❖ liston virtytet që djali vlerëson te babai; ❖ lexon me ndjenjë poezinë; ❖ interpreton dhe diskuton rreth poezive të autorëve të ndryshëm që kanë shkruar vargje me këtë tematikë. 		Fjalët kyç: im atë, virtyt, breza, mund, djersë, pasuri.	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, “Poezi”, R. Bërns		Lidhja me fushat kurikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë; Kllaster; Diskutim; Shkrim i lirë.			
Përshkrimi kontekstual i situatës Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme			



Ndërtimi i njohurive të reja

Parashikim me terma paraprakë:

Mësuesi/ja shkruan fjalët kyç në tabelë dhe u kërkon nxënësve që të shkruajnë një poezi të shkurtër me këto fjalë. Lexohen vargjet nga disa nxënës.

Veprimet në situatë:

- Prezantimi i poezisë.
- Diskutim rreth pyetjes: A përcjellin vargjet tuaja të njëjtën ide si ato të poetit? Jepni mendimin tuaj.
- Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e R. Bërns.
- Interpretim i disa poezive të shkrimtarit.

Reflektim mbi rezultatet e arritura

- Punimi i rubrikës “Të zbëthejmë tekstin”.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: listojnë veçoritë; shprehin idetë dhe mendimet e tyre gjatë analizës së poezisë dhe interpretojnë bukur vargje të autorëve të ndryshëm.

Detyrë shtëpie: Sillni në klasë të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e poetit.

Mësoni përmendsh vargjet dhe interpretojini ato me ndjenjë.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “ Fermer i ndershëm ish im atë” R. Bërns Ora e dytë		Situata e të nxënit: Këshillat e babit për djalin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ përkufizon mesazhin e poezisë; ❖ liston cilësitë që djali vlerëson te baba i tij; ❖ analizon elementet e metrikës; ❖ shpreh mendimet dhe opinionet e tij për vlerën e punës nëpërmjet punës së pavarur. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>këshillë, ndershmëri, punëtor, breza, bir.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, “Poezi” R. Bërns</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare: Qytetari</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Ditari dypjesësh.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme</p> <p>Lista e këshillave</p> <p>Mendohuni për pak kohë dhe listoni disa këshilla që prindërit ose të afërmit ju kanë dhënë në momente të ndryshme.</p> <p>Lexojini ato dhe diskutoni:</p> <p>A kanë këto këshilla vlerë gjithëkohore?</p>			

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimet në situatë:

- Diskutim rreth jetës në fshat

Mësuesi/ja u drejton pyetje, si:

A ju pëlqen fshati? Pse?

Çfarë pëlqeni e çfarë jo?

A ka qenë fshati frymëzim për poetët e huaj e shqiptarë? Kujtoni vargje të ndryshme.

- Prezantimi i poezisë

Poezia lexohet në mënyrë shprehëse njëherë nga mësuesi/ja dhe pastaj nga dy - tre nxënës.

- Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e Bërnsit

Robert Burns (U lind më 25 janar 1759, në Alloway, Ayrshire, Skoci - 21 korrik 1796, Dumfries, Skoci), djali i William Burns (bujk), ishte më i madhi nga shtatë fëmijët e familjes. Rininë e tij e kaloi duke punuar në fermën e babait të tij. Pavarësisht nga varfëria, babai i mundësoi arsimim shumë të mirë, sepse me këmbëngulje angazhoi një mësues për të dhe dhe vëllain e tij më të ri, Gilbertin.

Nga moshë 15-vjeçare, i ra barra e punëtorit kryesor në fermë. Për t'i ikur lodhjes, ai rrekej pas shkrimit, i cili e bënte të harronte punën e rëndë dhe të vështirë, duke medituuar për një botë më të mirë. Në këtë moshë dolën në dritë vargjet e tij të para, odë për Skotlandën dhe për gratë me titullin "Nela ime e bukur".

Kur i vdiq babai, në vitin 1784, Roberti dhe vëllai e vazhduan bashkërisht punën në fermë. Roberti u dha pas pasionit të vet të parë dhe publikoi librin me poezi "Poems, Chiefly in the Scottish Dialect", kryesisht në dialektin scocez, ku këndon për dashuri të "thyer". Këto këngë u pranuan shumë mirë nga lexuesit dhe nga kritika. Kjo e shndërroi në të përkëdhelurin dhe në krenarinë e familjes. Filloi të bënte udhëtime nëpër vendlindje. Kështu, mbërrin në Edinburg, ku u bashkua me rrethin e shquar të artistëve dhe shkrimtarëve, të cilët, të prekur nga bukuria e poezisë së tij, e pranuan mirë (megjithëse më vonë disa e quajtën "poeti fshatar") dhe e pëlqyen punën e tij poetike.

Në mes të viteve 1793 e 1818 iu botua koleksioni "A Select Collection Of Scottish Airs for the Voice" në gjashtë volume dhe 114 këngë të tjera popullore. Që nga ajo kohë, filloi të konsiderohet si poeti i parë romantik dhe gjithmonë u shërbeu gjeneratave si inspirim.

Fatkeqësisht, Burns vdiq i ri, në moshën 37- vjeçare, nga një sëmundje zemre, sigurisht, kjo si pasojë e lodhjes së tepërt me punët e fermës. Vdekja e gjeti ditën kur gruaja e tij, Jean, lindi djalin e tyre të fundit, të quajtur Maxwell. Në varrim morën pjesë rreth 10 000 vetë. Në këtë kohë, lavdia e tij nuk kishte arritur jo shumë larg nga niveli që e fitoi më pas.

Pas vdekjes së tij, për çdo vit (për ditëlindje), skotllandezët, ngado ku ndodhen, organizojnë darkë dhe festojnë me krenari për poetin e tyre.

- Mesazhi i poezisë: Punëtor dhe i ndershëm janë dy virtyte që kurrë nuk të lënë të humbasësh në jetë.

- Interpretimi i dy-tri poezive të poetit.

Reflektim mbi rezultatet e arritura

- Leximi i listës së këshillave. Krahasimi mes këshillave që i jepte i ati i Bërnsit atij dhe ato që kanë listuar nxënësit.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: përcaktojnë veçoritë e tekstit poetic; shprehin idetë dhe mendimet e tyre gjatë analizës së poezisë dhe nxjerrjes së mesazhit.

Detyrë shtëpie: Mësoni përmendsh vargjet dhe interpretojini ato me ndjenjë.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë prozë poetike		Situata e të nxënit: Shkrim i lirë	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>❖ përdor fjalor të pasur dhe gjuhë të figurshme me qëllim që të ndikojë te lexuesi;</p> <p>❖ përdor gjuhë të shkruarit gjuhën standarde dhe respekton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore.</p>			<p>Fjalët kyç: prozë poetike, përjetime të autorit, detaje.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, një prozë poetike</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare: Edukim figurativ</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Shkrim i lirë.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja lexon një prozë poetike të ndonjë autori që ka mundësi. Nxënësit rikujtojnë veçoritë e prozës poetike, njohuri të marra në klasën e gjashtë.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <p>- Lexohen udhëzimet orientuese për mënyrën e shkrimit të prozës poetike.</p>			

- Bashkëbisedim rreth pikturës së Vangjush Mios.
- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.
- Leximi i disa punimeve nga nxënësit.
- Vlerësimi i punës së njëri-tjetrit.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përshkruar fshatin në prozën poetike; shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë shkrimit.

Detyrë shtëpie: Identifikoni figurat letrare që keni përdorur në prozën poetike.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Dëgjimi i poezive (Gjuha jonë, gjuha shqype)		Situata e të nxënit: Të dëgjuarit me vëmendje	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dëgjon poezitë dhe tregon përmbajtjen e tyre. - Përcakton tema dhe motivin e poezive. - Nënvizon detajet dhe zbërthen kuptimin e tyre. - Krahason poezitë dhe zbërthen kuptimin e tyre. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>poezi, detaje, motiv, tema, gjendje emocionale, figurë letrare.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor “Gjuhë Shqipe 7”, CD-, video projektor, poezia “Gjuha Shqipe”, Fishta, poezia “Gjuha jonë”, N. Frashëri, fletore, fabula, shkumësa me ngjyra.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Ditari dypjesësh; Diskutim ; Diagrami i Venit .</p>			

Organizimi i orës së mësimimit

Hapi I: Mësimi nis me dëgjimin e poezive “Gjuha jonë”, të shkrimtarit Naim Frashëri dhe “Gjuha shqipe”, Gjergj Fishta. Nxënësit vlerësojnë poezinë duke u nisur pas dëgjimit të parë të poezive. Ata flasin rreth përmbajtjes së tyre, rreth temës dhe motivit. Mësuesi/ja u kërkon të shprehin ndjesitë dhe mendimet e para që u vijnë në mendje pas impaktit të parë të dëgjimit.

Hapi II: Nxënësit i dëgjojnë përsëri poezitë me radhë dhe mësuesi/ja shkruan në tabelë këto elemente, të cilat plotësohen nga nxënësit. Secili nxënës shkruan nga një fjali për komentimin që ka për secilën poezi.


Poezitë	Komenti im
N. Frashëri	
Gj. Fishta	

Hapi III: Nxënësit në fletën e formatit, që e kanë ndarë në dy pjesë, e plotësojnë atë duke u përqendruar në pyetjet që shkruan mësuesi/ja në tabelë: motivi i poezive, tema e poezive, detajet/fjalët kyç, gjuha e përdorur, figurat letrare, elementi lirik.

Gjuha jonë	Gjuha shqipe
1	
2	
3	

Mësuesi/ja dëgjon me vëmendje përgjigjet e nxënësve dhe i orienton ata që t’i dëgjojnë poezitë edhe një herë tjetër.

Hapi IV: Në këtë moment, mësuesi/ja ndërton në tabelë Diagramin e Venit dhe kërkon nga nxënësit që të gjejnë krahasimet midis poezive, të veçantat dhe të përbashkëtat. Poezitë krahasohen rreth lëtyre elementeve: përmbajtja, tema, ideja, gjuha.



Mësuesi/ja në fund të orës vlerëson përgjigjet e nxënësve,

motivon angazhimin e tyre.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ay mal Mit'hat Frashëri		Situata e të nxënimit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënimit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Liston fjalët kyç me të cilat shkrimtari shpreh dashurinë, krenarinë e dhimbjen e tij.</p> <p>Dallon figurat letrare: epitete, krahasime e shprehje të figurshme.</p> <p>Ndërton hartën e Shqipërisë mbështetur në udhëtimin imagjinar të autorit.</p> <p>Zbulon mesazhin që përcjell tregimi.</p> <p>Analizon personazhet dhe gjuhën letrare të përdorur në tekst.</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>historia, pozita gjeografike, dashuria për atdheun, marrëdhënia midis brezave, malet, hapësirë gjeografike.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, tabakë të bardhë, informacionet e hulumtuara nga nxënësit, fletore, lapsa me ngjyra, tabela, shkumësa me ngjyra, harta e Shqipërisë.</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Procedura Kërkim – Hulumtim; Organizues grafik; Punë me grupe.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimimit</p> <p>Hapi I: Ora e mësimimit fillon me leximin e detyrës së shtëpisë, diskutimin rreth realizimit të saj.</p> <p>Hapi II - Kalohet te rubrika: “Të studiojmë gjuhën dhe ndërtimin stilistikor të tekstit”.</p>			

Ushtrim: Për t'i dhënë përgjigje sa më të saktë këtij ushtrimi, nxënësit rikthehen në tekst për të gjetur fjalët kyç në të cilat shkrimtari shpreh:

dashurinë: *Shqipërinë tonë*

krenarinë: *gjak shqiptari*

dhimbje: *mos lëndo*

Ushtrim: Mësuesi/ja vizaton në tabelë *Organizuesin grafik; figurat letrare*.

U drejtohet nxënësve të gjejnë epitete, krahasime e shprehje të figurshme. U tërhiqet vëmendja t'i gjejnë këto figura tek fragmenti ku autori shpirtëzon pasuritë natyrore të vendlindjes. *Figurat letrare* që shpirtëzojnë pasuritë natyrore, nxënësit i vendosin në tabelë.

Epitete	Krahasime	Shprehje të figurshme
i qetë	si një varg	rrëzë tyre është
i butë	ruajtësish besnikë	shtrirë

Hapi III: Ushtrim: Për zhvillimin e këtij ushtrimi, mësuesi/ja shfrytëzon materialet e grumbulluara si modele, maketeve të maleve, liqeneve e qyteteve kryesore. Nxënësit ndërtojnë së bashku hartën e Shqipërisë përreth 5-7 minuta, e krahasojnë me hartën e Shqipërisë të varur në tabelë. Nxënësit, të cilët përzgjidhen nga vetë grupet, vendosin një tabak të bardhë mbi tryezën e mësuesit, përcaktojnë fillimisht pikat e horizontit dhe vendosin në vendin e duhur modelet: male, liqene, qytete. Nxënësit e tjerë vlerësojnë maketet e përgatitura.

Nxënësit diskutojnë rreth maketit duke bërë qasje dhe me përmbajtjen e pjesës si prozë poetike.

Hapi IV: Ushtrim: Fillimisht nxënësit tregojnë se ç'përfaqësojnë të dy personazhet. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të komentojnë mbi tabelën e mëposhtme.

Dhënësi ———— Babai ———— Trashëgimia
Marrësi ———— Djali ———— Mes brezave
Mesazhi ———— Ta duam vendin e ta transmetojmë atë brez pas brezi

Mësuesi/ja bën vlerësimin e orës së mësimin.

Vlerësimi: Për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Dashuria për vendlindjen		Situata e të nxënit: Të shkruajmë me fantazi	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. liston karakteristikat e esesë; 2. zbërthen temën e esesë në formë dhe përmbajtje; 3. respekton strukturën e esesë; 4. analizon tekstin në këndvështrimin e ndërtimit strukturor të esesë; 5. shkruan ese duke zbërthyer temën në formë dhe përmbajtje. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>vendlindje, dashuri, mall, krenari, emocion.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, tabakë të bardhë, informacionet e hulumtuara nga nxënësit, fletore, harta e Shqipërisë, videoprojektor, CD, poezia e Asdrenit.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>TIK, Gjeografi</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Diagrami i Venit; Tabela; Punë e pavarur.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Hapi I: Mësuesi/ja i njeh nxënësit me temën e re të mësimi: <i>Dashuria për vendlindjen</i>, të cilën e shkruan në tabelë.</p> <p>- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të rikujtojnë nxënësit çfarë është eseja. Mësuesi/ja tregohet i kujdesshëm dhe kërkon që të gjithë nxënësit të rikujtojnë shembullin e marrë për esenë “Telashet e vajtjes në kinema”; rikujtojnë strukturën e esesë dhe mënyrën se si ndërtohet ajo.</p>			

Hapi II: Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi/ja përgatit 4-5 pyetjet për diskutim (varen nga materiali) dhe i shkruan në tabelë. Pyetjet mund të jenë:

- Ç'është eseja?
- Ku ndryshon eseja me shkrimin artistik/letrar?
- Mësuesi/ja përdor metodën e Diagramit të Venit. Analizon çdo element të llojit strukturor të esesë dhe të shkrimit artistik letrar.

Hapi III: Mësuesi/ja vendos në videoprojektor poezinë e Asdrenit “Dashuria për atdheun”. Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyç: i ëmbël, i dashur, lëngon, larguar, i trishtuar.

I fton nxënësit që të dallojnë edhe fjalë të tjera nga poezia për t'i përdorur në esenë që do të shkruajnë.

Hapi IV: Nxënësit punojnë në punë të pavarur për 15 minuta. Shkruajnë në fletore esenë “Dashuria për vendlindjen “. Jepen orientime nga mësuesi/ja për zbatimin në ese të këtyre elementeve në formë dhe përmbajtje:

- Zbërthimi i temës së esesë nga ana ideore.
- Respektimi i strukturës së esesë: hyrje – zhvillim – mbyllje, dhe i paragrafëve.
- Stili dhe origjinaliteti i shprehjeve të mendimeve mbi temën.
- Rregullat drejtshkrimore, shkronja e madhe.

Hapi V: Nxënësit lexojnë esetë e realizuara. Diskutojnë me njëri-tjetrin për realizimin e tyre. Analizojnë përmbajtjen ideore dhe stilin e të shkruarit. Kjo etapë zhvillohet nën udhëheqjen e mësueses/it.

Hapi VI: Në këtë hap bëhet vlerësimi i nxënësve në një hulumtim dhe diskutim të përbashkët. Mësuesi/ja mund të krijojë një tabelë për vlerësimin e pjesëmarrjes së nxënësve në veprimtaritë mësimore, por edhe në realizimin e plotë të esesë.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie: Shkruajmë me fantazi një ese me temë “Atdheu im”.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “Zoti të dhashtë” Migjeni ora parë e mësimit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ritregon përmbajtjen e tregimit dhe risjell atë në aktualitet; - përshkruan personazhin e lypësit; - analizon tregimin në formë he përmbajtje; - reflekton mbi mesazhin e tregimit. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>problem social, lypës, varfëri, lutje, vuajtje.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor “Gjuhë shqipe 7”, fletore, fletë formati A4, bojëra uji, skeda.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë; lexim në heshtje; Grupe eksperte me role.</p>			

Organizimi i orës së mësim:

Mësuesi/ja i orienton nxënësit mbi krijimtarinë e Migjenit. Diskuton mbi novelat e Migjenit, mbi letërsinë shqipe të viteve 1930. I njeh me tematikën e novelave dhe me realitetin shqiptar që Migjeni pasqyroj në krijimtarinë e tij.

Hapi I: Ndahet klasa në grupe me nga 6 pjesëtarë secili. U thuhet nxënësve se secili nga anëtarët e grupit do të ketë nga një rol (nxënësve mund t'u jepet mundësia të zgjedhin vetë se çfarë rolesh të luajnë). Nxënësit përzgjedhin lypësin ose zonzjën/zotërinë. Nxënësit krijojnë dialogje dhe në fund flasin mbi temën dhe personazhet që ato luajtën gjatë roleve.

Hapi II: Njihen nxënësit me titullin e tregimit. U thuhet të lexojnë tekstin (mësuesi/ja në bashkëpunim me lexuesin e kanë ndarë tregimin në dy pjesë: 1. Përshkrimi i lypësit 2. Ritual i zakonshëm i rrugicave, i lutjes së lypësit. Nxënësi në rolin e lexuesit është i lirë të bëjë edhe ndarje të tjera dhe diskuton mbështetur në rolet e përcaktuara brenda grupit. Pavarësisht nga kjo u bëhet e qartë nxënësve se nuk është e thënë që të kufizohen brenda roleve që u janë dhënë, p.sh., përmbledhësi mund të bëjë pyetje mund të përcaktojë fjalët kyç etj. Nxënësit flasin rreth personazhit të lypësit dhe mënyrës së jetesës që ai bën.

Hapi III: Gjatë kohës që nxënësi punon brenda grupit, mësuesi/ja i ndjek me kujdes duke ndaluar grup më grup. Dëgjon me kujdes pyetjet e hartuara, përgjigjet e dhëna, lidhjen e çështjeve të trajtuara në tregim me aktualitetin etj. Nuk harron të japë vlerësime për punën e bërë dhe të inkurajojë për të vazhduar më tej.

Hapi IV: Nxënësit (nëse kanë dëshirë) mund të krijojnë produkt përfundimtar duke mbajtur shënime (mund të caktohet një nxënës si mbajtësi i shënimeve), të cilat i këmben më pas me grupet e tjera. Shkëmbimi sjell marrjen e informacionit më të gjerë mbi subjektin e tregimit, mbi personazhin e lypësit, mbi varfërinë dhe kushtet e vështira ekonomike.

Hapi V: Së fundi, mësuesi/ja bën një përmbledhje me një grup ekspertësh të krijuar me nga një përfaqësues (për secilin rol) të përzgjedhur nga çdo grup. Mësuesi/ja shkruan në tabelë informacionin që doli nga puna e grupit të ekspertëve. Në fund, nxënësve u jep një material përmbledhës mbi krijimtarinë e Migjenit.

Bëhet vlerësimi i punës së nxënësve duke veçuar sidomos dëshirën për të bashkëvepruar brenda grupit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie: Përshkruani gjendjen tuaj emocionale gjatë leximit të tregimit.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “Zoti të dhashtë” Migjeni ora dytë e mësimit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ilustron me fjali nga teksti temën që trajtohet; - liston arsyet që i detyron njerëzit të jenë të varfër; - dallon figurat letrare dhe zbërthen kuptimin stilistikor të tyre; - bën portretizimin e personazhit duke shfrytëzuar mjetet stilistike që përdor autori; - analizon gjuhë e përdorur në tregim. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>probleme sociale, lypës, varfëri lutje, vuajtje.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor “Gjuhë shqipe 7”, fletore, fletë formati A4, bojëra uji, skeda, vepra “Novela të qytetit të Veriut” Migjeni.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në dyshe; Diskutim; Empatia.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimit</p> <p>Ora e mësimit fillon me kontrollin e detyrave të shtëpisë dhe diskutimin rreth tyre.</p> <p>Hapi I: Mësimi nis me pyetjet që kanë të bëjnë me interpretimin mbi tekstin. Si i kuptoni fjalët: Hajt! Zoti të dhashtë?! Po lypësi çfarë kuptonte kur i dëgjonte këto fjalë? Argumentojeni mendimin tuaj. Nxënësit, pasi gjejnë fjalitë ku shprehet revolta e lypësit i lexojnë me zë duke bërë komentin e tyre. Për këtë, nxënësit punojnë në dyshe, diskutojnë midis tyre për të qenë të gatshëm t’i përballin mendimet e tyre me ato të dysheve të tjera. Në</p>			

ushtrimin që kërkon plotësimin e tabelës, nxënësit jo vetëm shkruajnë idetë e tyre, por edhe argumentojnë zgjedhjen e tyre. Është mirë të përjashtohen komentet pozitive apo negative ndaj ideve dhe argumenteve që japin nxënësit gjatë diskutimit.

Hapi II: Në ushtrimin çfarë kërkon lypësi nga njerëzit, mëshirë apo ndihmë, si do të reagonit ju ndaj një njeriu në nevojë? Nxënësit rrëfejnë mbështetur në përvojat e tyre vetjake. Në fillim, mësuesi/ja i udhëzon që të tregojnë bukur e pa u zgjatur shumë rreth ngjarjeve që kanë dëgjuar. Nxënësit mund të tregojnë edhe me fotografi të ndryshme, vendet ku jetojnë, jetën që bëjnë etj.

Hapi III: Kalohet tek rubrika mbi gjuhën dhe stilin. Fillimisht njihen nxënësit me rrëfimin duke lexuar materialin e dhënë në tekst dhe më pas gjejnë shprehje të tjera në tekst që përdoren në gjuhën e folur. Shprehja: Buzëqeshje ironike analizohet nga nxënësit në aspektin gjuhësor. Nxënësit përzgjedhin nga gjuha e përdorur dialektore fjalë të cilat i kthejnë ato në gjuhën standarde. Nxënësit plotësojnë tabelën në ushtrimin përkatës.

Modeli jepet si më poshtë:

Dialekt	Gjuha standarde

Pas plotësimit, tabela lexohet nga disa nxënës.

Hapi IV: Mësuesi/ja mund të përdorë metodën e empatisë (vënien e vetes në vendin e tjetrit). Lihen nxënësit 10 minuta për të lexuar dhe për ta vendosur veten në rolin e personazhit kryesor, lypësit, i cili rrëfen jetën dhe ngjarjen. Udhëzohen nxënësit që gjatë rrëfimit të mbështeten në momentet që përcjellin më shumë situatë dramatike. Mësuesi/ja aktivizon tre rrëfimtara dhe, së fundmi, në formën e një minikonkursi të shpallë fitues atë që rrëfen më bukur. Në ushtrimin pasardhës, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të gjejnë fjalët kyç që tregojnë veprimet e lypësit. Nxënësi dallon mënyrën se si lypësi kalon nga veprimet në analizën e situatës në të cilën ndodhet çdo ditë. Nxënësit që janë të talentuar në pikturë mund të paraqesin me vizatim imazhin që ju krijohet nga leximi i tregimit.

Hapi V: Mësuesi/ja i fton nxënësit të nënvizojnë në tekst figurat letrare dhe të bëjnë zbërthimin stilistikor të tyre. Diskutojnë së bashku edhe mbi gjuhën që përdor Migjeni.

Në fund të orës bëhet vlerësimi i nxënësve.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyre shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e përbërë		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja drejton pyetjet: Çfarë është fjalja e thjeshtë? Ç'ndryshim ka fjalja e thjeshtë nga fjalja e vogël? Cilat janë skemat për to?	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalinë e thjeshtë e të përbërë; - krijon fjali të thjeshta e të përbëra; - përdor saktë fjali të thjeshta e të përbëra në gjuhën e folur e të shkruar. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>fjali e thjeshtë, fjali e përbërë, kallëzues.</p>	

Burimet: teksti “Gjuha shqipe7”	Lidhja me fushat kurikulare: TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh; Diagrami i Venit; Praktikë e drejtuar; Praktikë e pavarur (punë në dyshe).	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja drejton pyetjet: Çfarë është fjalia e thjeshtë? Ç' ndryshim ka fjalia e thjeshtë nga fjalia e vogël? Cilat janë skemat për to?</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <p>- Mësuesi/ja drejton pyetjet: Çfarë është fjalia e thjeshtë? Ç' ndryshim ka fjalia e thjeshtë nga fjalia e vogël? Cilat janë skemat për to?</p> <p>- Mësuesi/ja vizaton në tabelë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Skemën e fjalisë së thjeshtë: GE + F + GE 2 2. Skemat e fjalisë më të vogël: <ol style="list-style-type: none"> a. Kryefjalë + Kallëzues b. Kryefjalë + Kallëzues + Kundrinor i drejtë c. Kryefjalë + Folje + Pjesë e kallëzuesit emëror <p>- Po fjalinë e thjeshtë, si e dallojmë nga fjalia e përbërë? Jepni shembuj. Argumentoni përgjigjen.</p> <p>- Nxënësit lexojnë informacionin e dhënë rreth fjalisë së thjeshtë dhe të përbërë. Gjatë leximit nxënësit plotësojnë Diagramin e Venit, në të cilin plotësojnë të përbashkëtat dhe dallimet mes fjalisë së thjeshtë dhe të përbërë.</p> <p>Veprimtari praktike:</p> <p>Punohen ushtrimet 1-4. Në ushtrimin 1, nxënësit gjejnë foljet. Dallojnë fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbërë dhe argumentojnë. Në ushtrimin 2, nxënësit zgjerojnë fjalitë e thjeshta me gjymtyrë të tjera (Kujdes! Këtu nxënësit mund të gabojnë duke shtuar folje dhe duke i kthyer</p>	

fjalitë në fjali të përbëra). Ushtrimi 3. Fjalitë e thjeshta te ushtrimi 2, nxënësit i shndërrojnë në fjali të përbëra.

Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 4.

Mësuesi/ja demonstroi në dërrasë mënyrën e ndarjes të fjalisë së përbërë sipas radhës së veprimeve.

- a. nënvizohen foljet-kallëzues, b. qarkohet mjeti lidhës, c. ndahet fjalia me një vijë vertikale sipas pjesëve përbërëse, d. përcaktohen pjesët e fjalisë së përbërë.

Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 4, sipas shembullit të dhënë në dërrasë.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë fjalinë e thjeshtë dhe fjalinë e përbërë; përcaktojnë fjalinë me bashkërenditje dhe me nënrenditje, përdorin saktë fjalitë e përbëra në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyra shtëpie: Përshkruaj dhomën tënde të gjumit, ku të përdorësh fjali të thjeshta dhe të përbëra.

Prezantim i përshkrimit në *Word*.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Fjalja e përbërë me bashkërenditje e nënrenditje		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të gjejnë foljet në tekstin e dhënë. Qarkojnë mjetin lidhës, ndajnë me vijë vertikale fjalitë e përbëra sipas pjesëve dhe përcaktojnë nëse fjalja është e thjeshtë apo e përbërë.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme: libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalinë e përbërë bashkërenditëse e nënrenditëse; - krijon fjali të bashkërenditura e të nënrenditura; - përdor saktë llojet e fjalive në gjuhën e folur e të shkruar. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>fjali e thjeshtë, e përbërë, me bashkërenditje shtuese, veçuese, kundërshtuese, përmbyllëse.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe7”</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>TIK</p>

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënët me këmbime; INSERT; Praktikë e pavarur (punë në dyshe).

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të gjejnë foljet në tekstin e dhënë. Qarkojnë mjetin lidhës, ndajnë me vijë vertikale fjalitë e përbëra sipas pjesëve dhe përcaktojnë nëse fjalia është e thjeshtë apo e përbërë.

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të gjejnë foljet në tekstin e dhënë. Qarkojnë mjetin lidhës, ndajnë me vijë vertikale fjalitë e përbëra sipas pjesëve dhe përcaktojnë nëse fjalia është e thjeshtë apo e përbërë.
- Nxënësit punojnë ushtrimin 1 në libër sipas kërkesës. Dallojnë fjalitë e thjeshta nga fjalitë e përbëra.
- Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin dhe plotësojnë tabelën INSERT (√, +, ?, -).

√ (informacioni i ditur)	+ (informacioni i ri)	? (paqartësi)	- (njohuri e mësuar ndryshe)

- Mësuesi/ja diskuton me nxënësit për njohuritë e reja, si dhe sqaron paqartësitë që ata kanë.
- Nxënësit punojnë ushtrimin 4. Dallojnë fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe përcaktojnë llojin.

Veprimtari praktike:

- Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimet 2, 3 dhe 5 sipas kërkesave. Dy nxënës punojnë në dërrasë ushtrimet 2 dhe 5.
- Mësuesi/ja diskuton ushtrimet me nxënësit. Këmbëngul që nxënësit të argumentojnë mënyrën e zgjidhjes së ushtrimeve.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë kryefjalën, fjalinë e thjeshtë dhe fjalinë e përbërë; përcaktojnë fjalinë me bashkërenditje dhe me nënrenditje; përdorin saktë fjalitë e përbëra në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyra shtëpie: ushtrimi 5, sipas kërkesës.

Prezantim në *PowerPoint* i njohurive për fjalinë e përbërë me bashkërenditje.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Kronika Teksti joletrar		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon termin kronikë - Liston llojet e kronikave dhe karakteristikat e tyre. - Zbaton dhe respekton rregullat e ndërtimit të kronikës. - Shkruan kronika sipas modeleve të strukturuar. - Analizon strukturën dhe përmbajtjen e kronikës. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>kronikë, strukturë, përmbajtje, informacion, lloje kronikash, rregulla etj.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë Shqipe 7”, informacione mbi kronikat, tabakë të bardhë, bojëra uji, fletë formati.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Punë në grupe; Bisedë; Punë e pavarur.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësim</p> <p>Punë parapërgatitore</p> <p>U kërkohet nxënësve disa orë më parë të mbledhin informacione rreth kronikave, llojeve të kronikave. Ftohet një gazetar në klasë, i cili qëndron gjatë gjithë orës së mësim. Në klasë, zhvillohet një fushatë ku nxënësit e talentuar do të shkruajnë kronika për gazetën e shkollës.</p> <p>Hapi I: Nxënësit tregojnë informacionet e mbledhura (kronika të llojeve të ndryshme) dhe diskutojnë për tematikën që trajtojnë.</p> <p>Hapi II: Në pjesën e dytë të orës së mësim, nxënësit dëgjojnë leximin e një kronike. Nxënësit ndërtojnë pyetje rreth temës që trajtohet në kronikë. Së</p>			

fundmi, nxënësit kërkojnë që gazetari të flasë mbi kronikat dhe të japë informacione rreth tyre. Nxënësit i drejtojnë atij pyetje të ndryshme mbi kronikat.

Hapi III: Në pjesën e tretë të orës së mësimi, klasa punon në grupe.

Grupi 1 - Nxënësit ndërtojnë kronikë të bardhë. Kjo lloj kronike trajton ngjarje me tema të përgjithshme.

Grupi 2 - Nxënësit ndërtojnë një kronikë të zezë. Kjo lloj kronike trajton ngjarje me një përfundim negativ.

Grupi 3 - Nxënësit ndërtojnë një kronikë rozë. Kjo lloj kronike trajton histori personale të personazheve të famshëm.

Grupi 4 - Nxënësit ndërtojnë kronikë gjyqësore. Kjo lloj kronike trajton probleme me temë nga gjyqësori.

Në përfundim të detyrës, secili grup zgjedh një përfaqësues që prezanton punën e grupit.

Hapi IV: Mësuesi/ja orienton nxënësit në tekst për të punuar ushtrimet. Ushtrimet realizohen në mënyrë të pavarur.

Secili nxënës njihet me pyetjet bazë të ndërtimit të kronikës: “kush?”, “ku?”, “kur?”, “pse?”, “çfarë?”.

Nxënësit në mënyrë të pavarur, të udhëhequr nga mësuesi/ja, punojnë me pyetjet duke i ilustruar ato me kronikat.

Hapi V: Lexohet teksti në libër dhe punohen ushtrimet që kërkojnë përcaktimin e rregullave të shkrimit të kronikës. Mësuesi/ja i shkruan rregullat në tabelë. Secili diskuton mbi punën e realizuar.

Së fundi, mësuesi/ja jep një vlerësim për punën e nxënësve, duke i falënderuar për angazhimin serioz në realizimin e të gjitha çështjeve mësimore.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punë e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Shkruani një lloj kronike që dëshironi. Respektoni rregullat e të shkruarit të kronikës.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Shkruajmë një kronikë		Situata e të nxënit: Shkruajmë me fantazi	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimor</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon tekstet e kronikave; - liston rregullat e të shkruarit të kronikave; - zbaton rregullat gramatikore dhe leksikore; - shkruan të gjitha llojet e kronikave; - analizon gjuhën formale të kronikave. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>kronikë, strukturë, përmbajtje, rregulla gramatikore.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, model kronike, tabela, shumësia me ngjyra, modele artikujsh nga gazetatat</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Diagrami i Venit; Shkrim i lirë.</p>			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: Të diskutojmë sëbashku.

- Mësuesi/ja i njeh nxënësit me temën e re: “Kronikën” të cilën e shkruan në tabelë dhe drejton pyetjen:

Çfarë është kronika?

Ç’tipare të përbashkëta dhe të veçanta ka me artikullin?

- Mësuesi/ja i orienton nxënësit të mbështeten te njohuritë që kanë marrë tek teksti joletrar mbi kronikën dhe artikullin.

Nxënësit mendohen 2-3 min, pastaj përgjigjen.

Hapi II: Mësuesi/ja vizaton Diagramin e Venit dhe më pas e plotëson atë me përgjigjet që merr nga nxënësit.

Nxënësit krahasojnë kronikën dhe artikullin për secilën shënojnë karakteristikat. Listojnë të përbashkëtat dhe të veçantat midis tyre, si nga ana e strukturës edhe nga ana e përmbajtjes.

Hapi III: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë një kronikë dhe një artikull dhe të bëjnë të mundur dallimin mes tyre si në strukturë ashtu dhe në përmbajtje. Ilustrojnë me shembuj karakteristikat që dolën nga hapi i dytë.

Hapi IV: Klasa ndahet në grupe. Nxënësit duke rikujtuar rregullat e të shkruarit të kronikës përzgjedhin secili grup nga 1 temë. Temat mund të jenë të ndryshme, por zbatohet struktura e ndërtimit të kronikës.

Nxënësit punojnë në fletore dhe pasi mbarojnë secili lexon kronikën e shkruar.

Njekohësisht diskutojnë mbi mënyrën e ndërtimit të kronikës. Mësuesi/ja i dëgjon me vëmendje duke komentuar e vlerësuar punën e secilit prej tyre.

Në fund të orës bën vlerësim me notë dhe motivon nxënësit aktiv gjatë orës.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie: Dalloni elementet e struktures në një kronike.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: “Makbethi” Shekspir (ora e parë)		Situata e të nxënit: Shfaqje në projektor e fragmentit të tragjedisë “Makbethi” (për 10’) dhe rikujtimi i njohurive të marra në klasën e gjashtë për veçoritë e tekstit dramatik dhe llojet e tij.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ portretizon Makbethin si personazh kryesor; ❖ tregon vendin dhe kohën kur zhvillohet ngjarja; ❖ përshkruan me ndihmën e fjalëve kyç atmosferën në momentin e krimit; ❖ interpreton me emocion rolin e caktuar. 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>tragjedi, vrasje, pabesi, mbret, lakmitar, fron.</p>	
<p>Burimet: teksti mësimor, CD-ja me materialet ndihmëse</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>Teatër, TIK</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh; Lexim në role; Kllaster; Diskutim.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rikujtoni njohuritë e marra për tekstin dramatik <p>Mësuesi/ja liston veçoritë e tekstit dramatik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkruhet enkas për t’u vënë në skenë. 			

- Ndahet në akte dhe skena.
- Përbëhet nga: dialogu, monologu, didaskalitë (fjalët e autorit).

Llojet e teksit dramatik


Plotësohen të përbashkëtat dhe të veçantat e dramës, komedisë e tragjedisë me ndihmën e diagramit të mëposhtëm:

Diskutim

- Ku ndryshon komedia nga tragjedia?
- A është konflikti i pazgjithshëm në tragjedi?
- Ç'tragjedi keni lexuar?
- Nga e ka origjinën ajo?

Ndërtimi i njohurive të reja

- Shfaqja për 10' e fragmentit të shkëputur nga tragjedia me qëllim krijim e idesë për mjedisin, kohën, kostumet
- Lexim në role i fragmentit të tragjedisë.
- Punimi i rubrikës "Të kuptojmë përmbajtjen".



Vlerësimi:

Vlerësimi i situatës:

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të portretizuar personazhe; përcaktojnë elementet e tekstit dramatik, shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë leximit në role.

Detyrë shtëpie:

- Grupi i aktorëve:** Punoni për të interpretuar me ndjenjë rolin e caktuar nga mësuesi/ja.
- Grupi i skenës:** Sillni materiale për dekorimin e skenës.
- Grupi i kostumografisë:** Sillni veshje të ndryshme për aktorët.
- Grupi i fundit:** Sillni materiale me të dhëna për jetën dhe veprën e Shekspirit.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Shkalla: III	Klasa: VII
Tema mësimore: “Makbethi” Shekspir (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> ❖ interpreton me emocion rolin e caktuar; ❖ shpreh ndenjat që përjeton gjatë interpretimit në dramë; ❖ realizon kostumet sipas kohës dhe moshës së personazheve; ❖ dekoron skenën në përshtatje me kohën dhe ngjarjen. 		personazh kryesor, dialog, monolog, fjalët e autorit (didaskalitë), skenograf, kostumograf.	
Burimet: teksti mësimor, kostumet, materialet e dekorimit të skenës		Lidhja me fushat kurikulare:	
		Teatër, Edukim figurativ, Edukim muzikor	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në grupe; Interpretim në role; Diskutim.			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>- Punë parapërgatitore</p> <p>Nxënësit janë ndarë orën e parë në grupe.</p> <p>- Punë përgatitore</p> <p>Nxënësit, sipas grupeve dhe me ndihmën e mësuesit/es, përgatisin skenën, aktorët, muzikën.</p>			

Interpretim

Aktorët interpretojnë rolet e tyre dhe mësuesi/ja bën vlerësimet, por edhe nxënësit japin vlerësimet e tyre rreth punës së grupeve. Lexohen nga grupi i fundit materialet për jetën dhe krijimtarinë e autorit

Diskutim

- A patët vështirësi gjatë punës në grup?
- Cili ishte grupi që ishte përgatitur më mirë?
- Cili nga aktorët interpretoi më bukur?
- A ishte një eksperiencë e bukur për ju kjo shfaqje? Pse?

Punimi i rubrikës “Gjuha dhe stili”.

Vlerësimi:**Vlerësimi i situatës:**

Situata quhet e realizuar kur nxënësit: shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë interpretimit në role: realizojnë skenën sipas kërkesave; përgatisin kostumet; diskutojnë dhe japin gjykimin për interpretimin e vet apo të shokëve e shoqeve.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Fjalja e përbërë me nënrenditje		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të gjejnë foljet në fjalitë e dhëna. Qarkojnë mjetin lidhës, ndajnë me vijë vertikale fjalitë e përbëra sipas pjesëve dhe përcaktojnë llojin e fjalisë sipas mjetit lidhës.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon pjesët e fjalisë së përbërë me nënrenditje dhe mjetin që lidh këto pjesë; - shndërron fjalitë e thjeshta në të përbëra dhe anasjelltas; 		<p>Fjalët kyç:</p> <p>Fjali e thjeshtë, e përbërë me nënrenditje, mjet lidhës.</p>	

- përdor saktë llojet e fjalive të përbëra në gjuhën e folur e të shkruar.	
Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"	Lidhja me fushat kurikulare: TIK
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Të nxënit me këmbime; INSERT; Praktikë e pavarur (punë në dyshe)	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të gjejnë foljet në fjalitë e dhëna. Qarkojnë mjetin lidhës, ndajnë me vijë vertikale fjalitë e përbëra sipas pjesëve dhe përcaktojnë llojin e fjalisë sipas mjetit lidhës (Mësuesi/ja i përgatit fjalitë në PowerPoint. Në pamundësi i përgatit ato në një tabak ose i shkruan në dërrasë.).</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Gjeta një shtëpi që ka një lulishte përpara. ○ U vendos që betonimin e urës ta fillonin pas një jave. ○ Kur doli në lëndinë, djaloshi pa tutje liqenin e madh malor. ○ Besniku u drejtua andej nga vinte jehona e këngës. ○ Ata flisnin të gjithë përnjëherësh, kështu që nuk merrej vesh asgjë. ○ Nuk merrej vesh asgjë, sepse ata flisnin të gjithë përnjëherësh. ○ Po mësove, arrin rezultate të mira. ○ Ajo e donte sportin më shumë nga ç'e donte vëllai i saj. ○ Këmbët e duart më ishin tharë nga të ftohtët, sa mezi duroja. ○ Sado i ri qofsh, për atdheun duhet të sakrifikohesh. ○ Altin, më ndihmo (që) të shkarkojmë makinën. <p>Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit të cilën e shkruan në dërrasë. - Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të gjejnë foljet në fjalitë e dhëna. Qarkojnë mjetin lidhës, ndajnë me vijë vertikale fjalitë e përbëra sipas pjesëve dhe përcaktojnë llojin e fjalisë sipas mjetit lidhës. - Nxënësit lexojnë në heshtje mësimin dhe plotësojnë tabelën INSERT (√, +, ?, -). 	

√(informacion i ditur)	+ (informacion i ri)	? (paqartësi)	- (Njohuri e mësuar ndryshe)
<p>- Mësuesi/ja diskuton me nxënësit për njohuritë e reja, si dhe sqaron paqartësitë. Përqendrohet te skema e fjalisë me nënrenditje të cilën e sqaron në dërrasë.</p> <p>- Me nxënësit punohet ushtrimi 1. Mësuesi/ja udhëzon që nxënësit të ndjekin hapat për analizën e fjalisë së përbërë.</p> <p>Veprimtari praktike:</p> <p>Në dyshe, nxënësit punojnë ushtrimet 2- 5 sipas kërkesave. Dy nxënës punojnë në dërrasë ushtrimet 2 dhe 5.</p> <p>- Mësuesi/ja diskuton ushtrimet me nxënësit. Këmbëngul që nxënësit të argumentojnë mënyrën e zgjidhjes së ushtrimeve.</p>			
<p>Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.</p> <p>Vlerësimi i situatës</p> <p>Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin: dallojnë fjalinë e thjeshtë dhe fjalinë e përbërë; përcaktojnë fjalinë me nënrenditje, përdorin saktë fjalitë e përbëra në gjuhën e folur dhe të shkruar.</p> <p>Detyrë shtëpie</p> <p>Ushtrimi 6, sipas kërkesës.</p> <p>Prezantim në <i>Power Point</i> i njohurive për fjalinë e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje. Diagrami i Venit. Në mungesë të kompjuterit kërkohet që nxënësi të punojë në një fletë formati A4.</p>			

Planifikimi ditor (ditar)



Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime përmbledhëse për fjalinë e përbërë		Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit ndërtojnë pemën e mendimit për fjalinë e përbërë	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca dixhitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			

<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon llojin e fjalisë: e thjeshtë, e përbërë me bashkërenditje, e përbërë me nënrenditje; - kryen veprime të ndryshme, si: plotësim me mjet lidhës, shndërrime nga fjalia e thjeshtë në të përbërë, ndarje të fjalive; - përdor saktë llojet e fjalive të përbëra në gjuhën e folur e të shkruar. 	<p>Fjalët kyç:</p> <p>fjali e thjeshtë, e përbërë me bashkërenditje, me nënrenditje, mjet lidhës.</p>
<p>Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"</p>	<p>Lidhja me fushat kurrikulare:</p> <p>TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Pema e mendimit, Të nxënit me këmbime, Praktikë e pavarur (punë në grup); Diskutim.</p>	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në dyshe, nxënësit ndërtojnë pemën e mendimit për fjalinë e përbërë. - Diskutohen njohuritë me gjithë klasën, mësuesi/ja plotëson pemën e mendimit në tabelë. <p>Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimin të cilën e shkruan në dërrasë. - Në dyshe, nxënësit ndërtojnë pemën e mendimit për fjalinë e përbërë. - Diskutohen njohuritë me gjithë klasën, mësuesi/ja plotëson pemën e mendimit në tabelë. - Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe cakton ushtrimet. <p>Veprimtari praktike:</p> <p>gr. I - ushtrimi 1 dhe 7;</p> <p>gr. II - ushtrimi 2 dhe 8;</p> <p>gr. III - ushtrimi 3 dhe 4;</p> <p>gr. IV - ushtrimi 5 dhe 6.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit punojnë në grup për zgjidhjen e ushtrimeve sipas kërkesës. - Në përfundim, përfaqësues të grupeve lexojnë zgjidhjet e ushtrimeve. Të tjerët saktësojnë dhe plotësojnë në librat e tyre. 	

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin: dallojnë fjalinë e thjeshtë dhe fjalinë e përbërë; përcaktojnë fjalinë me bashkërenditje dhe nënrenditje; zgjidhin ushtrimet sipas kërkesave, përdorin saktë fjalitë e përbëra në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 6.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

<p>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: 3</p>	<p>Klasa: VII</p>
<p>Tema mësimore: Ligjerata e drejtë dhe e zhdrejtë</p>		<p>Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit krahasojnë fjalitë dhe nxjerrin dallimet</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p>			
<p>Nxënësi/ja</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; 2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; 3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm. <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p>			<p>Fjalët kyç:</p> <p>Ligjëratë e drejtë, ligjëratë e zhdrejtë</p>

<ul style="list-style-type: none"> - dallon ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë; - kthen një tekst nga ligjerata e drejtë në të zhdrejtë dhe anasjelltas; - përdor në situata të caktuara ligjeratën e drejtë dhe të zhdrejtë. 	
<p>Burimet: teksti "Gjuha shqipe7"</p>	<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë; Tabela e koncepteve; Praktikë e drejtuar; Punë e pavarur.</p>	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Në dyshe, nxënësit krahasojnë fjalitë dhe nxjerrin dallimet.</p> <p>Abdyl Frashëri ka thënë: "Të bashkohemi në një besë të gjithë shqiptarët."</p> <p>E pyeta sekretaren: "Kur e ke mbaruar shkollën e lartë?"</p> <p>Ajo m'u përgjigj: "E kam mbaruar vjet".</p> <p>Abdyl Frashëri ka thënë që të bashkohemi me një besë të gjithë shqiptarët <i>(Në këtë rast ruhet koha dhe veta e foljeve, sepse thënia ka vlerë gjithëkohore.)</i>.</p> <p>E pyeta sekretaren se kur e kishte mbaruar shkollën e lartë.</p> <p>Ajo m'u përgjigj se e kishte mbaruar një vit më parë.</p> <p>Veprimet në situatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në tabelë. - Në dyshe, nxënësit krahasojnë fjalitë dhe nxjerrin dallimet. <ol style="list-style-type: none"> 1. Fjalitë e pavarura kthehen në fjali të përbëra me nënrenditje. 2. Ndryshojnë kohët e foljeve. 3. Ndryshon veta e foljeve. 	

Mësuesi/ja shkruan përgjigjet e nxënësve në dërrasë. Shpjegon ç'është ligjerata e drejtë dhe e zhdrejtë dhe u kërkon nxënësve të japin shembuj të kalimit nga ligjerata e drejtë në të zhdrejtë dhe anasjelltas.

- Nxënësit lexojnë mësimin dhe plotësojnë tabelën:

Ligjerata e drejtë: fjalët tona ose të një tjetri të riprodhuara me përpikmëri nga një person tjetër. Mund të jetë një fjali e thjeshtë, e përbërë ose një thënie prej disa fjalësh.	Ndryshimet kur kalojmë nga ligjerata e drejtë në ligjeratë të zhdrejtë: <ul style="list-style-type: none">➤ Kohët e foljeve; foljet kalojnë një kohë prapa.➤ Vetat e foljeve dhe e përemrave.➤ Ndajfoljet e kohës ose përcaktorë që lidhen me procesin e veprimit.
Ligjerata e zhdrejtë: fjalët tona ose të një tjetri të riprodhuara, të ndryshuara nga një person tjetër.	

Veprimtari praktike:

- Mësuesi/ja zhvillon me nxënësit ushtrimin 1.

- Nxënësit zhvillojnë në fletore ushtrimet 2 dhe 3: kthejnë ligjeratën e drejtë në të zhdrejtë dhe anasjelltas.

- Mësuesi/ja diskuton zgjidhjen e ushtrimeve me nxënësit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë ligjeratën e drejtë dhe të zhdrejtë; kthejnë një tekst nga ligjerata e drejtë në të zhdrejtë dhe anasjelltas; përdorin në situata të caktuara ligjeratën e drejtë dhe të zhdrejtë.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 4, sipas kërkesës.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Bulina Naum Prifti Ora e parë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Tregon ngjarjen sipas pikave të planit.</p> <p>Përcakton kohën, vendin ku zhvillohen ngjarjet në tekst.</p> <p>U përgjigjet pyetjeve rreth brendisë së tekstit.</p> <p>Jep vlerësimin e tij për tregimin.</p>			<p>Fjalët kyç:</p> <p>Bulina, fëmijë, ngjarje, oficer gjerman, dashuri për kafshët.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletore, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bisedë; DRTA; Diskutim.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I. Mësimi nis me një bisedë rreth pyetjeve:

- Ç'ju kujton emri Bulina?
- Në ç'botë ju fut ky personazh?
- Cila është marrëdhënia e fëmijëve me atë?
- Si titullohet tregimi? Pse?

(Biseda zgjat rreth 5 minuta. Nxënësit të kujtojnë momentet kryesore të marrëdhënies së fëmijëve me qenin e tyre të dashur.)

Hapi II. Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e mësimi "Bulina". U thotë nxënësve se do të njihen me aventurat e fëmijëve me Bulinën. U kërkohet atyre, nisur nga titulli, të japin mendimin e tyre se për çfarë bëhet fjalë në këtë pjesë (nxënësit që e kanë lexuar vetëm dëgjojnë). Më tej mësuesi/ja lexon tekstin me ndalesa. Bëhen tri ndalesa dhe për secilën u kërkohet nxënësve:

- para leximit të parashikojnë rrjedhën e ngjarjes;
- pas leximit ta plotësojnë dhe ta krahasojnë atë me parashikimin e tyre.

Hapi III. Ndalesa I - Lexohet pjesa nga fjalia e parë: "Atë ditë" ...deri tek "...dhe lehu mbytur".

- Çfarë ndodhi atë ditë?
- Si përshkruhet vendi ku zhvillohet ngjarja?
- Çfarë ishte Bulina për fëmijët?

Ndalesa II - Lexohet teksti nga "Makinat ushtrake..." deri tek "...u kthye në të djathtë".

- Si përshkruhen makinat gjermane?
- Kush ishte në veturën e vogël dhe çfarë bëri oficeri gjerman?
- Çfarë pa Bulina?

Ndalesa III - Lexohet teksti nga "Bulina..." deri tek "...makina të tjera gjermane".

- Pse u shqetësuan për Bulinën?
- Çfarë ndodhi?
- Çfarë ndjenë fëmijët kur panë Bulinën të shtrirë?

Nxënësit punojnë me fjalorin gjatë leximit të tekstit.

Për secilën ndalesë, nxënësit diskutojnë, japin përgjigje, komentojnë dhe analizojnë situatat e zhvillimit të ngjarjeve.

Bëhet vlerësimi i orës së mësimi.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punë e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Dramatizojeni pjesën dhe luajeni atë në role.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Bulina Naum Prifti Ora e dytë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Interpreton me role pjesën.</p> <p>Dallon karakteristikat e një dashurie midis fëmijës dhe kafshës.</p> <p>Vlerëson cilësitë e mira të fëmijëve dhe miqësinë e tyre me Bulinën.</p> <p>Gjykon rreth veprimit të oficerit gjerman.</p> <p>Gjen figurat letrare dhe zbërthen kuptimin e tyre.</p> <p>Analizon tekstin në formë dhe përmbajtje.</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>Bulina, fëmijë, dashuri për kafshët, ngjarje, oficer gjerman.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletore, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, CD, filmi “Tomka dhe shokët e tij”.</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Interpretime në role; Diagrami i Veni; Argumentim idesh; Diskutim.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I. Nxënësit, sipas roleve të ndara një orë më pare, interpretojnë pjesën.

Personazhet: Bulina, fëmija I, fëmija II, fëmija III, oficeri gjerman.

Pjesa mund të luhet edhe nga dy grupe nxënësish. Vetë nxënësit vlerësojnë interpretimet e realizuara.

Hapi II. Rubrika mbi pyetjet rreth përmbajtjes së tregimit.

- Ndaluni në marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve dhe Bulinës. Gjeneroni në tekst momentet ku shprehet kjo marrëdhënie.

Ushtrimi: Çfarë ndjeni për Bulinën gjatë leximit? Si e përjetuan fëmijët ngjarjen atë ditë?

Tregoni cilësitë e fëmijëve që dalin nga marrëdhënia e dashuria për Bulinën, duke i krahasuar me marrëdhëniet e oficerit gjerman me Bulinën.

Fëmijët - Bulina	Oficeri gjerman - Bulina
-------------------------	---------------------------------

Ushtrimi: Nxënësit mbyllin sytë dhe e imagjinojnë skenën kur mësuesi/ja pyet se çfarë ndjeni kur humbisni kafshën tuaj të preferuar. Secili jep mendimin e tij duke argumentuar.

Ushtrimi: Tashmë nxënësit e njohin mirë marrëdhënien e tyre me Bulinën. Ata listojnë cilësitë, karakteristikat që shfaqen në tregim, duke e ilustruar me momente nga teksti.

Më pas, nxënësit diskutojnë rreth marrëdhënieve të personazheve me Bulinën.

Fëmijët tregojnë: lidhjen e tyre me Bulinën, situatat dhe momentet që kalonin së bashku, lojërat e ndryshme, dashuria për njëri –tjetrin.

Oficeri gjerman tregon egërsinë e tij ndaj Bulinës dhe arsytet pse sillet ashpër me të.

Ushtrimi: Zhvillohet bisedë. Nxënësit sjellin argument për të treguar se dashuria për kafshët është shumë e madhe.

Hapi III. Kalohet te rubrika “gjuha dhe stili” dhe punohet me ushtrimet e kësaj rubrike.

Ushtrimi: Nxënësit rikthehen në tekst. Nënvizojnë fjalët kyç dhe plotësojnë tabelën e mëposhtme:

Pamja e jashtme	Veprimet që kryen
------------------------	--------------------------

--	--

--	--

Ushtrimi: Nxënësit punojnë me tekstin dhe nënvizojnë figurat letrare: epitetet, krahasimin. Gjejnë shembuj, por edhe realizojnë zbërthimin e funksionit stilistikor të tyre.

Ushtrimi: Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të gjykojnë veprimet e personazheve duke dhënë komentin e tyre.

Personazhet	Veprimet	Komenti
Bulina		
Fëmijët		
Oficeri gjerman		

Mësuesi/ja, gjatë diskutimit në çdo etapë të orës, bën vlerësimin e nxënësve.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri. **Vlerësimi i situatës**

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Të duam kafshët Të flasim		Situata e të nxënit: Flasim mbi temën	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lexon tekste ku trajtohen tema mbi kujdesin dhe dashurinë për kafshët. - Diskuton mbi imazhet, fotografitë duke shprehur mendimet rreth tyre. - Tregon mbi marrëdhëniet midis njerëzve, kafshëve dhe shpreh qëndrimin rreth situatave. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>kafshët, rregulla, ligji për kafshët, kopshti zoologjik.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, Ligji Ndërkombëtar Kundër Keqtrajtimit të Kafshëve, rregullorja, CD, videoprojektor, fotografi.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Bashkëbisedim; Demonstrim; Diskutim.</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimi</p> <p>Punë parapërgatitore</p> <p>Mësuesi/ja u ka kërkuar 4 nxënësve të sjellin në klasë për zhvillimin e orës dhe së mësimi postera, foto me kafshët e tyre të preferuara.</p> <p>Gjithashtu, nxënësit kanë lexuar në google ligjin kundër keqtrajtimit të kafshëve.</p> <p>Hapi I: Kjo orë mësimi zhvillohet në formë bashkëbisedimi, i cili përqendrohet në dy momente kryesore në realitetin e përditshëm dhe në imagjinatën apo ndjesitë e nxënësve për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të shtruar. Çdo nxënës mendon kafshën e tij të preferuar. Pyetjet janë:</p>			

- Cila është kafsha juaj e preferuar?

- Cila është mënyra se si e trajtoni ju atë?

- Si ndjeheni ju kur ndodheni në shoqërinë e kafshës suaj?

- Po në realitetin e përditshëm, çfarë ndodh me kafshët e rrugës? Nxënësit diskutojnë dhe tregojnë nga përvojat e tyre.

Hapi II: Nxënësit flasin rreth Ligjit Kundër Keqtrajtimit të Kafshëve. Mësuesi/ja, nëpërmjet videoprojektorit, paraqet rregullat, nenet e ligjit. Nxënësit flasin rreth përvojave të tyre me kafshët e parapëlqyera, për mënyrën e bashkëjetesës, për mënyrën e trajtimit. Flasin dhe komentojnë rreth ligjit dhe rregullave për mbrojtjen e kafshëve. Nxënësit mbajnë një qëndrim të caktuar.

Hapi III: Mësuesi/ja i fton nxënësit të punojnë rreth pyetjeve në tekstin mësimor në mënyrë të pavarur. Nxënësit demonstrojnë punën e bërë mbi pyetjet e rubrikës: "Ushtroni". Madje komentet e tyre shoqërohen me postera, foto me kafshë të ndryshme. Çdo hap diskutimi në klasë udhëhiqet nga mësuesi/ja. Mësuesi/ja vlerëson nxënësit që u aktivizuan gjatë orës së mësimt.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Përshkruani kafshën tuaj të preferuar.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Mënyrat e fjalëformimit të fjalëve në gjuhën shqipe		Situata e të nxëniet: Nxënësit punojnë në grupe me fishat e përgatitur nga mësuesi/ja.	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyç			
Nxënësi/ja:			
<ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalët kyç:
Nxënësi/ja:			fjalë e parme, jo e parme, fjalë e prejardhur, e përbërë, e përngjitur, parashtesa, prapashtesa, temë fjalëformuese.
<ol style="list-style-type: none"> dallon fjalët e parme, jo të parme, të prejardhura, të përbëra, të përngjitura; formon fjalë të reja duke përdorur mënyra të ndryshme të fjalëformimit; bën analizën fjalëformuese të një fjale. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë me fisha (punë në grupe); Pema e mendimit; Shpjegim i kombinuar me diskutim.			
Përshkrimi kontekstual i situatës			
Nxënësit punojnë në grupe me fishat e përgatitur nga mësuesi/ja.			
Gr. I			
Ndan fjalët e ushtrimit 1 në të parme dhe jo të parme. Cili është dallimi mes tyre?			

fjala	e parme	jo e parme
ishte	+	
ditë	+	
kryengritje		+

Gr. II

Dallon temën nga mbaresa (ushtrimi 1).

fjala	tema	mbaresa
shërbeja	shërbe	ja
anën		
kryengritje		
mbretit		
fol		
kryengritja		
shtyp		
kryengritësit		
kapën		
burgosën		
vranë		
njërin		

(Mësuesi/ja sqaron nxënësit se, për të dalluar temën nga mbaresa duhet të lakojmë emrin/mbiemrin dhe të zgjedhjmë foljet. Pjesa e fjalës që nuk ndryshon është tema.)

Gr. III

Dallon temën fjalëformuese të fjalëve (ushtrimi 9).

fjala	tema fjalëformuese
vogëlush	vogël
gëzim	gëzo

mençuria marrëzi rigjejnë komunikimin lidhjen pazakontë		
--	--	--

(Mësuesi/ja sqaron se tema fjalëformuese është ajo fjalë nga e cila formohet drejtpërdrejt një fjalë tjetër. Sqaron në dërrasë fjalët **vogëlush** dhe **gëzim**. Sqaron se, emrat që formohen me prapashtesat -im, -je, -esë vijnë nga foljet.)

Gr. IV

Plotëson tabelën sipas kërkesës (ushtrimi 7).

fjala	mbarësa	parashtesa	prapashtesa	rrënja
zbukuroj	j	z-	-o	bukur
ngurosi				
ullishte				
barkazi				
tërheqës				
aftësia				
largimi				
veprimi				
paqësore				
mosbesim				
stërgjysh				
përkrenare				

Gr. V

Formon fjalë të reja duke lidhur parashtesat me temat fjalëformuese (ushtrimi 5).

	vlerësoj
--	----------

për- mbi- ç- sh- ri-	shkruaj liroj këmbej ngarkoj ndërtoj lodhje pagim punoj
----------------------------------	--

Gr. VI

Formon fjalë të reja duke lidhur prapashtesat me temat fjalëformuese (ushtrimi 5).

shah det marr vesh vonë ditë bark bind	-ës -je -esë -or -as -ist -ar
---	---

Gr. VII

Formon fjalë të përbëra duke lidhur fjalët (ushtrimi 10)

rrufe letër hekur këpucë breg	detar ëmbël ministër dhe këmbim	rrufepritës
---	---	-------------


krye	qepës		
zemër	punues		
flokë	pritës		
rroba	bërës		
at	verdhë		
zë	bardhë		

Gr. VIII

Punon me ushtrimin 8.

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe secilit grup i jep fisha ose detyrë nga teksti. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin e më pas plotësojnë fletën e punës. Kjo veprimtari të mos zgjasë më shumë se 10-15 minuta.
- Një përfaqësues nga secili grup lexon fletën e punës që kanë plotësuar duke shpjeguar mënyrën e formimit të fjalës së re, kuptimin që ajo merr (fjalët e prejardhura), klasën së cilës i përket fjala e formuar, marrëdhëniet që vendosen midis temave (te fjalët e përbëra). Çdo pjesëtar i grupit mund të plotësojë, saktësojë, por pasi përfaqësuesi jep përgjigjet.
- Mësuesi/ja drejton pyetjen: Cili është dallimi mes fjalëve të përbëra dhe të përngjitura?
- Punohen ushtrimet 4, 5 në libër.
- Mësuesi/ja, mbështetur në gjithë veprimtarinë që zhvilluan nxënësit, plotëson bashkë me ta pemën e mendimit:



- Nxënësit lexojnë mësimin dhe plotësojnë pemën e mendimit në fletore.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësim i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar, kur nxënësit arrijnë të zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, dallojnë temën, mbaresën, parashtesën, prapashtesën, përcaktojnë mënyrën e fjalëformimit të fjalëve.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 6. Mësuesi/ja sqaron në dërrasë analizën fjalëformuese të fjalës “përvjetorit”.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ushtrime përmbledhëse për fjalëformimin e fjalëve në gjuhën shqipe		Situata e të nxëniet: Mësuesi/ja drejton pyetje rreth formimit të fjalëve.	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyç			
Nxënësi/ja:			
<ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			Fjalët kyç:
Nxënësi/ja:			fjalë e parme, jo e parme, fjalë e prejardhur, e përbërë, e përngjitur, parashtesa, prapashtesa, temë fjalëformuese.
<ol style="list-style-type: none"> dallon fjalët e parme, jo të parme, të prejardhura, të përbëra, të përngjitura; formon fjalë të reja duke përdorur mënyra të ndryshme të fjalëformimit; bën analizën fjalëformuese të një fjale. 			
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh; Praktikë e pavarur (punë në dyshe); Praktikë e drejtuar; Diskutim.			

Përshkrimi kontekstual i situatës

Mësuesi/ja drejton pyetje rreth formimit të fjalëve:

Ç'janë fjalët e parme dhe jo të parme?

Si i ndajmë fjalët jo të parme?

Ku dallohen fjalët e prejardhura nga fjalët e përbëra dhe të përngjitura?

Thoni disa parashtesa dhe prapashtesa.

Veprimet në situatë:

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit, të cilën e shkruan në dërrasë.

- Mësuesi/ja drejton pyetje rreth formimit të fjalëve:

○ Ç'janë fjalët e parme dhe jo të parme?

○ Si i ndajmë fjalët jo të parme?

○ Ku dallohen fjalët e prejardhura nga fjalët e përbëra dhe të përngjitura?

○ Thoni disa parashtesa dhe prapashtesa.

Veprimtari praktike

Në dyshe, nxënësit punojnë për plotësimin e ushtrimeve 1, 2, 3, 4, 6, 7 sipas kërkesave.

Në përfundim, diskutohen ushtrimet me klasën.

- Lexohet detyra e shtëpisë.

Ushtrimin 5 mësuesi/ja e zhvillon në dërrasë. Sqaron hapat e analizës fjalëformuese të fjalëve.

përgënjeshtroj

Në fillim ndahet tema nga mbaresa: **përgënjeshtro + j** (përgënjeshtro - tema, - j mbaresa)

për + gënjeshtër + o (me parashtesë dhe prapashtesë njëkohësisht; gënjeshtër - tema fjalëformuese) **gënjeshtër** (rrënja e fjalës)

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; klasifikojnë fjalët sipas formimit; dallojnë temën e fjalës nga tema fjalëformuese; formojnë fjalë të prejardhura dhe fjalë të përbëra; analizojnë fjalët për nga fjalëformimi.

Detyrë shtëpie: ushtrimet 8, 9.

Planifimi ditor (ditar)



Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Familja e fjalëve		Situata e të nxënit: Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën <u>drejt</u> dhe u kërkon nxënësve të krijojnë sa më shumë fjalë të parashtesave, prapashtesave dhe fjalë të përbëra (-o, - or, -im, -uar,-(ë)si, - sht, -ues, -i, pa-, peshim, qëndrim) (2')	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç			
<p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; 2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim. 3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; 4. shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.) duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: 1. dallon fjalët e së njëjtës familje;		Fjalët kyç: familje fjalësh, parashtesa, prapashtesa, rrënja, tema fjalëformuese.	

<p>2. përcakton elementet fjalëformues;</p> <p>3. formon familje fjalësh.</p>	
<p>Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"</p>	<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p> <p>TIK</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lojë me role; Shpjegim i kombinuar me diskutim; Punë e pavarur; Diskutim.</p>	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën <u>drejt</u> dhe u kërkon nxënësve të krijojnë sa më shumë fjalë të parashtesave, prapashtesave dhe fjalë të përbëra. (-o, -or, -im, -uar,-(ë)si, -sht, -ues, -i, pa-, peshim, qëndrim) (2').</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p>- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në dërrasë.</p> <p>- Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën <u>drejt</u> dhe u kërkon nxënësve të krijojnë sa më shumë fjalë të parashtesave, prapashtesave dhe fjalë të përbëra (-o, -or, -im, -uar,-(ë)si, -sht, -ues, -i, pa-, peshim, qëndrim) (2').Nxënësit thonë fjalët e formuara të cilat mësuesja i shkruan në tabelë për të formuar skemën e familjes së fjalës <u>drejt</u>.</p> <p>drejtësisht drejtësi drejt drejto drejtim</p> <p>drejtqëndrim drejtor drejtuar drejtues</p>	

drejtpeshim drejtori i drejtuar i padrejtuar

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të vërejnë skemën e dhënë në libër dhe të shpjegojnë si janë formuar fjalët, cilat janë parashtesat, prapashtesat dhe temat fjalëformuese. Në dyshe, plotësojnë skemën e fjalës tjetër.

Veprimtari praktike

Ndahet klasa në katër grupe dhe secili ponon ushtrimet 1-4 sipas kërkesave.

Një pjesëtar i secilit grup lexon zgjidhjet e ushtrimeve. Pjesa tjetër e klasës plotësojnë në libër ose në fletore.

Mësuesi/ja ndërhyt në rastet kur është e nevojshme të sqarohet ose të plotësohet.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, dallojnë fjalët që i përkasin të njëjtës familje, ndërtojnë familje fjalësh.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 5. Në programin *Word* mund të krijojnë familjet e fjalëve të dhëna.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Rruga e kthimit Petro Marko Ora e parë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Krijon një tekst të shkurtër mbështetur në fjalët kyçe.</p> <p>Lexon për të kuptuar përmbajtjen e tregimit dhe për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të shtruara, për të pasuruar fjalorin me fjalë të panjohura prej tyre.</p> <p>Vlerëson aftësitë krijuese të njëri-tjetrit.</p> <p>Zbulon mesazhin e pjesës.</p> <p>Zbërthen nga ana ideore tregimin.</p> <p>Analizon gjuhën e përdorur në tregim.</p>			<p>Fjalët kyç:</p> <p>Shpellë</p> <p>pirat</p> <p>shoqëri</p> <p>udhëheqës</p> <p>udhëtim</p> <p>fantastiko-shkencor</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletore, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, romani “Shpella e Piratëve”, materiale nga interneti.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Parashikim me terma paraprakë; Lexim zinxhir; Diskutim.</p>			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe: shpella, kuriozitet, anije, piratë, histori fantastike. U kërkohet nxënësve që me 7-8 fjali të krijojnë një tekst në mënyrë të pavarur rreth 5-7 minuta.

Hapi II. Lexohen disa krijime. Nxënësit vlerësojnë punimet e njëri-tjetrit mbështetur në:

shtjellimin interesant të ngjarjes;

në mënyrën e të shprehurit;

në përfshirjen e të gjithave fjalëve kyçe.

Hapi III. Njihen nxënësit me temën, të cilën mësuesi/ja e shkruan në tabelë. Lexohet pjesa nga disa nxënës (zinxhir). Në fillim udhëzohen nxënësit të ndjekin me vëmendje leximin për të mbajtur mend. Mësuesi/ja i fton nxënësit të diskutojnë rreth pyetjeve të mëposhtme:

emrat e personazheve;

dialogët midis fëmijëve dhe Gjonbabës;

gjendjen shpirtërore të Ilirit.

Gjatë leximit, nxënësit nënvizojnë fjalët e panjohura. Për ato të pashpjeguarat në tekst, nxënësit ndihmohen nga mësuesi/ja ose Fjalori i gjuhës së sotme shqipe. Leximi i nxënësve ndërpritet në fjalinë: “Më pëlqen kur dëgjoj të flas për trimërinë.

Hapi IV. U kërkohet nxënësve të parashikojnë se si mbyllet tregimi. Dëgjohen disa nxënës më pas lexohet mbyllja e dhënë nga autori/ Bëhet krahasimi me alternativat e ofruara prej nxënësve. Diskutohet rreth alternativave.

Hapi V. Kalohet tek pyetjet për të kuptuar përmbajtjen. Punohen ushtrimet e kësaj rubrike.

Ushtrim. Nxënësit plotësojnë me të dhëna nga tregimi këto pyetje: koha kur zhvillohen ngjarjet, vendi ku zhvillohet ngjarja, tema e tregimit, mesazhi që përcjell autori, personazhet që marrin pjesë në tregim.

Ushtrim. Gjatë ritregimit të bisedave midis fëmijëve dhe Gjonbabës, nxënësit japin edhe gjykimin e tyre rreth gjendjes shpirtërore më të cilën ndodhen: Iliri, Fotoja apo personazhet e tjerë. Mënyra e përjetimit të personazheve gjatë udhëtimit, qëllimi i tyre, dëshira për të realizuar këtë udhëtim dhe kurioziteti për të njohur çdo gjë.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Përshkruani vizitën tuaj në një vend turistik.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Rruga e kthimit Petro Marko Ora e dytë		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Tregon ndjenjën që përjetuan fëmijët kur vizituan shpellën.</p> <p>Jep mendime rreth mënyrës së marrëdhënies midis fëmijëve dhe Gjonbabës.</p> <p>Komenton mbylljen e tregimit dhe jep ide rreth saj.</p> <p>Shpjegon kuptimin e figurshëm të shprehjeve të dhëna mbështetur në kuptimin e parë të tyre.</p> <p>Dallon figurat letrare (epitete, krahasime) të përdorura nga autori në përshkrimin e shpellës.</p> <p>Analizon veprën nga ana ideore.</p>		<p>Fjalët kyç:</p> <p>shpellë, pirat, shoqëri, udhëheqës, udhëtim fantastiko-shkencor.</p>	
Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, fletore, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe		Lidhja me fushat kurikulare:	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Parashikim me terma paraprakë; Lexim zinxhir; Diskutim.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I. Mësimi nis me punimin e detyrës së shtëpisë. Dëgjoen me vëmendje mendimet e nxënësve mbi përshtypjet që ju kanë lënë vizitat në vendet me trashëgimi kulturore.

Listohen në tabelë përshtypjet, duke i renditur sipas rëndësisë që mendojnë nxënësit se ato kanë.

Hapi II. Kalohet tek rubrika: “Gjuha dhe stili”.

Ushtrim. Nxënësit për 5 minuta punojnë në mënyrë individuale. Kujtojmë skemën e komunikimit dhe lidhim me shigjeta elementet përbërës të saj.

Plotësimi i skemës, sipas modelit, p.sh:

Dhënësi	Tema
Marrësi	Ideja
Referenti	Gjuha
Kodi	Lexuesi
Mesazhi	Shkrimtari

Çdo nxënës ilustron këto elemente me të dhëna nga teksti. Punon me tekstin dhe nënvizon fjalitë.

Ushtrim. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të gjejnë në tekst fjalët kyç dhe shprehjet e figurshme me të cilat fëmijët përshkruajnë Gjonbabën gjatë udhëtimit të tyre. Punohet me tekstin 5 minuta, pastaj secili nxënës liston disa prej tyre dhe i grupon sipas klasave të fjalëve.

Ushtrim. Nxënësit rikthehen në tekst dhe nënvizojnë figurat letrare, si: epitete, krahasime, metafora që autori ka përdorur për ta bërë më tërheqës rrëfimin.

Nxënësit diskutojnë rreth tyre. Bëjnë zberthimin e figurave letrare nga ana kuptimore dhe gjuhësore.

Ushtrim. Duke lexuar mirë tekstin, nxënësit punojnë mbi ushtrimin: Plotësoni disa cilësi të personazheve:

- Të Ilirit _____ - Të Gjonbabës _____ - Të Fotos _____

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të dallojnë shkallët e mbiemrave që përdoren. Ata flasin edhe mbi qëllimin stilistik të përdorimit në tekst. Bëhet vlerësimi i orës së mësimi.

Mësuesi/ja falënderon nxënësit aktiv gjatë orës së mësimi.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

<p>Fusha: Gjuha dhe komunikimi</p>	<p>Lënda: Gjuhë shqipe</p>	<p>Shkalla: 3</p>	<p>Klasa: VII</p>
<p>Tema mësimore: Fusha leksikore</p>		<p>Situata e të nxënit: Në dyshe, nxënësit lexojnë tekstet e dhëna dhe punojnë për të krijuar bashkësi me fjalët që i përkasin të njëjtës fushë leksikore. Gjysma e klasës punon njërin tekst, gjysma tekstin tjetër.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p>			
<p>Nxënësi/sja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; 2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; 3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; 4. shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. dallon fjalët e së njëjtës fushë leksikore; 2. formon fushën leksikore të një fjale të dhënë. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>fusha leksikore, bashkësi, kuptim.</p>

Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"	Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Rishikim në dyshe; Shpjegim i kombinuar me diskutim; Punë e pavarur; Diskutim.	
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Mësuesi/ja përgatit skeda ky janë shkruar dy tekste të shkurtër. Nxënësit do të gjejnë fjalët që i përkasin fushës leksikore të fjalëve: ngjyrë, tinguj, pjesët e trupit të njeriut, imazhe pamore.</p> <p>Në dyshe, nxënësit lexojnë tekstet e dhëna dhe punojnë për të krijuar bashkësi me fjalët që i përkasin të njëjtës fushë leksikore. Gjysma e klasës punon njërin tekst, gjysma tekstin tjetër.</p> <p>Skeda 1</p> <p><i>Mëngjesi kishte zbardhur në zemër të kënetës. Nga qielli ngjyrë kobalti të pastër, i vijëzuar aty-këtu me shtëllunga të lehta resh të bardha, shkëlqente dielli me një ngrohtësi të butë e të dobishme mbi gjelbërimin e brishtë të kallamishteve gjysmë të rritura dhe barëra tashmë të harlisura të ujit pluskonin si gjethe zambakësh. Disa flutura të mëdha kuq e zi fluturonin me nge mbi majat e xunkthit. Aty-këtu vezullonte mbi sipërfaqe të ujit ndonjë pilivesë, që rrihte lehtë flatrat e veta të tejdukshme, me një shkëlqim si zjarr ngjyrë smeraldi e ametisti. Në çdo shkurre vinin tingujt e butë të mëllenjave që bënin foletë. Dhe pikërisht brenda buzës ujore të xunkthave, si ndonjë dru ngjyrë kafe, qëndronte një gakh.</i></p> <p>Skeda 2</p> <p><i>Pak më i vogël se një metër, nga maja e sqepit të tij të fuqishëm në formë kamë deri te fundi i bishtit të shkurtër dhe të rrumbullakët, me sy të rreptë, të shndritshëm e të fortë, që nuk i kapsalliste kurrë, me kokën gjarpërushe dhe qafën e gjatë muskulore, dukej sikur ishte zot i plotfuqishëm i kënetës. Madje, ashtu i palëvizshëm siçi ishte, një sy i pastërvitur do ta kishte marrë për trung të kalbur buzë ujit. Këmbët e gjata i kishte ngjyrë ulliri të mbyllur, që shkonte me tonet e hijëzuara të ujit.</i></p>	

Veprimet në situatë

- Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në dërrasë.

Në dyshe, nxënësit lexojnë tekstin e dhënë dhe punojnë për të krijuar bashkësi me fjalët që i përkasin të njëjtës fushë leksikore.

Ngjyra: *ngjyrë kobalt i pastër, re të bardha, gjelbërimi, kuq e zi, shkëlqim si zjarr, ngjyrë smeraldi, ametisti, dru ngjyrë kafe.*

Tinguj: *pluskonin, rrihte lehtë flatrat, tingujt e butë të mëllenjave.*

Imazhe pamore: *re, dielli, kallamishte, barëra, flutura, pilivesë, mëllenjat, xunkthave, dru, gakh.*

Pjesët e trupit: *maja e sqepit, bishti i shkurtër e i rrumbullakët, sy të rreptë, kokën gjarpërushe, qakën e gjatë muskulore, këmbët ngjyrë ulliri të mbytur.*

Mësuesi/ja pyet nxënësit se ç'është fusha leksikore. Lexohet mësimi dhe nxënësit japin shembuj të tjerë duke plotësuar secilin rast të dhënë, p.sh., zhurma: plasje, kërcitje, shushurimë etj.

Veprimtari praktike

Në dyshe, nxënësit punojnë ushtrimet 1- 5 dhe 7 sipas kërkesave.

Në përfundim, ushtrimet diskutohen me të gjithë klasën. Mësuesi/ja është i vëmendshëm që të aktivizojë sa më shumë nxënës.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësim i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; përcaktojnë fushën leksikore të fjalëve; formojnë fushën leksikore të një fjale të dhënë.

Detyrë shtëpie: ushtrimet 6 dhe 8 (në dy grupe).

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Sinonimet, antonimet, homonimet		Situata e të nxënit: Në grupe, nxënësit formulojnë pyetje rreth sinonimeve dhe antonimeve, si dhe krijojnë çifte sinonimike dhe antonimike.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e tij për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar: rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; shpreh drejt një mendim apo kërkesë për një situatë të caktuar, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare, (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> dallon sinonimet dhe antonimet në një tekst të dhënë; formon sinonime dhe antonime me fjalët e dhëna; ndërton fjali me homonime. 			<p>Fjalët kyç: sinonime, antonime, homonime.</p>
Burimet: teksti "Gjuha shqipe 7"			Lidhja me fushat kurikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Konkurs; Shpjegim i kombinuar me diskutim; Punë e pavarur; Diskutim.			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës:</p> <p>Në grupe, nxënësit formulojnë pyetje rreth sinonimeve dhe antonimeve, si dhe krijojnë çifte sinonimike dhe antonimike.</p> <p>Veprimet në situatë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në dërrasë. Në grupe, nxënësit formulojnë pyetje rreth sinonimeve dhe antonimeve, si dhe krijojnë çifte sinonimike dhe antonimike. 			

Konkurs: përfaqësues të grupeve u drejtojnë pyetje grupeve të tjera që kanë të bëjnë me njohuritë e marra në klasat e mëparshme për sinonimet dhe antonimet dhe të japin sinonime dhe antonime për fjalët e kërkuara.

- Mësuesi/ja drejton pyetjet:

Cilat janë mënyrat e formimit të sinonimeve?

- a. fjalë dialektore - fjalë dialektore, p.sh., çikë (gegërisht) – keçe (toskërisht);
- b. fjalë dialektore - fjalë e normës letrare, p.sh., laps - kalem;
- c. fjalë e normës letrare - fjalë e normës letrare, p.sh., vështroj - vërej;
- d. fjalë shqipe - fjalë e huaj, p.sh., i ndërgjegjshëm - koshient;
- e. fjalë e huaj - fjalë e huaj, p.sh., kozmonaut, astronaut.

- Shpjegon antonimet kontekstuale, të cilat dalin me kuptime të kundërta në një tekst të caktuar.

- Drejton pyetjen: Cila është vlera e sinonimeve dhe antonimeve? Thekson përdorimin e tyre në fjalor për të shpjeguar më saktë kuptimet e fjalëve.

Një nxënës lexon informacionin rreth homonimeve.

Mësuesi/ja shpjegon llojet e homonimisë:

- a) homonime - fjalë që shkruhen dhe lexohen njësoj, por që kanë kuptime të ndryshme (bar - ilaç, bar - bimë);
- b) homografe - fjalë që shkruhen njësoj, por që shqiptohen ndryshe (drej'tori, drejto'ri);
- c) homofone - fjalë që shkruhen ndryshe, por që lexohen njësoj (Këto fjalë janë më të rralla dhe përbëjnë shkelje të normës së drejtshqiptimit, p.sh. qepë, qep).

Nxënësit zhvillojnë ushtrimin 7 sipas kërkesës.

Veprimtari praktike

Në dyshe, nxënësit punojnë ushtrimet 1-6 sipas kërkesave.

Në përfundim, ushtrimet diskutohen me të gjithë klasën. Mësuesi/ja është i vëmendshëm që të aktivizojë sa më shumë nxënës.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë sinonimet, antonimet dhe homonimet; formojnë çifte sinonimike dhe antonimike; përdorin sinonimet, antonimet dhe homonimet.

Detyrë shtëpie: ushtrimi 8.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa:VII
Tema mësimore: Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja		Situata e të nxënit: Në grupe nxënësit nxënësit krijojnë fushën leksikore të fjalëve: sport, veshje, ushqime, teknologji, shkencë, mjekësi ku të përdoren sa më shumë fjalë të cilat ne i kemi huazuar nga gjuhët e tjera.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Nxënësi/ja: 1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera komunikimi; 2. lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës, me gojë ose me shkrim; 3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave të rinj (fjalëve, koncepteve) duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; 4. shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.) duke ndërvepruar në grup ose në klasë.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: 1. dallon fjalët e huaja; 2. i klasifikon ato sipas burimit; 3. i zëvendëson ato me fjalë shqip.			Fjalët kyçe: fjalë e huaj, huazim, burim, pasurim, varfërim.
Burimet: teksti " Gjuha shqipe 7 "			Lidhje me fushat kurrikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë, Shpjegim i kombinuar me diskutim, Punë e pavarur, Diskutim.			

Përshkrimi kontekstual i situatës:

Në grupe nxënësit nxënësit krijojnë fushën leksikore të fjalëve: sport, veshje, ushqime, teknologji, shkencë, mjekësi ku të përdoren sa më shumë fjalë të cilat ne i kemi huazuar nga gjuhët e tjera.

Veprimet në situatë:

-Mësuesi/ja prezanton temën e re të mësimit dhe e shkruan në dërrasë.

Në grupe nxënësit nxënësit krijojnë fushën leksikore të fjalëve: sport, veshje, ushqime, teknologji, shkencë, mjekësi ku të përdoren sa më shumë fjalë të cilat ne i kemi huazuar nga gjuhët e tjera.

Ndahet klasa në tri grupe:

Grupi I: sport, veshje;

Grupi II: ushqime, teknologji;

Grupi III: shkencë, mjekësi.

Përfaqësues nga çdo grup lexon fushat leksikore të krijuara, të cilat plotësohen nga pjesëtarë të grupeve të tjera.

- Mësuesi/ja drejton pyetjet:

- Ç'janë huazimet? Pse kanë hyrë ato në gjuhën shqipe?

Pushtimet, marrëdhëniet me fqinjët, lëvizja e popullsisë, zhvillimi ekonomik e shoqëror (futje e terminologjive dhe nocioneve të reja).

- Pse vitet e fundit vihet re një shtim i madh i fjalëve të huazuara në gjuhën shqipe?
- Kur huazimet janë pasurim i gjuhës dhe kur janë varfërim?

Mësuesi/ja shpjegon mësimin për huazimet.

Një nxënës lexon informacionin në libër rreth huazimeve dhe burimet.

Veprimtari praktike:

Në dyshe nxënësit punojnë ushtrimet 4 dhe 5 sipas kërkesave.

Në përfundim ushtrimet diskutohen me të gjithë klasën. Mësuesi/ja është i vëmendshëm që të aktivizojë sa më shumë nxënës.

Vlerësimi: Për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet, vlerësim i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar: kur nxënësit arrijnë të zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin; dallojnë huazimet; formojnë fushat leksikore të fjalëve të dhëna; zëvendësojnë huazimet me fjalë të shqipes; i klasifikojnë huazimet sipas burimit.

Detyrë shtëpie: Gjeni një artikull në gazetë, kopjojeni atë dhe listoni huazimet e përdorura.

Diktim

(Në këtë diktim trajtohen probleme të drejtshkrimit të fjalëve të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura, përdorimi i apostrofit, si dhe drejtshkrimi i diftongjeve.)

Vijat e tirqve të tyre ishin fare pranë vijave të tirqve të tij, gjarpërinj të zinj me kokat plot helm, që ishin gati të kafshonin. Në ecje e sipër, ato gati sa nuk prekeshin. Por ai ishte krejtësisht i qetë. Ishte i mbrojtur nga besa njëzetekatërorëshe më mirë se nga çdo frëngji kulle apo kështjelle. Tytat e pushkëve të tyre çoheshin drejt mbi xhokat e zeza, por tani për tani ato s'kishin të drejtë të shtinin mbi të. Nesër, pasnesër... ndoshta. Kurse, po të kërkonte katundi besën tridhjetëditëshe për të, atëherë do të kishte edhe katër javë jetë të qetë. Pastaj...


Një tytë maliheri, bënte ç'bënte, lëkundej si për t'u dalluar midis të tjerave, disa hapa përpara. Një tytë e shkurtër, shurdhane, ishte nga ana e majtë. Të tjera tyta përreth. Cila prej tyre do të... Në ndërgjegjen e tij, fjalët "do të më vrasë mua", në çastin e fundit, si për t'u lehtësuar pak, u shndërruan në "do të shtjerë mbi mua".

Rruga nga varreza gjer te shtëpia e të vvarit dukej e pafund. Dhe përpara ishte dreka e mortit, ku atë e priste një provë edhe më e vështirë. Do të ulej në tryezë bashkë me fisin e të vvarit, do t'i vinin bukë e do t'i hidhnin gjellë, do t'i vinin lugën përpara dhe ai duhej të hante.

Marrë nga "Prilli i thyer"

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “Zoga” N. Mjeda (ora e parë)		Situata e të nxënit: punë me tekstin	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë. Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: ❖ liston detaje që simbolizojnë ardhjen e stinës së pranverës; ❖ lexon me ndjenjë poezinë; ❖ interpreton dhe diskuton rreth poezive të autorëve të ndryshëm për stinën e pranverës.		Fjalët kyçe: pranverë, hare, rreze dielli, lule, dallëndyshe, blerim.	
Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, Poema “Andrra e jetës” N. Mjeda		Lidhja me fushat kurikulare: Histori	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Kllaster; Diskutim; Shkrim i lirë.			
Përshkrimi kontekstual i situatës Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Plotësim i petaleve të lules me detaje të ardhjes së stinës së pranverës.			
Ndërtimi i njohurive të reja Veprimet në situatë: - Diskutim rreth pyetjes: A ju pëlqen stina e pranverës? Jepni mendimin tuaj. - Prezantimi i poezisë.			

- Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e Mjedës.
- Interpretim i poezive të shkrimtarëve të ndryshëm për stinën e pranverës.

Reflektim mbi rezultatet e arritura

- Punimi i rubrikës “Të zbëthejmë tekstin”.

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: listojnë veçoritë e stinës së pranverës; shprehin idetë dhe mendimet e tyre gjatë analizës së poezisë dhe interpretojnë bukur vargje të autorëve të ndryshëm.

Detyrë shtëpie: Sillni në klasë të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e poetit.

Mësoni përmendsh vargjet dhe interpretojini ato me ndjenjë.

Planifikimi ditor (ditar)



Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “ Zoga” N. Mjeda (ora e dytë)		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p> <p>Kompetenca digjitale: Përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ diskuton rreth elementeve të metrikës që janë përdorur në fragment; ❖ analizon figurat letrare; ❖ interpreton me ndjenjë vargjet. 		<p>Fjalët kyç: analizë metrike, figura letrare.</p>	
<p>Burimet: teksti “Gjuha shqipe 7”, të dhëna mbi jetën dhe krijimtarinë e Mjedës</p>		<p>Lidhja me fushat kurikulare: Histori</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Kllaster; Diskutim; Shkrim i lirë.</p>			
<p>Përshkrimi kontekstual i situatës</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme Diskutim rreth figurës së Ndre Mjedës, si: poet, gjuhëtar, folklorist, politikan.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja Veprimet në situatë: - Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë e Mjedës. - Interpretimi i poezisë nga disa nxënës. - Punimi i rubrikës “Gjuha dhe stili”:</p>			

- 1 - strofat janë katërvargëshe,
- rima e kryqëzuar ABAB,
- vargu tetërokësh mbisundon,

2 - Figurat letrare:

- dallëndyshet pors i era – krahasim,
- pranvera thërret – metaforë,
- pemët kanë endun lule – metaforë,
- është vesh fusha me blerim – metaforë,
- erë akullit mizore – personifikim.

Reflektim mbi rezultatet e arritura

- Shkruani një poezi me dy strofa katërvargëshe dhe rimë të përputhur për stinën e pranverës.

Lexohen poezitë duke bërë dhe vlerësimet për njëri-tjetrin

Vlerësimi i orës:

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar kur nxënësit arrijnë të: zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përshkruar stinën e pranverës; shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre gjatë shkrimit; përdorin figurat letrare të mësuara.

Detyrë shtëpie: Krahasoni poezinë që shkruajtet për stinën e pranverës me një pikturë.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “Kronikë në gur” I. Kadare ora parë e mësimin		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. lexon me kujdes tregimin dhe kupton përmbajtjen; 2. dallon kuptimin e parë e të figurshëm të fjalëve të përdorura; 3. shpjegon kuptimin e titullit duke nxjerrë arsyet pse është e vështirë të ishe fëmijë në këtë qytet; 4. analizon strukturën e tregimit në aspektin ideor. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>kronikë, histori, luftë, fëmijëri, vendlindje, qytet.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, romani “Kronikë në gur”, Ismail Kadare, hartë gjeografike, pamje nga qyteti i Gjirokastrës etj.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lexim me pyetje; Diskutimi; Punë në çift.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I: Mësuesi/ja shkruan në tabelë skedën e mëposhtme mbi autorin e veprës.

Titulli i romanit: “Kronikë në gur”.

Autori: Ismail Kadare.

Jeta: Lindi më 1936 në Gjirokastrë.

Një ndër shkrimtarët bashkëkohorë shqiptarë.

Poema: “Gurghendësit”, “Princesha Argjiro”.

Prozë: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kështjella”.

Tipar i krijimtarisë: veprat e tij i përshkon mesazhi i origjinës së lashtë dhe i traditave të pasura shqiptare.

Hapi II: Lexohet teksti nga mësuesi/ja për të përcjellë sa më mirë te nxënësit emocionet dhe idetë që mbart ai. Ndjenjat e emocionet e autorit lexohen me intonacion dhe rrjedhshëm për ta futur nxënësin në botën e fantazisë. Mësuesi/ja i fton nxënësit të jenë të vëmendshëm, sepse do të diskutojnë mbi titullin e romanit dhe të fragmentit.

Hapi III: Ushtrimet mbi përmbajtjen. Nxënësit punojnë në çift. Secili çift lexon jo më shumë se 4 fjali dhe më pas diskutojnë çdo paragraf të tekstit. Nxënësi i parë lexon me kujdes paragrafët, ndërsa tjetri bën pyetje rreth tij.

Sugjerim: Orientohen nxënësit rreth çështjeve për të cilat do të pyesin gjatë këtij ushtrimi.

- Cilin qytet përshkruan autori?
- Përse ky qytet duket i çuditshëm?
- Ç’përshtypje u bënte udhëtarëve që e shikonin për herë të parë?

Nxënësi i dytë përgjigjet. Të dy nxënësit duhet të përpiqen që çdo pyetje të marrë përgjigjen më të përshtatshme. Bashkërisht nxjerrin fjali përmbledhëse për çdo paragraf. Kështu vazhdohet deri në fund të tekstit. Mësuesi/ja ndërhyr nëse e shikon të nevojshme.

Hapi IV: Ushtrime mbi interpretimin e tekstit. Nxënësit punojnë me tekstin duke shpjeguar kuptimet e fjalive dhe të fjalëve të figurshme. Nxënësit komentojnë paragrafët që përshkruajnë qytetin në mënyrë të figurshme. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të mendojnë me imagjinatë dhe të flasin rreth idesë së krijuar pas leximit të fragmentit.

Në fund, mësuesi/ja bën vlerësimin e orës së mësimi.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst me temë: “Qyteti i ëndrrave të mia”.

Planifikimi ditor (ditar)

____/____/____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: “Kronikë në gur” I. Kadare ora dytë e mësimit		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. pëcakton fjalët kyç me të cilën autori përshkruan qytetin dhe i ndan ato në klasa të fjalëve; 2. nënvizon figurat letrare dhe bën zbërthimin stilistikor të tyre; 3. shpjegon kuptimet e fihurshme të fjalëve dhe fjalive; 4. analizon gjuhën e përdorur në tekst duke listuar karakteristikat e stilit letrar të shkrimtarit. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>kronikë, histori, luftë, fëmijëri, vendlindje, qytet.</p>
<p>Burimet: teksti “Gjuhë shqipe 7”, romani “Kronikë në gur”, hartë gjeografike, pamje nga qyteti i Gjirokastrës etj.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; Rrjeti semantik; Krahasim.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I: Ora e parë e mësimi fillon me shfaqjen në videoprojektor të pamjes të qytetit të Gjirokastrës. Mësuesi/ja i fton nxënësit të flasin rreth pamjeve dhe të bëjnë një krahasim midis dy planeve. Të lexuarit në tekst dhe të mënyrës së përshkrimit nga autori dhe të pamjeve vizuale të para në videoprojektor. Nxënësit diskutojnë edhe mbi pritshmëritë që kanë nga leximi i romanit.

Hapi II: Ushtrime “gjuha dhe stili”

Ushtrim. Nxënësit lidhin me shigjetë fjalët që kanë lidhje me epitetin, krahasimin. Shpjegojnë kuptimin e tyre.

Ushtrim. Kontrasti në fjalinë: “... Nën ato korraca të forta, gjëllonte dhe përtërihej mishi i butë i jetës”, realizohet me antitezën. Ky ushtrim realizohet përmes rrjetit semantik të antitezës.

Hapi III: Ushtrim. Mësuesi/ja iu kërkon nxënësve të rikthehen në tekst dhe të nënvizojnë fjalët kyç me të cilët autori përshkruan lashtësinë dhe veçantinë e qytetit.

Ushtrim. Nxënësi liston fjalët me kuptime të figurshme, i evidenton nga teksti dhe me ndihmën e fjalorit të Gjuhës së sotme shqipe bën shpjegimin e tyre. Por është e rëndësishme që nxënësit t’i vendosin këto fjalë në kontekstin e përmbajtjes së veprës.

Hapi IV: Nxënësi liston disa fjalë të figurshme si: qenie prehistorike, kacavjerrur, gjëllonte, dhe gjen kuptimin e parë të fjalëve.

Hapi V: Mësuesi/ja bën vlerësimin e orës së mësimi.

Vlerësimi: Për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Gjenerat figurat letrare që keni mësuar.

Planifikimi ditor (ditar) _____/_____/_____

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Njoftime Teksti jo letrar		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngre në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon fjalën njoftim. - Liston karakteristikat e tekstit të njoftimeve. - Dallon përdorimin e gjuhës dhe të terminologjisë, shkruan njoftime duke zbatuar strukturën. - Identifikon në tekst elementet e strukturës së kronikës. - Zbërthen elementet e komunikimit. - Analizon tekstin në formë dhe përmbajtje. 			<p>Fjalët kyç: njoftime, strukturë, përmbajtje, elemente komunikimi.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor, materiale nga interneti, njoftime të ndryshme, skeda, fletore, hartë gjeografike.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Orgazinues grafik; Përkufizojmë konceptet; Diskutim.</p>			

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I: Mësuesi/ja lexon tekstin. Në fund të leximit shkruan në tabelë fjalën njoftim. Jep informacion mbi tekstin joletrar. Shkruan elementet përbërës të tekstit dhe diskuton rreth tyre.

Hapi II: Mësuesi/ja i fton nxënësit të lexojnë tekstin në libër dhe të nxjerrin karakteristikat e tij. Në vazhdimësi, mësuesi/ja ndan klasën në grupe.

Grupi I - Nxënësit punojnë mbi përmbajtjen e tekstit.

Grupi II - Nxënësi punojnë mbi strukturën e tekstit mbi elementet përbërës të saj: hyrje - zhvillim – mbyllje.

Grupi III - Nxënësit punojnë mbi skemën e komunikimit. Elementet përbërës të skemës së komunikimit janë:

dhënësi, kodi, kanali, referenti, mesazhi, marrësi.

Secili grup prezanton punën e tij. Mësuesi/ja dëgjon me vëmendje përgjigjet e nxënësit dhe i udhëheq ato duke plotësuar çdo pëgjigje me informacione shtesë mbi njoftimet. Përgëzon punën e nxënësve në grupe.

Hapi III: Udhëzohen nxënësit të shikojnë hartën gjeografike të Shqipërisë. Secili përzgjedh qytetin e tij të lindjes. Në fletore, nxënësi shkruan njoftime mbi aktivitetet artistike dhe sportive që zhvillohen në vendlindjen e tij. Nxënësit i prezantojnë në klasë dhe diskutojnë rreth tyre.

Hapi IV: Me anë të organizuesit grafik, nxënësit punojnë në kompjuter për të ngritur një forum në internet me temë: “Fëmijë, talente të reja. Kosova dhe Shqipëria, e ardhmja e tyre”.

Nxënësit në këtë adresë postojnë njoftimet mbi zhvillimin e aktiviteteve që ata kryejnë në shkollë dhe jashtë saj. Mësuesi/ja përfshin të gjithë nxënësit në këtë nismë dhe kërkon nga ata monitorimin e mesazheve. Mësuesi/ja vlerëson nxënësit aktiv, motivon ata nxënës që sollën ide inovative mbi përdorimin e internetit.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Sillni në klasë njoftime nga gazetatat, diskutoni rreth përmbajtjes dhe strukturës së ndërtimit të tyre.

Fusha: Gjuha dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema mësimore: Ftesa Tekst joletrar		Situata e të nxënit: Punë me tekstin	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç</p> <p>Kompetenca e të menduarit: Jep përgjigje për një hipotezë që mësuesi/ja ngrë në klasë nëpërmjet një pyetjeje.</p> <p>Kompetenca e të nxënit: Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.</p> <p>Kompetenca qytetare: Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Liston karakteristikat e tekstit të ftesave. - Dallon llojet e ftesave në formë dhe përmbajtje. - Zbërthen elementet e tekstit joletrar. - Përcakton forma dhe mënyra të të shkruarit të ftesave. - Analizon gjuhën e përdorur dhe strukturën e ftesës. 			<p>Fjalët kyç:</p> <p>ftesa, përmbajtje, struktura, modele ftesash etj.</p>
<p>Burimet: teksti mësimor “Gjuha Shqipe 7”, tabakë letre, modele ftesash, tabela, materiale nga interneti, videoprojektor, ngjyra.</p>			<p>Lidhja me fushat kurikulare:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Veprimtari e drejtuar; Leximi me kodim teksti; Pema e mendimit.</p>			

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I: Kujtojmë modele ftesash të marra personalisht dhe mësuesi/ja drejton nxënësit të shikojnë në videoprojektor, duke komentuar mbi pamjet dhe modelet e ftesave që jepen aty. Njëkohësisht, nxënësve u drejtohen pyetjet: A keni marrë ftesa ju personalisht apo familja juaj?

- Si ishte e formular, pra cila ishte përmbajtja e saj?

- Çfarë forme kishte ajo?

- Po nga ana disenjatore, çfarë ju ka bërë përshtypje?

- Po nga modelet që shikoni në videoprojektor, çfarë ju pëlqen më shumë? Mësuesi/ja dëgjon me vëmendje përgjigjet e nxënësve. I përgëzon për njohuritë që nxënësit kanë marrë në mënyrë individuale. Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i paraqet në mënyrë të përmbledhura në pemën e mendimit. **FTESA** => qëllimi, lloji, struktura, drejtshkrimi, gjuha e përdorur përmbajtja, tematika.

Hapi II: Ndërtimi i njohurive: (Lexim me kodim teksti)

Përpara fillimit të kësaj veprimtarie mësimore, mësuesi/ja vendos në tabelë një tabak të bardhë letre, ku është shkruar informacioni që nxënësit gjejnë në tekstin e ftesës (Në pamundësi, mësuesi/ja e shkruan atë në tabelë.).

- Çfarë informacioni përmban ftesa?

- Cila është struktura e ftesës (hyrja - zhvillimi - mbyllja)? Çfarë fjalësh shkruhen te hyrja, te zhvillimi dhe te mbyllja?

- Cila është përmbajtja e ftesës?

- Përcaktoni llojin e ftesës etj.

Mësuesi/ja shpjegon me kujdes çdo informacion që ka lidhje me ftesën.

Hapi III: Mësuesi/ja i vendos nxënësit të lexojnë përmbajtjen e tekstit të ftesës dhe të shënojnë me laps për çdo informacion që kërkojnë.

Hapi IV: Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të bëjnë një tabelë, ku të nxjerrin elementet e strukturës së ftesës.

Nxënësi plotëson elementet se si shkruhet një ftesë. Më pas realizon një model ftese.

Hapi V: Mësuesi/ja dëgjon punën që është bërë nga nxënësit dhe kërkon që të shkruajnë modele ftesash të llojeve të ndryshme, duke respektuar strukturën, përmbajtjen dhe gjuhën.

Mësuesi/ja bën vlerësimin e nxënësit dhe motivon nxënësin aktiv gjatë orës së mësimi.

Vlerësimi: për përgjigjet në grup, punën e pavarur, diskutimet; vlerësimi i punës së grupeve nga njëri-tjetri.

Vlerësimi i situatës

Detyrë shtëpie: Ushtrime nga teksti mësimor.

TEST

TREMUJORI I

Emër Mbiemër _____

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: VII

Lexo me vëmendje tekstin:

Gjakmarrja po i zinte frymën fshatit, madje gjithë krahinës. Zakoni e ruante, armiku e nxiste. Një e keqe e kobshme që merrte jetë njerëzish ndillte zi e siguri.

- Jemi shqiptarë, jemi vëllezër, - u hodh e tha një i mençur.

-Ta ruajmë jetën, ta shtojmë fisin... Pushkën veç për armikun! E dëgjuan burrat në kuvend. Luajtën vendit. Nuk ishte e lehtë. Zakoni e kërkonte që gjaku të lahej me gjak.

- Kush është burrë, le ta tregojë burrërinë! – tha prapë i mençuri. U ngritën të gjithë në këmbë. Se të gjithë ishin burra dhe, po të ishte për të marrë hak, askush nuk frikësohej.

-Jo, - tha prapë i mençuri, - më burrni ka ai që e fal gjakun se ai që e merr! Kuvendi lëvizi. Burrat ranë në mendime. Ishte diçka e rëndë, e paparë, e padëgjuar ...Ndofta një turp!

- Unë e fal gjakun! – guxoi e i tha kryetari i një familje të madhe, të nderuar. Të tjerët heshtën. Rrudhën ballin e përzhitur. Kaluan sekonda, minuta ... Qetësi varri në dukje, zierje përbrenda.

- Pushka ime veç për armikun! - theu heshtjen një tjetër. Edhe unë e fal gjakun.

- Edhe unë ! Edhe unë!...Edhe unë! Folën burrat me radhë dhe i dhanë dorën njëri-tjetrit, i dhanë besën, i falën gjaqet, u bashkuan grusht, si shqiptarë e vëllezër.

Bardhyl Xhamo

1. Shkruaj një titull të figurshëm për tekstin e mësipërm. 2 pikë

2. Listo tri cilësi të shqiptarit që dalin në pjesën e mësipërme:

a. _____ b _____ c _____

3 pikë

3 - Shkruaj shkurt si e përfytyron gjendjen pas marrjes së vendimit për faljen e gjakut:

3 pikë

4 - Armiku e nxiste gjakmarrjen. Pse? Jepni gjykimin tuaj

2 pikë

- 5 - Identifiko të paktën dy figura letrare në tekstin e mësipërm. 2 pikë
- 5 - Trego klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalitë e mëposhtme: 3 pikë
- a - Aty, zënim e gjuanim **me** gurë _____
- b - Më shtrëngoi **fort** pas vetes _____
- c - Genci na kishte shpikur **edhe** një lojë _____
- 6 - Formo me fjalën rrugë fjalë të prejardhura me prapashtesë:
emër _____ 2 pikë
mbiemër _____
- 7 - Shkruaj trajtën e pashquar të emrit:
barku _____ 1 pikë
- 8 - Trego rasën dhe lakimin e emrit të nënvizuar:
E vuri në frigorifer **pulën.** 2 pikë
- a - rasa _____ b - lakimi _____
- 9 - Gjej shkallën e mbiemrit të fjalës e mëposhtme:
Ai ishte më i gjatë se moshatarët. _____ 1 pikë
- 10 - Shkruaj shumësin e grupit emëror:
fik i egër _____ 1 pikë
- 11 - Përcakto llojin e përemrave të nënvizuara në fjalitë e mëposhtme:
a -Për **mua** nuk ishte problem kjo punë _____ 2 pikë
b - **Ç'**do këtu? _____
- 12 - Përcakto gjininë e emrave të mëposhtëm:

TEST

TREMUJORI II

Beteja e Çanslësvillit

Beteja e Çanslësvillit, një nga betejat më të famshme të Luftës Civile, u zhvillua në Virxhinia në pranverë të vitit 1863. Për muaj me radhë, të dyja ushtritë përgjonin njëra-tjetrën në të dyja anët e brigjeve të një lumi të ngushtë. Trupat e Konfederatës udhëhiqeshin nga strategu ushtarak, ndoshta më i nderuari në historinë amerikane, gjenerali Robert E. Lee. Ushtarët e Unionit udhëhiqeshin nga Joe Hooker "Luftaraku".

Nga pamja, personaliteti dhe mënyra e jetesës, këta burra ishin pothuajse krejtësisht të kundërt.

Lee, një burrë i vjetër me shëndet të dobët, me një mjekër gri, kishte një sjellje të matur, të zymtë.

Hooker ishte një i ri flokëverdhe, trupmadh, krenaria e të cilit mbi paraqitjen përbënte vetëm një anë të egoizmit të tij. Ndërsa Lee ishte i përkushtuar dhe parimor, Hooker ishte i njohur për argëtimet.

Pavarësisht nga fakti se ushtria e Konfederatës kishte fituar katër betejat e mëdha të fundit dhe ushtarët e Unionit ishin të uritur, të lodhur dhe të demoralizuar, Hooker thërriste: "Planet e mia janë të përsosura. Dhe, kur unë të filloj t'i zbatoj ato, Zoti pastë mëshirë për Bobby Lee, sepse unë nuk do të kem." Çfarë e bënte Hooker-in që, përveç prirjes së tij narcisizte, të ishte aq i sigurt?

Hooker kishte përdorur spiunë, analistë, dhe madje, edhe balona me ajër të nxehtë për të grumbulluar një sasi të madhe informatash rreth ushtrisë së Lee. Ai kishte vënë re, për shembull, se Lee kishte vetëm 61 000 ushtarë kundrejt 134 000 ushtarëve të Hooker-it. I nxitur nga superioriteti i tij në numër, Hooker fshehurazi zhvendosi 70 000 nga njerëzit e tij pesëmbëdhjetë milje lart përtej lumit dhe pastaj i urdhëroi ata që të shkonin përsëri poshtë fshehurazi, për t'u pozicionuar pas ushtrisë së Lee. Në fakt, Hooker i kishte rrethuar ushtarët aleatë para dhe prapa. Ata ishin në kurth. I kënaqur me avantazhin e tij, Hooker u bind se e vetmja rrugë që i mbetej Lee-së ishte të tërhiqej në Riçmond, duke i siguruar një fitore Unionit. Megjithatë, Lee, pavarësisht nga disavantazhet e tij, si në numër dhe në vendndodhje, nuk u tërhoq. Në vend të kësaj, ai zhvendosi trupat e tij në pozicion për të sulmuar. Ushtarët e Unionit, që u përpoqën ta paralajmëronin Hooker-in se Lee ishte hedhur në sulm, u dëbuan si frikacakë. Duke qenë i bindur se Lee nuk kishte zgjidhje, por vetëm të tërhiqej, Hooker filloi të injorojë realitetin. Kur ushtria e Lee-së sulmoi ushtrinë e Unionit në 5:00 të mbrëmjes, ata ishin duke ngrënë darkë, krejtësisht të papërgatitur për luftë. Kur trupat e Lee-së u sulën duke bërë titur, me bajoneta të nxjerra, ata braktisën pushkët e tyre dhe ikën me vrap. Kundër të gjitha gjasave, Lee fitoi betejën e Çanslësvillit, ndërsa forcat Hookerit u tërhoqën me disfatë.

Pyetjet e leximit:

1) Duke u bazuar në këtë pjesë, mund të arrihet në përfundimin se Hooker e humbi Betejën e Çanslësvillit

kryesisht për shkak të: (1 pikë)

A. mendjemadhësisë; B. vetëbesimit të tepruar;

C. informacioneve të gabuara; D. veseve.

Ilustro me detaje nga teksti. (2 pikë)

2) Në paragrafin 3, autori citon Hooker-in kur thotë: "Planet e mia janë të përsosura. Dhe, kur unë të filloj t'i zbatoj ato, Zoti pastë mëshirë për Bobby Lee, sepse unë nuk do të kem.". Autori e përfshin këtë thënie me qëllim që:

A. të demonstrojë besimin e Hooker-it në pagabueshmërinë e tij;

B. të tregojë se Hooker ishte një njeri thellësisht fetar, pavarësisht nga mënyra e tij e jetesës;

C. të parashikojë humbjen e Hooker-it;

D. të portretizojë Hooker-in si një gjeneral i pamëshirshëm, i cili ishte nxitur nga urrejtja e tij për Lee-në.

(1 pikë)

3) Sipas autorit, avantazhet e Hooker-it në Betejën e Çanslësvillit përfshinin: I. numrin e ushtarëve; II. pozicionin; III. strategjinë. (1 pikë)

A. vetëm I

B. vetëm II

C. vetëm I dhe II

D. vetëm II dhe III

E. I, II, dhe III

4) Teksti i mësipërm është pjesë e një: (1 pikë)

A. tregimi;

B. eseje;

C. studimi historik;

D. komenti.

5) Gjej disa detaje në tekst që i përkasin këtij lloj teksti. (2 pikë)

6) Bazuar në përdorimin e saj në paragrafin 3, mund të kuptohet që fjala prirje i përket grupeve të mëposhtme të fjalëve: (1 pikë)

A. pëlqim, njëanësi, dashuri;

- B. e metë, faj, dobësi;
- C. tendencë, anim, predispozitë;
- D. vetëbesim, vetësiguri, bindje.

7) Në paragrafin e dytë gjej detaje që paraqesin kontrastin mes dy komandantëve ushtarakë

(2 pikë)

Lee: _____

Hooker: _____

8) Shprehe fjalinë në një mënyrë tjetër duke e ruajtur kuptimin e saj: I nxitur nga superioriteti i tij në numër, Hooker fshehurazi zhvendosi 70 000 nga njerëzit e tij pesëmbëdhjetë milje lart përtej lumit ...

(2 pikë)

9) Bazuar në informacionin e marrë nga kjo pjesë, përmblihdh me 5 fjali ngjarjet e Betejës së Çanslësvillit.

(5 pikë)

10) Nëse do të kishe qenë ti në pozicionin e Hooker-it, çfarë do të kishe bërë ndryshe gjatë betejës së Çanslësvillit? A do të kishe marrë të njëjtat vendime? Nëso po, pse? Pse jo?

(2 pikë)

11) Çfarë mendon se ndodhi me Hooker-in pas disfatës (humbjes) së tij në Çanslësvilli? Argumento përgjigjen tënde.

(2 pikë)

Pyetjet e gjuhës:

1. Përcakto grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit. (2 pikë)

Beteja e Çanslësvillit u zhvillua në Virxhinia në pranverë të vitit 1863.

GE i kryefjalës _____

GF _____

2. Në fjalinë e dhënë, analizo grupin emëror.

Planet e mia janë të përsosura.

(5 pikë)

A. Grupi emëror _____

B. Emri bërthamë _____

C. Përcaktori _____

D. Me çfarë shprehet _____

3. Përcakto funksionin e gjymtyrëve të nënvizuara. Përcakto me se shprehen.

(6 pikë)

Për muaj me radhë, të dyja ushtritë përgjonin njëra-tjetrën në të dyja anët e brigjeve të një lumi të ngushtë. Kundër të gjitha gjasave, Lee fitoi Betejën e Çanslësvillit dhe forcat Hooker-it u tërhoqën me disfatë. Hooker filloi të injorojë realitetin.

Për muaj me radhë _____, në të dyja anët e brigjeve të një lumi të ngushtë _____,

të dyja ushtritë _____, Betejën e Çanslësvillit _____,

me disfatë _____, filloi të injorojë _____.

4. Dallo lidhëzat dhe përcakto llojin.

(3 pikë)

"Planet e mia janë të përsosura. Dhe kur unë të filloj t'i zbatoj ato, Zoti pastë mëshirë për Bobby Lee, sepse unë nuk do të kem."

a. _____ b. _____ c. _____

5. Kthe fjalinë nga ligjërata e drejtë në ligjëratën e zhdrejtë:

(2 pikë)

Nesër do të studioj përsëri hartat dhe do të bëj planin konkret për turneun e dytë, - tha gjenerali.

Pikët	1 - 9	10 - 15	16 - 20	21 - 25	26 - 30	31 - 35	36 - 40
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Përgjigjet e testit

Pyetjet e leximit:

1. B

a. Hooker thërriste: "Planet e mia janë të përsosura. Dhe, kur unë të filloj t'i zbatoj ato, Zoti pastë mëshirë për Bobby Lee, sepse unë nuk do të kem."

b. Ushtarët e Unionit, që u përpoqën ta paralajmëronin Hooker-in se Lee ishte hedhur në sulm, u dëbuan si frikacakë. Duke qenë i bindur se Lee nuk kishte zgjidhje, por vetëm të tërhiqej, Hooker filloi të injorojë realitetin.

2. A

3. C

4. C

5. Personazhet realë, përdorimi i gjuhës së fakteve, numrat, emërtimet gjeografike, përdorimi i fjalive të gjata me shprehje parafjalore, lidhëzore.

6. C

7. Lee, një burrë i vjetër, me shëndet të dobët, me një mjekër gri, kishte një sjellje të matur, të zyrtë. Lee ishte i përkushtuar dhe parimor

Hooker ishte një i ri flokëverdhtë, trupmadh, krenaria e të cilit mbi paraqitjen përbënte vetëm një anë të egoizmit të tij.

Hooker ishte i njohur për argëtimet.

Pyetjet e gjuhës:

1. Grupi emëror i kryefjalës: Beteja e Çanslësvillit.

Grupi foljor i kallëzuesit: u zhvillua në Virxhinia në pranverë të vitit 1863.

2. Planet e mia: emri bërthamë - planet; përcaktori - e mia; përemër pronor.

3. Rrethanosie; rrethanosie vendi; kryefjalë; kundrinor i drejtë; rrethanosie mënyre; kallëzues foljor i përbërë.

4. dhe - lidhëz bashkërenditëse shtuese

kur - lidhëz nënrenditëse kohore

sepse - lidhëz nënrenditëse shkakore

5. Gjenerali tha se të nesërmen do të studionte përsëri hartat dhe do të bënte planin konkret për turneun e dytë.

TEST

TREMUJORI III

Shiu i verës

Ditët më të këqija në çdo verë janë ato me shi. Ne e kalojmë gjithë vitin duke pritur me padurim kohën e mirë me ditë të gjata e të nxehta. Gjatë gjithë dimrit, me ditët e tij të zymta, gri dhe të ftohtin e hidhur, ne ëndërrojmë për ato ditët pa fund në plazh, shtrirë në rërë, duke u zhytur në diellin e ndritshëm, përvëlues. Vera vjen, dhe bie shi.

Kur isha fëmijë zgjohesha në ato ditët e verës me shi dhe më vinte për të qarë. Nuk ishte aspak e drejtë. Ne torturoheshim në muajt e shkollës me motin e mjerueshëm për ato dhjetë javë të lirisë dhe motit të butë. Çdo ditë, që nuk mund ta kaloja në plazh apo duke luajtur top me shokët e mi, më dukej si një ndëshkim për diçka që nuk e kisha bërë.

Në ato ditë verore me shi, nuk kishte asgjë tërheqëse për të bërë dhe do të ulesha brenda duke ia ngulur sytë shiut si një jetim dikensian. Isha fëmijë i vetëm, kështu që nuk kisha me kë të luaja. Babai e bënte punën e tij nga shtëpia, prandaj nuk isha me të vërtetë i vetëm, por ai nuk mund të luante me mua, sepse teknikisht ishte në punë. Ishin ato ditë kur do t'ia dorëzoja veten gjithçkaje që ishte në televizor ose çfarëdo libri që do të gjeja nëpër shtëpi. Zvarritesha gjithë ditën dhe natën lutesha që, kur të zgjoha të nesërmen, shiu nuk do të ishte më.

Si një i rritur, megjithatë, mendimi im për shiun e verës ka ndryshuar. Kur të duhet të punosh çdo ditë, vera nuk pritet më me padurim. Kryesisht, ditët vrapojnë së bashku, duke u gjakosur me njëra-tjetrën, kështu që ato nuk janë të veçanta, por ndihen si një ditë e njëjtë, e gjatë, e vazhdueshme. Çdo gjë duket monotone dhe e ngathtë, dhe mërzia e apatia zënë vend. Çdo ndryshim i motit të gëzon. E kalojmë dimrin duke ëndërruar për verën dhe verën duke ëndërruar për dimrin. Kur vjen vera, unë ankojem për vapën. Dhe atëherë, unë mezi e pres shiun, sepse shiu sjell me vete freskinë, e cila ofron anulimin- pa dyshim që për një kohë shumë të shkurtër- e torturës prej temperaturës 36° dhe ditët e lagështa. Ditët me shi vazhdojnë të jenë ditët më të këqija të verës, por shiu i verës sot, do të thotë një mot i bukur dhe më i freskët nesër.

Pyetjet e leximit:

1) Në pjesë përdoret një gjuhë që është: (1 pikë)

- A. metaforike;
- B. bisedore;
- C. zyrtare;
- D. e studimeve.

Ilustro me detaje nga teksti. (2 pikë)

2) Sipas kësaj pjese, vera është ndryshe për të rriturit, sepse: (1 pikë)

- A. shiu sjell temperatura më të ulëta për ditët pasardhëse;
- B. moti është më i ngrohtë sesa ishte në kohën e fëmijërisë;
- C. ata nuk marrin shumë ditë pushime nga puna gjatë stinës së verës;
- D. ata dinë se si ta mbushin më mirë ditën.

3) Sipas kësaj pjese, cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë për tregimtarin kur ishte fëmijë?

(1 pikë)

- A. Ai mërzhitej shpesh në ditët e verës.
- B. Ai preferonte motin më të frekët.
- C. Ai pëlqente të rrinte brenda.
- D. Ai nuk kishte vëllezër ose motra.

4) Duke krahasuar me kohën kur rrëfimtari ishte një fëmijë, si një i rritur ai është: (1 pikë)

- A. më realist;
- B. emocionohet më pak;
- C. më idealist;
- D. më pak i qetë.

5) Gjej dy epitete të përdorura në paragrafin e katërt. (2 pikë)

5) Në paragrafin e fundit, fjala anulimin përdoret me kuptimin: (1 pikë)

- A. një konkluzion përfundimtar;
- B. një vazhdim i shkurtër;
- C. një nivel më i lartë i dhimbjes;
- D. një pushim i përkohshëm.

6) Autori i kësaj pjese përshkruan ndjenjat e tij për shiun e ditëve të verës. Në përgjithësi, si ndihesh në ditë të tilla? A je dakord me mendimin e autorit, apo nuk e ke problem një mot të tillë? Përshkruaj shkurt mendimin tënd.

(2 pikë)

7) Në paragrafin 4, autori përshkruan pse ai nuk e pret më verën me aq me padurim si në kohën e fëmijërisë. Çfarë mendon se ka ndryshuar? A mendon se dhe ti do të ndihesh njësoj një ditë? Pse? (2 pikë)

8) Autori shkruan në paragrafin 4 se ai "e kalon dimrin duke ëndërruar për verën dhe verën duke ëndërruar për dimrin". Në anën tjetër, shumë njerëz do të thonin se kanë një stinë të preferuar. Si ndihesh ti? A ke një stinë të preferuar, apo gjithmonë pret me kënaqësi çdo stinë që vjen? Pse? (2 pikë)

Pyetjet e gjuhës:

1. Dallo nëse fjalitë janë të thjeshta ose të përbëra: (4 pikë)

A. Si një i rritur, megjithatë, mendimi im për shiun e verës ka ndryshuar. _____

B. Kur isha fëmijë, zgjohesha në ato ditët e verës me shi dhe më vinte për të qarë.

C. Çdo gjë duket monotone dhe e ngathtë, dhe mërzia e apatia zënë vend. _____

D. Ne e kalojmë gjithë vitin duke pritur me padurim kohën e mirë me ditë të gjata e të nxehta.

2. Ndaj fjalinë. Emërto llojin e pjesëve (4 pikë)

Babai e bënte punën e tij nga shtëpia, prandaj nuk isha me të vërtetë i vetëm, por ai nuk mund të luante me mua, sepse teknikisht ishte në punë.

Pjesa

I _____

Pjesa

II _____

Pjesa

III _____

Pjesa

IV _____

3. Përcakto pjesët përbërëse të fjalës tërheqëse. (6 pikë)

tema _____, mbaresa _____, tema fjalëformuese _____,

parashtesa _____, prapashtesa _____,

rrënja _____.

4. Shkruaj tri fjalë që i përkasin familjes së fjalës vrap. (3 pikë)

5. Gjej një çift antonimik në paragrafin e dytë. (1 pikë)

6. Gjej një çift sinonimik në paragrafin e fundit. (1 pikë)

7. Cilës fushë leksikore i përkasin fjalët: (1 pikë)

e zyrtë, gri, të ftohtin, temperaturë, ditë të lagështa? _____

Pikët	1 - 8	9 - 13	14 - 18	19 - 23	24 - 27	28 - 31	32 - 35
Nota	4	5	6	7	8	9	10

PËRGJIGJET E TESTIT

TREMUJORI III

Pyetjet e leximit:

1) Në pjesë përdoret një gjuhë që është: (1 pikë)

A. metaforike

Ilustro me detaje nga teksti. (2 pikë)

Kryesisht, ditët vrapojnë së bashku, duke u gjakosur me njëra-tjetrën; duke u zhytur në diellin e ndritshëm, përvëlues; motin e mjerueshëm; ditët e tij të zymta; do t'ia dorëzoja veten gjithçkaje që ishte në televizor.

2) Sipas kësaj pjese, vera është ndryshe për të rriturit, sepse: (1 pikë)

C. ata nuk marrin shumë ditë pushime nga puna gjatë stinës së verës;

3) Sipas kësaj pjese, cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë për tregimtarin kur ishte fëmijë? (1 pikë)

D. Ai nuk kishte vëllezër ose motra.

4) Duke krahasuar me kohën kur rrëfimtari ishte një fëmijë, si një i rritur ai është: (1 pikë) A. më realist;

5) Gjej dy epitete të pardorura në paragrafin e katërt. (2 pikë)

e gjatë, e vazhdueshme, më e keqe, i bukur, i freskët.

5) Në paragrafin e fundit, fjala anulimin përdoret me kuptimin: (1 pikë)

D. një pushim i përkohshëm.

Pyetjet e gjuhës:

1. Dallo nëse fjalitë janë të thjeshta ose të përbëra: (4 pikë)

A. e thjeshtë

B. e përbërë

C. e përbërë

D. e thjeshtë

2. Ndaj fjalinë. Emërto llojin e pjesëve. (4 pikë)

Babai e bënte punën e tij nga shtëpia, **prandaj** nuk isha me të vërtetë i vetëm, **por** ai nuk mund të luante me mua, **sepse** teknikisht ishte në punë.

Pjesa I - pjesa kryesore

Pjesa II - pjesë e bashkërenditur përmbyllëse

Pjesa III - pjesë e bashkërenditur kundërshtore

Pjesa IV - pjesë e nënrenditur shkakore

3. Përcakto pjesët përbërëse të fjalës tërheqëse. (6 pikë)

tema-tërheqës; mbaresa-; tema fjalëformuese-tërheq; prapashtesa-ës; rrënja-heq.

4. Jep tri fjalë që i përkasin familjes së fjalës vrap. (3 pikë)

vrapoj vrapim vrapues

5. Gjej një çift antonimik në paragrafin e dytë. (1 pikë)

mot i mjerueshëm - mot i butë

6. Gjej një çift sinonimik në paragrafin e fundit. (1 pikë)

ditë e lagësht - ditë me shi

7. Cilës fushë leksikore i përkasin fjalët: (1 pikë)

kushte të motit ose një përgjigje tjetër që ka të bëjë me motin

Pikët	1 - 8	9 - 13	14 - 18	19 - 23	24 - 27	28 - 31	32 - 35
Nota	4	5	6	7	8	9	10

**CIP Katalogimi në botim
BKTiranë**

Mulgeci, Dhurata

Gjuha shqipe 7 : udhëzues për mësuesin / Dhurata
Mulgeci, Aliqi Zhonga ; red. Ortensa Marini. –
Tiranë : Irisoft education, 2016

340f. ; 20.7x27.7 cm.

ISBN 978-9928-4362-5-2

I.Zhonga, Aliqi

1.Gjuha shqipe 2.Tekste për mësuesit 3.Tekste për
shkollat 9-vjeçare

811.18 (072) (075.2)